

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

UBT News

Media & Events

7-24-2013

UBT News - Korrik 2013

University for Business and Technology

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/newspaper>

Recommended Citation

University for Business and Technology, "UBT News - Korrik 2013" (2013). *UBT News*. 10.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/newspaper/10>

This Book is brought to you for free and open access by the Media & Events at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in UBT News by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të Universitetit për Biznes dhe Teknologji | korrik 2013

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

UBT SHPALL KONKURS PËR VITIN ERI AKADEMIK 2013/2014

Faqe 32

UBT ME INSTITUT TË VEÇANTË, UNIK DHE TË VETMIN NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Faqe 6



UBT EDHE NË KËTË VIT OFRON BURSA JASHTË VENDIT PËRMES PROJEKTIT "ERASMUS MUNDUS - SIGMA"

Faqe 7



ROBOTËT E GJENERATËS SË FUNDIT TË NAO-SË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Faqe 11



UBT ME KAMPUS TË RI UNIVERSITAR

Faqe 4-5

STUDENTËT KOSOVAR MUND TË VAZHDOJNË STUDIMET NË UNIVERSITETIN E VARSHAVËS

"Kjo marrëveshje do t'ua mundësojë studentëve të UBT-së dhe atyre kosovarë që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe në doktoraturë nëpërmjet UBT-së t'i ndjekin në Universitetin Varshavës në Poloni, po ashtu stafit akademik zhvillim e kompetencës në fushën hulumtuese dhe zhvillimore. Bashkëpunimi do të ofrojë edhe programe të tjera të veçanta siç janë projektet, seminarët, transferi i teknologjisë, dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet".

Faqe 3



Editorial



Edmond Hajrizi
President i UBT-së

DYMBËDHJETË

Dymbëdhjetë vjet më parë, kur nisëm rrugëtimin tonë, e kishim të qartë çka duam, si dhe ku duam të mbërrijmë. Tash, është e lehtë të numërohen të arriturat – vetëm përmendim emrat, ngritjen shkencore e akademike dhe pozitat prestigjioze që kanë sot qindra ish-studentë tanë. Gjithashtu, kur i shohim sfidat që kemi kapërcyer, dalin se ishin shumë. Dhe, jemi krenarë se i kemi kapërcyer ato, shumë thjesht – sepse kishim të qartë synimin, të qartë e kishim edhe rrugën që duhet ndjekur për të krijuar një institucion prestigjioz si UBT-ja, që na bën krenarë ne dhe të gjithë ata që ishin dhe që janë pjesë e tij.

Këto ditë u zhvillua Ceremonia e Diplomimit 2013. Në të studimet bachelor dhe master i përmbyllën 212 studentë të Departamentit për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Departamentit për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, si dhe Departamentit për Mekatronikë.

Numrit të studentëve të diplomuar në UBT ia shtuam edhe këta 212, që hyjnë fuqishëm në konkurrencën e më të mirëve, hyjnë në garën për të qenë liderë profesionalë, që është një kërkesë e përditshme kudo në botë, por edhe në Kosovë.

E themi me këtë rast se ne po kërkojmë të zhvillojmë një personalitet, i cili është shumë i përgatitur profesionalisht, është i përkushtuar në punë, ka shkallë të lartë kreativiteti dhe inovacioni, ndërton partneritete me të tjerët, ndihmon veten dhe shoqërinë, puna e tij bazohet në fakte dhe rezultate, ka një aftësi të lartë ndërkulturore dhe interdisciplinare, por ka edhe një komunikim modern, të bazuar në vlerat më të larta.

Studimet në UBT kanë pasur dhe kanë pikërisht një qëllim: ofrimin e veglave dhe aftësive të nevojshme individit, për të marrë vendime racionale dhe që i garantojnë atij suksese dhe vlera që bazohen në standardet më të larta evropiane dhe ndërkombëtare.

Detyra kryesore është që t'ia ofrojmë studentit tonë të gjitha arritjet e fundit në shkencën e menaxhimit, në ekselencën biznesore, në teknologjinë më moderne, në robotikë, në arkitekturë, në dizajn, planifikim hapësinor, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, në integrimet evropiane, por edhe në kompetencën sociale.

Kjo është mundësuar falë një planprogrami modern që UBT e ka krijuar, duke u bazuar në standardet evropiane dhe amerikane të studimeve, por edhe në bazë të nevojave dhe kërkesave që dalin nga tregu i punës.

Po ashtu, kjo është mundësuar edhe falë angazhimit të një stafi akademik me një eksperiencë të lartë ndërkombëtare në shkencë por edhe në aspektin profesional.

Më shumë se 300 profesorë dhe ekspertë, nga katër kontinente, nga 20 vende dhe kultura të ndryshme, nga rreth 100 e më shumë universitete dhe institucione partnere me renome botërore, po sjellin në UBT përvojën dhe dijen e tyre në këto programe. Kjo ka krijuar një ambient unik ndërkombëtar, ndërkulturore dhe interdisciplinar jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Kjo i krijon UBT-së mundësinë të ofrojë programe dhe projekte që nuk kanë qenë më parë të pranishme në Kosovë.

Me ceremoninë e diplomimit, ne përmbyllëm një cikël, për të hapur menjëherë ciklin tjetër, për t'u rreshtuar në fillimin e garës për të arritura dhe suksese të reja. Tash, edhe me drejtime të reja, që janë sfida për ne të gjithë.

Përkushtimi ynë mbetet i njëjtë – ju keni zgjedhur më të mirin dhe, gjithsesi, do të bëheni më të mirët. Ne e dimë saktë dhe Ju do të bindeni se UBT ua mundëson këtë.

IMPRESUM

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së,

Botues: Edmond Hajrizi

Kryeredaktore: Naile Demiri

Adresa: www.ubt-uni.net

Tel: 038 541 400

Thyerja Grafike: ELV Studio



12 YEARS

LEADERSHIP and INNOVATION

Education • Research • Training • Consulting
2001/2011



**UNIVERSITY EDUCATION
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY**
AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

UBT-JA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN VARSHAVËS NË POLONI

STUDENTËT KOSOVAR MUND TË VAZHDOJNË STUDIMET NË UNIVERSITETIN E VARSHAVËS

Prishtinë, 10 qershor 2013- Në ambientet e UBT-ë, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndëruniversitar në mes të UBT-së dhe Universitetit të Varshavës në Poloni.

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hjarizi, së bashku me delegacionin nga Universiteti i Varshavës nga Polonia, i përberë nga zëvendësrektorja prof. Marta Kicinska-Habiovr, prof. Edward Halizak dhe dr. Jakub Zajczkowski, i kanë ftuar zyrtarisht të gjithë profesorët vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe studentët që të bëhen pjesë e programeve të përbashkëta, të cilët ata i kanë prezantuar.

“Kjo marrëveshje do t’ua mundësojë studentëve të UBT-së dhe atyre kosovarë që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe në doktoraturë nëpërmjet UBT-së t’i ndjekin në Universitetin Varshavës në Poloni, po ashtu stafit akademik zhvillim e kompetencës në fushën hulumtuese



Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hjarizi gjatë nënshkrimit të marrëveshjes ndërinstitucionale me prof. Marta Kicinska-Habiovr

dhe zhvillimore. Bashkëpunimi do të ofrojë edhe programe të tjera të veçanta siç janë projektet, seminarët, transferi i teknologjisë, dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet”,

ka theksuar presidenti i UBT-së, Edmond Hjarizi.

Ndërkaq zëvendësrektorja prof. Marta Kicinska-Habiovr, para të pranishmëve është shprehur e kënaqur me të arriturat e UBT-së, sidomos me programet e studimit me teknologjinë më

moderne, me infrastrukturën, me stafin akademik dhe me arritjet e studenteve. “Shpreh kënaqësinë time që vizitoj Kosovën me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëpunim në mes UBT dhe Universitetit të Varshavës.

Bashkëpunimi ndëruniversitar në mes UBT dhe Universitetin të Varshavës, ka filluar edhe më herët nëpërmjet projektit “Erasmus Mundus”, për shkëmbim të studentëve dhe stafit. Hjarizi, gjatë kësaj vizite dhe takimet e njëpasnjëshme që i zhvilloi me menaxhmentin më të lartë në Universitetin e Varshavës, u njoh me zhvillimet në këtë universitet, me theks të veçantë me punën që bëhet në të gjitha fakultete.

Universitetit i Varshavës është themeluar në vitin 1816, dhe sot renditet në 4% të universiteteve të kategorisë botërore dhe si universitetin numër një në vend. Është universitet gjithëpërfshirës publik, dhe më i madhi në vend, me 54 mijë studentë, 3500 staf akademik dhe ligjërues. Ka

bashkëpunim ndërkombëtar me përmasa botërore, me 240 marrëveshje bashkëpunimi universitar në 54 vende botërore, me 1600 marrëveshje bashkëpunimi, 1000 nga to në kuadër të programin ‘Erasmus Mundus’, të Unionit Evropian, dhe është anëtar aktiv në kuadër të këtij projekti”, është shprehur ajo. Pas aktit solemn të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, mysafirët nga Vrhava së bashku me menaxhmentin e lartë të UBT-së e kanë vizituar kampusin e ri universitar, dhe kanë marrë pjesën në hapjen e Ekspozitës Tradicionale “UBT 2012”, në të cilën janë ekspozuar punimet e studentëve të Departamentit të Arkitekturës të këtij universiteti.

Përfaqësuesit e Universiteti të Varshavës, para studentëve kosovarë dhe të pranishmëve tjerë, po të hënën në ora 17.30, mbajtën edhe një ligjëratë publike nga lëmi i shkencave politike, si dhe kanë folur për të arriturat e Universitetit të Varshavës.

UBT ZGJERON BASHKËPUNIMIN ME UNIVERSITETE NË GJERMANI, LIDH MARRËVESHJE ME TU CLAUSTHAL DHE UNIVERSITETIN E FREIBURGUT



Pamje nga takim i prof. dr. ing. Thomas A. Bier nga Universiteti i Freiburgut me prof. Hjarizin dhe prof. Krasniqin

Prishtinë 7 shkurt 2013- Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hjarizi, bashkë me prof. dr. Ibrahim Krasniqin, gjatë qëndrimit të tyre njëjavor në Republikën e Gjermanisë, zhvilluan një varg takimesh me rëndësi, ku njëkohësisht u takuan me krerët më të lartë të universiteteve të vendit.

Kështu, në Universitetin për Teknologji- Clausthal, në Gjermani, Prorektori për Çështje Akademike prof. dr.- Ing. Oliver Langefeld, përpos mikpritjes së përzemërt, pati një takim të përbashkët dhe të rëndësishëm me palët kosovare, në objektin e Universitetit për Teknologji -Clausthal, dhe u arrit në parim një marrëveshje për bashkëpunim ndëruniversitar me UBT-në. Në takim ishte e pranishme edhe Drejtoresha për Marrëdhënie Ndërkombëtare, në kuadër të

Universitetit për Teknologji të Clausthalit, znj. Romanovski e cila gjithashtu e përkrahu një bashkëpunim të tillë.

Më konkretisht, kjo marrëveshje parashih mundësimin e bashkëpunim ndëruniversitar në të gjitha nivelet e studimit, si dhe shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve, projekte të përbashkëta zhvillimore dhe hulumtuese, studentët të organizojmë seminare dhe takime të tjera akademike për çështje shkencore, përdorimin e bibliotekave përkatese për nevoja të studimeve dhe hulumtimeve shkencore, programe të studimit në distancë, zbatimin e përbashkët të programeve studimore, aktivitetet lidhur me kurset verore dhe takime të tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet.



Pamje nga takimi me prof. dr. Hjarizi me zëvendësrektorin prof. dr. Ing. Langefeld nga TU Clausthal

Z. Hjarizi dhe z. Krasniqi, gjatë kësaj takimeve me menaxhmentin më të lartë në Universitetin për Teknologji Clausthal, u njohën me zhvillimet në këtë universitet, me theks të veçantë me punën që bëhet në të gjitha fakultetet, më konkretisht, prof. Langefeld, e ka njoftuar z. Hjarizin lidhur me zhvillimet e përgjithshme dhe vizionin për zhvillim të mëtejshëm në këtë institucionin. Përveç marrëveshjes, gjatë kësaj vizite, pala kosovare, me ftesë të menaxhmentit të universitetit në fjalë, ka vizituar edhe disa institute dhe laboratorë të teknologjinë në moderne që ka shteti gjerman, të instaluar nëpër universitete për praktikë të studentëve, stafit dhe partnerët që ka ky universitet.

Përveç Universitetit të Clausthalit, Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hjarizi, bashkë me prof. dr. Ibrahim Krasniqin, zhvilluan edhe një takim shumë të rëndësishëm në Universitetin e Freibergut, ku u takuan me zëvendësdekanin e Fakultetit dhe njëherësh Drejtorin e Institutit për Shkenca Materiale, prof. dr. Ing. Thomas A. Bier.

Dy krerët e dy institucioneve biseduan për të gjitha mundësitë e bashkëpunimit, në një të ardhme të afërt, si në fushën e shkencave të materialeve, ndërtimin e infrastrukturës laboratorike por edhe projekte të përbashkëta shkencore dhe profesionale, në të gjitha nivelet e studimit, dhe për projektet e për-

bashkëta në nivel evropian dhe rajonal, shkëmbimin e literaturës më të avancuar dhe për çështje të tjera akademike të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet. Me këtë rast u arrit pajtimi dhe u nënshkrua marrëveshja e kooperimit të ndërsjellë, e cila do të mundësojë shkëmbim universitar të të gjitha niveleve.

Prof. Hjarizi dhe prof. Krasniqi vizituan edhe Muzeun Nacional të Kristaleve, më të madhin në botë, dhe u njohën me të arriturat e tij të vazhdueshme.

Që të dyja këto universitete të shtetit gjerman numërojnë një numër të konsiderueshëm të mësimdhënësve dhe kanë marrëveshje shumta bashkëpunimi me universitete në të gjitha kontinentet e botës, dhe janë themeluar ndër universitete e para në kontinentin e Evropës, ku numri i të diplomuarve nga këto universitete është i krahasueshëm me universitete më të mëdha në botë, po ashtu të diplomuarit sot janë në vende udhëheqëse nëpër kompani dhe organizata më profitabile në mbarë botën. Po ashtu të dyja janë ndër universitetet më me renome në Republikën e Gjermanisë dhe më gjerë, me një traditë qindvjeçare në fushën akademike dhe shkencore.

Prof. dr. Hjarizi dhe prof. dr. Krasniqi, gjatë vizitës në Universitetin e Freibergut, u takuan gjithashtu me prof. dr.- Ing. Habil. H Oettel, i cili gjithashtu shpreh gatishmëri për bashkëpunim në të gjitha fushat e mundshme në të mirë të dy universiteteve.

Sipas mikpritësve ky ishte vetëm hapi i parë në rrugën e një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe afatgjatë për të ardhmen.

UBT ME KAMPUS T



Prishtinë 6 dhjetor 2012- Në magjistralen Prishtinë-Shkup, 8 km larg Prishtinës, është përuaruar objekti i ri i UBT-së, objekt ky i cili u cilësua si i rëndësishëm veçantë dhe me një koncept të ri për zhvillimin e sistemit universitar e shkencor. Shiritin inauguroes, para shumë të pranishmëve, e kanë prerë Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prof. Dr. Ramë Buja dhe kryetari i Lipjanit, Shukri Buja

Duke folur para të pranishmëve, si përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të medieve, profesorë dhe studentë të UBT-së dhe të ftuar të tjerë, përveç se ju shprehu mirëseardhje në ceremoninë e përuarimit të objektit universitar, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi tha se ky objekt i dedikohet 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, u dedikohet studentëve dhe familjarëve, si dhe gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit. Po ashtu, studentëve u ka uruar studime të mbara.

“Pas themelimit të UBT-së në vitin 2001, dhe festimit të 10-vjetorit të punës së suksesshme të këtij institucioni, vlerësojmë se përuarimi i kampusit të ri universi-

tar shënon ngjarjen më të veçantë në historikun e këtij institucioni të arsimit të lartë, i cili shënon një fillim tjetër të funksionimit të jetës akademike dhe zhvillimit të procesit mësimor-shkencor”, tha Dr. Hajrizi.

Ai më tej premtoi se përmes kësaj infrastrukture do të ngriten kapacitete hulumtuese dhe profesionale, cilësi në shkencë, konsulencë, trajnime e certifikime, transfere të teknologjisë dhe ndërkombëtarizim...

“Kjo infrastrukturë tash mundëson sfida të shumta që ka zhvillimi i vendit. Përmes kësaj infrastrukture dhe përmes kompetencës profesionale ne tash e tutje do t’i përgjigjemi sfidës së prodhimitarisë vendore, përmes kësaj infrastrukture - laboratorit të mektronikës dhe robotikës dhe teknologjisë së avancuar ne do ta rrisim prodhimitarinë vendore dhe do ta ulim importin dhe do ta rritim eksportin. Në fakt, përmes kësaj teknologjie ne do t’i përgjigjemi sfidave të teknologjisë së informacionit dhe kompetencës profesionale dhe do të kemi punësim më të madh, do të ndërtojmë biznese të qëndrueshme për një shfrytëzim më të mirë të resurseve natyrore, do të organizojmë



Pamje gjatë përuarimit të objekti i ri të UBT-së

ngjarje të mëdha shkencore, profesionale”, vijoi ai.

“I jemi mirënjohës Komunës së Lipjanit për zemërgjerësinë që ka treguar me dhënien e pronës komunale për ndërtim universiteti, ndërsa shpresojmë të jemi partnerë të mirë për ta drejt zhvillimit të ekselencës, në edukimin e lartë, të inovacioneve dhe të teknologjisë”, tha Dr. Hajrizi në fjalën e tij, ndërsa ka shtuar se

Lipjani me këtë rast iu shkëput një pjesë e tokës së pëlleshme, por nga ana tjetër fitoi ndërtimin e vendit të dijes dhe të shkencës profesionale.

UBT e bën Lipjanin qytet universitar

Ndërsa, ministri i arsimit, Ramë Buja, ka deklaruar se UBT-ja është një institucion kredibil që ka dhënë kontribut të çmueshëm,

e gjithësesi edhe të dalluar drejt avancimit të dijes.

“Ky universitet ia mori Lipjanit tokën e pëlleshme, mirëpo, arsyetimi më i mirë për këtë marrje toke është të krijohet atë që është më i pëlleshmi i të pëlleshmëve, të krijohet njeriu i ditur për Kosovën dhe këtë e besoj me sigurinë time se ky institucion do ta bëjë”, ka thënë ministri Buja.

TË RI UNIVERSITAR



Pamje nga fjalimi i presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, drejtuar mysafirëve me rastin e përrurimit të objektit të ri të UBT-së

“Këtu, në këtë vend shpresohet të studiojnë djem e vajza nga të gjitha trojet shqiptare, sepse patriotizëm kulmor tash për tash në këtë kohë është vetëm dija”, vijoi ai.

Për ngritjen e UBT-së, ndërkaq, Komuna e Lipjanit pati ndarë rreth 3 hektarë tokë të pronës komunale, e cila ndodhet në zonën ekonomike dhe ku tashmë ka edhe lidhje të mëdha biznesi.

Z. Shukri Buja, kryetar i Lipjanit, e pranon se në fillim kur është dhënë kjo tokë ka pasur dyshimet e veta për ndërtim kaq të shpejtë të universitetit në fjalë.

“Kur lindi ideja për këtë universitet ishin bukur skeptikë, madje edhe kur e dhamë pronën komunale për këtë ndërtim, mirëpo presidenti i UBT-së, Hajrizi, e arriti këtë sukses, duke përruruar objektin ndër më të mirët në këtë komunë. Personalisht sot jam tepër i privilegjuar, sepse pos përrurimit të këtij universiteti po e shpalli edhe një premtime elektoral të realizuar, qytetin e Lipjanit, qytet universitar”, ka thënë Buja.

Në ngritjen e UBT-së në Lipjan, ndërkaq, është thënë se janë investuar rreth një milion euro në fazën e parë të këtij projekti. UBT-ja tashmë në brendinë e



UBT-ja e nderoi kryetarin Shukri Buja me çmimin “Leadership Excellence Award”

vetë ka salla laboratorësh, amfiteatrin, por edhe 15 salla mësimi me hapësirë prej 3 mijë metrash katrorë.

Kurse zëvendës-presidenti i UBT, Prof. Dr. Mo Vaziri tha se përpjekjet tona do të bazohen në anët e forta dhe vlerat karakteristike të Kosovës.

Misioni ynë është për të ndryshuar Kosovën nëpërmjet hulumtimeve të cilësisë së lartë, kërkime studimore dhe ripërsëritje te va-

zhdueshme. Ne do të edukojmë ekspertë të përgjegjshëm, mendje hapur për të vepruar si largpamës të ardhshëm në shoqërinë tonë. Ne do të përdorim profilet tona unike për të stimuluar risitë dhe tejkaluar kufijtë tradicionalë. Do të ndërtojmë një komunitet të hapur për studentët, ekspertët, akademikët dhe të tjerët për shkëmbimin e lirë të ideve që ndikojnë në shoqërinë në përgjithësi. UBT do të punojë për t’u siguruar

udhëheqësve akademikë procese, mjete, mbështetje dhe trajnim të duhur menaxhimi. Krahas arritjeve akademike, lidhshipi i mirë duhet të njihet dhe të shpërblehet, përfundoi ai.

UBT ndau çmim për kryetarin Buja,

Kryetarin Shukri Buja, për kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë rreth objektit të ri të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi

dhe Këshilli Akademik i UBT-së, si shenjë respekti e nderuan me Çmimin më të lartë që parasheh Statuti i Universitetit UBT, “Leadership Excellence Award”.

Në vijim të manifestimit, studentja Pajtesa Gashi ka thënë se ata si studentë ndihen të privilegjuar t’i vijojnë mësimet në këtë objekt.

“Ne si studentë jemi të privilegjuar që kemi fatin të vijmë në këtë objekt kaq të bukur, të ri dhe madhështor. Gjithmonë kjo është meritë e juaja, andaj gjithmonë, duhet falënderuar juve”, ka pohuar Gashi.

Më 28 tetor 2009, në Kuvendin Komunal të Lipjanit, që nënshkruar kontrata midis Kuvendit Komunal të Lipjanit dhe të UBT-së për lokacionin e ri, afër QMI-së, për ndërtimin e kampusit të ri të UBT-së. Kontratën e patën nënshkruar Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe kryetari i Kuvendit Komunal të Lipjanit, zotëri Shukri Buja.

Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes i pari komunës së Lipjanit, z. Buja, patë thënë se “Dr. Edmond Hajrizi është qytetar i komunës së Lipjanit, i cili na ka nderuar me investimin e tij në komunën tonë, me ndërtimin e objektit të Universitetit për Biznes dhe Teknologji”.

Ndërsa, rektori i UBT-së, Dr. Edmond Hajrizi, ka falënderuar kryetarin Buja dhe komunën e Lipjanit, për bashkëpunimin dhe mundësinë e ofruar UBT-së, për zhvillimin dhe rritjen e mëtejme të tij.

UBT PËRUROI INSTITUTIN E GJUHËVE TË HUAJA

UBT ME INSTITUT TË VEÇANTË, UNIK DHE TË VETMIN NË REPUBLIKËN E KOSOVËS



Prishtinë 4 prill 2013- Në UBT u bë përrurimi i Institutit të Gjuhëve të Huaja dhe të Komunikimit Ndërkulturor. Fjalimin inauguroes, para shumë të pranishmeve, e ka mbajtur Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, dhe më pas drejtori i këtij

Institucioni, prof. dr. Abdullah Karjagdiu. Ky institut u cilësua si i rëndësishëm së veçantë dhe me një koncept të ri, si një urë bashkëpunimi në rajon dhe botë, dhe për t'i ndihmuar vendit tonë që të integrohet sa më parë në strukturat euroatlantike.

Duke folur para të pranishmëve, si përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të medieve, profesorë dhe studentë të UBT-së, dhe të ftuarve të tjerë, Presi-

denti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se "UBT-ja është një universitet modern dhe inovativ në Republikën e Kosovës, që i ka përparësitë e universiteteve të njohura ndërkombëtare, ngase jo vetëm që ofron programe të një cilësie të lartë studimesh, por tash e tutje e ka edhe Institutin e Gjuhëve të Huaja dhe Komunikimit Ndërkulturor si për ngritjen e cilësisë së studimeve në UBT ashtu edhe për t'i ndihmuar vendit tonë që të integrohet sa më parë në strukturat euro-atlantike".

Dr. Hajrizi më tej shtoi se është institucioni i veçantë, unik dhe i vetmi në Republikën e Kosovës i këtij lloji, ngase qëllimi kryesor i institutit është që t'i përgatisë të gjithë të punësuarit në sektorin publik dhe privat, në Republikën e Kosovës si, shërbyesit civilë të të gjitha llojeve, niveleve dhe institucioneve, pedagogët e të gjitha niveleve, arsimtarët, mjekët, politikanët, diplomatët, policët, ushtarakët, gjykatësit, etj, në zhvillimin, ngritjen, perfeksionimin dhe avancimin e aftësive dhe shkathtësive të komunikimit me shkrim dhe me gojë në gju-

hën angleze dhe në gjuhë të tjera evropiane",

Ndërsa, Drejtori i këtij instituti, prof. dr. Abdullah Karjagdiu, ka deklaruar se Instituti do t'ju bëjë të mundur të gjithë të punësuarve në sektorin publik dhe privat në Kosovë që të komunikojnë, me shkrim dhe me gojë, në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera botërore, me kolegët e tyre në Evropë dhe në botë, në nivel profesional, serioz dhe dinjitoz. Kjo pastaj do të bëjë të mundur ngritjen e përsheptuar dhe të sigurt të kapaciteteve të administratës shtetërore dhe të gjitha institucioneve publike dhe private vendore në përgjithësi për të qenë në gjendje që të kontribuojnë në përsheptimin e integriteteve në strukturat euro-atlantike. Garant për këtë do të jetë stafi tejet i përgatitur dhe i motivuar i pedagogëve, profesorëve dhe asistentëve universitarë më të mirë nga vendi, rajoni, Evropa dhe ShBA-ja.

Po ashtu një fjalë përsheptëse e mbajti edhe zëvendës-presidenti i UBT, prof. dr. Mo Vaziri.



UBT ZGJERON BASHKËPUNIMIN ME MASHT-in

Prishtinë, 19 prill 2013 - Në kuadër të marrëveshjeve të shumta që i ka UBT, me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, Presidenti i këtij institucioni, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në Republikën e Kosovës, prof. dr. Ramë Buja, nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi.

Qëllimi i këtij Memorandumi është zhvillimi i Sistemit për Publikime shkencore dhe Projekte në Kosovë.

Më konkretisht ky Memorandum përmban si Sistemin për publikime dhe projekte, regjistrimin e institucioneve akademike (universitete, kolegje universitare dhe kolegje), regjistrimin e personave të lidhur me ndonjë nga këto institucione akademike, publikimin e punimeve, projekteve, njoftimin mbi konferencat, etj.



160 PJESËMARRËS NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE PËR 100-VJETORIN E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Prishtinë, 2- 3 nëntor 2012 – UBT në bashkëpunim me Universitetin “Ismail Qemali” në Vlorë, dhe Universitetin e Tiranës, dhe institucione tjera akademike, organizuan Konferencën dy ditore ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacione, e cila zhvilloi punimet e saja më 2 dhe 3 nëntor, në hotelin “Swiss Diamond”, në Prishtinë.

Kjo Konferencë Ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacione, u mbajt me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, dhe janë paraqitur rreth 160 pjesëmarrës - akademikë dhe profesionistë të fushave përkatëse, nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, si dhe akademikë nga shumë vende të ndryshme të botës.

Përveç krerëve të këtyre institucioneve organizatore, si Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, Rektori i Universitetit të Vlorës, prof. dr. Albert Qarri, dhe prof. dr. Kozeta Sevrani, përgjegjëse e Departamentit Matematikë, Statistikë dhe Informatikë e zbatuar në Universitetin e Tiranës, UT, në hapjen solemne morën pjesë edhe përfaqësues të lartë të Republikës së Kosovës, si ministri i Zhvillimit Ekonomik, z. Besim Beqaj, etj.

Dr. Hajrizi: UBT ka përfaqësuar Republikën e Kosovës dhe 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë në katër anët e globit

Duke folur para të pranishmëve, si përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të medieve, profesorë dhe studentë të UBT-së dhe të ftuar të tjerë përveç se ju shprehi mirëseardhje, Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha: “Kjo konferencë është edhe një rezultat i punës së pandalshme të UBT-së, në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar. Kjo konferencë hyn në vargun e një varg konferencash ndërkombëtare që ka organizuar UBT në Prishtinë, apo ku UBT ka përfaqësuar Republikën e Kosovës, në të katër anët e globit, duke krijuar ura bashkëpunimi me institucio-

net më prestigjioze ndërkombëtare dhe regjionale, si dhe duke u krijuar mundësinë profesorëve dhe studentëve të UBT-së që të njihen me kolegët dhe përvojat e institucioneve akademike nga e mbarë bota. E vlerësoj lart rëndësinë e kësaj konference dhe bashkëpunimin me institucionet më të rëndësishme akademike të Shqipërisë”.

Dr. Hajrizi më tej shtoi se UBT, që nga themelimi i saj - vitin 2001, ka luajtur rol kryesor në avancimin, përsosmërinë jo vetëm në shkencë dhe hulumtime por edhe në zhvillimin e vendit. Ky institucion, ka kontribuar në avancimin e Arsimit të Lartë në vend dhe më gjerë, ndihmoi rritjen e ekonomisë së Kosovës dhe rritjen e industrisë në aspektin e cilësisë dhe sasisë. Ne jemi shumë krenarë që çdo herë kemi qenë pjesë e përparimit në aspektin akademik dhe kryerjen e shumë aktiviteteve të ndryshme, duke sjellë risi në drejtimet që ofron UBT, si Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Mekatronikë, Arkitekturë, Biznes, Ekonomik dhe Menaxhim ..etj.

Ndaj, nëpërmjet kësaj konference, do të përpiqem të lidhim marrëdhënie të ngushta me Ju të pranishëm dhe më të gjitha komunitetet tjera, për të ruajtur reputacionin tonë dhe angazhimin në sektorin e Arsimit të Lartë në vend dhe më gjerë.

Qarri: UBT është një institucion modern, ambicioz dhe më seriozi në Kosovë!

“Ndihehem posaçërisht i emocionuar sot- në një udhëtim në Kosovë, në këtë të patriotizmit shqiptarë, për ne që vijmë prej Vlorës, si për çdo shqiptar është gjithnjë i veçantë, për arsye që shumëkush e di. Për më tepër ky takim në Prishtinë, në këto ditë të Jubileut, në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, është edhe njëherë dëshmi e kohëve të reja, akt domethënës mbi një të ardhme të përbashkët, në çdo kuptim”, tha rektori i Universitetit të Vlorës, prof. dr. Albert Qarri.

Ai me tej shtoi se, dua të ndalëm në mënyrë të veçantë në për-



Pamje nga fjalimi i presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, drejtuar pjesëmarrësve të konferencës



masën e re që po merr ndërveprimi mes nesh, në këtë rast mes Universitetit “Ismail Qemali”, të Vlorës dhe UBT-së.

Prof. dr. Kozeta Sevrani, organizatore e Konferencës dhe përgjegjëse e Departamentit Matematikë, Statistikë dhe Informatikë e zbatuar në UT, përveç që i përshëndeti të pranishmit ndër tjera tha: “Nëpërmjet kësaj konference synonim të vazhdojmë të kontribuojmë për përmbushjen e nevojave që kanë akademikët, kërkuesit, lektorët e studiuesit e fushës, për të ndarë mendimet, idetë, eksperiencat dhe punimet e tyre. Konferenca synon të forcojë një platformë tashmë të vendosur që në konferencën e mëparshme, ku të diskutohen problemet e Teknologjisë së Informacionit, Komunikimit, Ekonomisë në vend si dhe impakti i elementeve të ndryshëm të saj në zhvillimin e ekonomisë e shoqërisë në për-

gjithësi. Së fundi, pjesë e fokusit të kësaj konference do të jetë dhe zhvillimi i tregut, ku aktorë të këtij tregu janë të mirëpritur të japin opinionin dhe mendimin e tyre kritik në lidhje me të.

Ministri i Ekonomisë në Republikën e Kosovës, Besim Beqaj, tha se evidenca empirike dhe praktike nga vendet e ndryshme, sidomos ekonomitë e transformuar në ekonomi të tregut, tregun që ekziston një korrelacion jashtëzakonisht i qëndrueshëm dhe pozitiv në mes të bizneseve të reja, inovacionit dhe rritjes ekonomike.

Konferencën e përshëndeti edhe zëvendës-presidenti i UBT-së, prof. dr. Mo Vaziri, dhe tha se UBT do të jetë në vazhdimësi kontribuues i konferencave shkencore, në rritjen e ekonomisë dhe zhvillimin e vendit në të gjitha sektorët.... etj.

Në konferencë në fjalë për dy ditë me radhë, me punime e tyre hulumtuese nga fusha e cekur me lartë u paraqitën vargu i studiuësve si:

Konferenca Ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacione, u mbajt me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, dhe u paraqitën 160 pjesëmarrës - akademikë dhe profesionistë të fushave përkatëse, nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, si dhe akademikë nga shumë vende të ndryshme të botës.

Po ashtu në konferencë më punime e tyre hulumtuese nga fusha e cekur me lartë u paraqitën edhe një varg studiuësish të rinj të tria universiteteve organizatore si të UBT-së, UV-së dhe UT-së, si studentë dhe profesor.



Pamje nga fjalimi i prof. dr. Albert Qarri, drejtuar pjesëmarrësve të konferencës

UBT-JA ORGANIZOI KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE ME TEMËN "STABILITETI NDËRKOMBËTAR, TEKNOLOGJIA DHE KULTURA"

UBT-JA MUNDËSI E MIRË PËR ECURINË E TEKNOLOGJISË

Prishtinë, 6 qershor 2013 - Universiteti UBT organizoi konferencë treditore ndërkombëtare me temën "Stabiliteti ndërkombëtar, teknologjia dhe kultura", e cila është mbajtur nën patronatin e Federatës Botërore - IFAC dhe në bashkëpunim me Universitetin e Vjenës për Teknologji.

Gjatë kësaj konference janë paraqitur mbi 100 punime shkencore, nga vendet e ndryshme të botës si: Kosova, Shqipëria, Polonia, Gjermania, Norvegjia, Arabia Saudite, Romania, Anglia, Bullgaria, Greqia, Irlanda, Maqedonia, Ukraina, Austria etj.

Përveç krerëve të këtyre institucioneve organizatore, si presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, prof. dr. Peter Kopacek nga Universiteti Teknik i Vjenës, prof. dr. Larry Stapleton nga Instituti për Teknologji në Irlandë, në hapjen solemne morën pjesë edhe përfaqësues të lartë të Qeverisë Republikës së Kosovës.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, pas hapjes solemne të punimeve të konferencës tha se "teknologjia e re po na mundëson mjete, të cilat po na shtojnë të ecim përpara për qëllime pozitive dhe drejt stabilitetit". Sipas tij, në përgjithësi teknologjia mbetet një faktor shumë i rëndësishëm për stabilitetin ndërkombëtar.

Kurse prof. dr. Peter Kopacek nga Universiteti Teknik i Vjenës, pasi falënderoi të gjithë pjesëmarrësit, u shpreh se është i nderuar që është ndër organizatorët e kësaj konference, e cila ka qëllimin pozitiv për njerëzimin.

Larry Stapleton nga Instituti Waterford për Teknologji në Irlandë, tha se "sektori i arsimit për shumë vite është konsideruar si mënyrë e përmirësimit të kushteve të njerëzimit, çka edhe e gjeta gjatë udhëtimit tim në UBT, që ishte misioni i vetë presidentit z. Hajrizi dhe prof. Kopacekut". "Kjo konferencë është një rast i mirë që po i adresohen temës së stabilitetit ndërkombëtar dhe zhvillimeve", vlerësoi ai.

Kurse përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë, dr. Murteza Osdautaj, tha se UBT-ja është duke dhënë kontribut të vazhdueshëm në zhvillimin e shkencës. "Duke e parë kontributin, UBT-ja me punën e vet po bëhet lider i zhvillimeve të teknologjisë", theksoi Osdautaj, i cili në emër të ministrit prof. dr. Ramë Bujaj, i uroi suksese punimeve të kësaj konference dhe premtoi mbështetje.

Punimet e konferencës u zhvilluan në disa sesione të njëpasnjëshme, gjithashtu u prezantuan një varg të arriturash nga hulumtimet shkencore, të cilat kishin qëllime pozitive dhe drejt stabilitetit. Sipas studiuesve, në përgjithësi teknologjia mbetet faktori më i rëndësishëm për stabilitetin e vendit dhe lehtësimin e jetës së njeriut.

Njëri ndër hulumtimet e prezantuar ishte "Menaxhimi i Mektro-

nikës dhe Inxhinierisë". Për të ku folën presidenti i UBT-së, Edmond Hajrizi, Lery Stapleton dhe Peter Kopacek.

Ky hulumtim shkencor ka për qëllim zhvillimin e sistemeve të reja dhe të qëndrueshme në sektorin e arsimit në rajone të etiketuara, me një fjalë ky hulumtim e përcakton rastin e zhvillimit të korikule universitare për menaxhimin e mektro-nikës në Kosovë konkretisht se si është e mundur që të përdorin teoritë e inxhinierisë dhe teknologjisë profesionale për zhvillimin e programeve të arsimit të lartë.

"Hulumtim dhe Edukim me Scrap (Mbeturina Elektronike dhe Materiale)" për të cilën folën Peter Kopacek, Muzafer Shala, Kreshnik Ismaili dhe Fatos Sylaj.

End of Life Management (EoL) është një temë aktuale në industrinë elektronike. Momentalisht shumica e pajisjeve të IT-se dhe aparaturore elektronike janë shqyrtuar. Varësisht prej moshës dhe llojit të pajisjes ekzistojnë tre mundësi të EoL: Rishitje (Resell)-Ripërdorim (Reuse) - Riciklim (Recycle) të quajtura "3R". Në të ardhmen e afërt çmontimi gjysmë automatik dhe automatik do të ketë rëndësi. Dizajnerët duhet të kenë parasysh EoL për shkak të rregulloreve dhe ligjeve si dhe duhet të bazohen në kodet etike që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit.

Në këtë publikim definitivisht është paraqitur një qasje e re në pjesën e Ripërdorim (Reuse). Në shumicën e vendeve në zhvillim pajisjet laboratorike për edukim dhe hulumtime shkencore janë shumë të shtrenjta. Prandaj ne kemi prodhuar pajisje të tilla prej mbeturinave harduerike dhe softuerike.

"Kulturat e reja dhe teknologji e vjetër, një rishikim dhe adoptimin i Qendrës së Telemjekësisë në Kosovë", ishte hulumtimi i O'Neill Sinead, Anita Kealy dhe Lery Stapleton. Me një fjalë hulumtimi i tyre ka shqyrtuar teoritë e inovacionit dhe adoptimit nga literatura sistemeve të informacionit për analizën e teknologjive të komunikimit në profesionin mjekësor në Kosovë. Sipas këtij hulumtimi mjekët janë njerëzit më të shkolluar në botë.

"Një shikim mbi trekëndëshin e njohurive si forcë udhëheqëse për rritje të qëndrueshme në vendet në zhvillim", ishte hulumtimi i radhës të studiuesi Peter Groumos. Ky hulumtim ka paraqitur qasjet matematikore dhe gjeometrike në konceptin Trekëndëshi të Njohurive, Marrëdhëniet e Strategjisë së Lisbonës dhe Institutin Evropian të Teknologjisë (IET). Gjatë ligjërimit të tij me fokus të veçantë Groumos u ndal të Trekëndëshi i Dijes, i cili tha se ky trekëndësh garanton bashkëpunim të plotë dhe dinamik midis komponentëve të nevojshme për zhvillimin e rritjes së qëndrueshme të një rajoni.

Krenare Pireva u paraqit me hulumtimin "Management System for Students' Attendance". "Në



këtë hulumtim propozojmë ide të reja sesi ne mundem të gjejmë vijueshmërinë e nxënësve tanë në mënyrë automatike, etj."

"Qendrat e transferimit të njohurive dhe edukimi për Inovacione dhe menaxhimin të teknologjisë" të autorit Pjetër Kopacek. Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të propozojë një qasje për përmirësimin e ekonomisë rajonale, ku synimi i këtij hulumtimi ka për qëllim përmirësimin e arsimit të lartë për një punësim më të mirë të të diplomuarve të tyre.

"Cross-Cultural Mediation: Mind the Knowledge Gap" - Gill S. Karamjit, i cili tha se, procesi i ndërmjetësimit mund të shihet në drejtim të identifikimit të njohurive dhe të komunikimit të boshllëqeve që pengojnë dhe gjejnë potencialin që lehtësojnë atë.

"Përmirësimi i politikave të transportit në vendet në zhvillim të Ballkanit Perëndimor duke shfrytëzuar metodën gjithë përfshirëse të integritimit të faktorëve kryesor", të autorit Ylber Limani dhe Binak Beqaj, të cilët thanë se ky punim ka për qëllim hulumtimin e mundësive për të përmirësuar planifikimin të transportit në nivel të politikave në vendet në zhvillim. Fokusi i hulumtimit është drejtuar në disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Hulumtimi është realizuar duke u bazuar në teorinë nga literature, nga hulumtimi gjendjes në regjionin e Ballkanit Perëndimor, dhe në praktikën më të mirë nga vende të ndryshme të botës.

Edmond Hajrizi, paraqiti punimin e tij shkencor me temën "Shfrytëzimi i ciklit jetësor të projekteve të ndjeshme (sensitive)". Punimi është shkruar me qëllim të realizimit të tentativës për të analizuar dhe studiuar shfrytëzimin apo përdorimin e menaxhimin të projekteve me fokus projektet që trajtojnë çështjet e ndjeshme sociale të shëndetit publik të të rinjve në Kosovë. "Sistemet informative dhe çështjet e blerjes nga jashtë (outsourcing) të MGT projekteve" ishte hulumtimi i Ahmed Aiharbi, i cili fole mbi

numrin që lidhen me outsourcing në det të hapur për projekte të sistemit të informacionit që mund të kenë ndikim të thellë mbi suksesin apo dështimin e projekteve.

Prof. dr. Ibrahim Krasniqi, u paraqit me dy punime shkencore si "Politikat Strategjike të Qeverisjes Lokale dhe Menaxhimi i mbeturinave - Rasti i Komunës së Prishtinës", i cili adreson menaxhimin strategjik të politikës së qeverisjes vendore dhe praktikën e menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Prishtinës. Urbanizimi i shpejtë ka bërë menaxhimin e mbeturinave një problem serioz sot. Perceptimi i njerëzve ka qenë gjithmonë se kjo është një përgjegjësi e organeve të qeverisjes vendore. Ky punim shkencor do të përfshijë vlerësimin e alternativave në dispozicion, praktikën e mira ndërkombëtare dhe teknikat, iniciimin e një metodologji praktike riciklimin të mbeturinave, dhe promovimin e strategjisë 3R (reduktim, ripërdorim, riciklim). Punimi shqyrton aspekte multidimensionale të mundësive të reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimin të mbeturinave dhe përmirësimin e menaxhimit të sektorit për nivelin e qeverisjes lokale.

Kurse punimi i radhës ishte "Menaxhimi i konflikteve potenciale mes burimeve të energjisë dhe sigurisë së furnizimit me energji në Kosovë". Sipas dr. Krasniqit qëllimi i këtij hulumtimi është vlerësimi shumëdimensional dhe menaxhimi i konflikteve potenciale mes burimeve të energjisë dhe sigurisë së furnizimit me energji në Kosovë, si dhe përcaktimin e skenarëve të zhvillimit të mundshme për furnizimin me energji të qëndrueshme të vendit. Zhvillimi ekonomik në të gjitha vendet në tranzicion, duke përfshirë Kosovën, ka dëshmuar se sa e vështirë është për të menaxhuar burimet natyrore si pronësi dhe të përfitojmë prej tyre drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Këto vështirësi janë të lidhura së pari me variacionin të madh të kërkesës për energji dhe treguesve ekonomikë, pastaj mungesa e infrastrukturës së

dukur dhe efektive si dhe gjetja e një metodologjie të përshtatshme për zhvillimin e sektorit. Vështirësitë bëhen më të madha në situatën ekzistuese ku për sektorë të ndryshëm të ekonomisë së Kosovës ende nuk ekzistojnë strategjitë e zhvillimit sektorial.

Për ndryshim nga punimet tjera kan. dr. Fatbardha Qehaja-Osmani, në këtë konferencë dha diçka më inovative në kuptimin e mësimnxënies nga kundërvështrimi psikologjik. Ky punim është pjesë e hulumtues të doktoratës që quhet "Funksionet ekzekutive dhe suksesi ne jete", i cili elaboron definicionet e tri funksioneve themelore ekzekutive në trurin e njeriut: Inhibition, Working Memory dhe Cognitive flexibility. Të gjitha këto janë bazuar në demonstrimin rasteve konkrete, sjellin konferencës njohuri koherente në efektet që këto funksione kanë në arritshme rinë e suksesshme të njerëzve.

Besart Pllana dhe Valdete Ferati, u paraqitën me punimin "Teknologjia e Informacionit në Shëndetësi në Kosovë: Përdorimi i Teknologjisë në Klinikat Private". Në këtë hulumtim diskutohet dhe analizohet përdorimi i teknologjisë së informacionit nga klinikat private në Kosovë, posaçërisht të spitalet private të licencuara. Në njërin anë analizohet lloji dhe mënyra e implementimit të teknologjisë nga këto klinika, dhe njëkohësisht në mënyrë sipërfaqësore analizohet gatishmëria e inkuadrimit të këtyre Klinikave në Sistemin Informativ të Shëndetësisë si pjesë e "Strategjisë për Qeverisje Elektronike 2009 - 2015".

"Ishulli i ngrohtë urban dhe ftohja pasive" është titulli i punimit shkencor të dr. Mimoza Dugollit, në të cilin ajo ka trajtuar fenomenin i cili quhet "Urban Heat Island" që shfaqet si pasojë e zhvillimeve të shpejta dhe të zgerimeve të paplanifikuara të qyteteve, duke trajtuar konkretisht rastin e qytetit të Prishtinës, me ç'rast në brendi të qyteteve paraqitet një rritje e temperaturave deri në + 4 grade C më shumë se sa në zonat rrethore të gjelbëruara e në periferi. Sadije Kelmendi dhe Muhamet Ahmeti prezantuan hulumtimin "Menaxhimi i hapësirave dhe kohës, kontraktorët në renovimin e objekteve spitalore", i cili paraqet një analizë të projekteve të cilat kanë të bëjnë me punët, problemet dhe vonesat në objektet ku procesi i punës që zhvillohet nuk duhet të ndërpritet, si p.sh. spitalet, shkollat dhe objektet e tjera të rëndësishme të veçantë. Rinovimi i këtyre objekteve është sfidues si për kryesit të punës, si dhe për menaxhmentin e këtyre objekteve posaçërisht të objektet spitalore të të cilat procesi i punës nuk mund të ndalohej as për një moment, për shkak të problemeve të shumta që lindin gjatë kryerjes së këtyre punimeve, të cilat kanë vonesa shumë të mëdha në ekzekutimin e këtyre punimeve, si dhe pengesa në funksionimin e rregullt të këtyre objekteve.

UBT DHE "MIQTË E AMERIKËS" ORGANIZUAN KONFERENCË REGJIONALE PËR 100-VJETORIN E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

RËNDËSIA JETIKE E SHBA-së PËR SHQIPTARËT



Prishtinë, 20 nëntor 2012 - UBT në bashkëpunim me shoqatën "Miqtë e Amerikës", organizuan konferencën shkencore dhe regjionale me temën; "Roli i SHBA-ve, në Shtetformimin e Shqiptarëve", e cila u mbajt në Hotelin "NARTEL" në Prishtinë, dhe u përçoll nga shumë të interesuar.

Në Konferencën "Roli i SHBA-ve, në Shtetformimin e Shqiptarëve", e cila u mbajt me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, dhe u paraqitën rreth 30 pjesëmarrës - nga fusha akademike dhe politike si nga Republika e Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë.

Përveç krerëve të këtyre institucioneve organizatore, në hapjen solemne morën pjesë edhe ambasadori i Shqipërisë në Republikën e Kosovës, Dr. Islam Lauka dhe përfaqësues të lartë të vendit.

Duke folur para të pranishmëve, si përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të

atyre regjionale, përfaqësues të medieve, profesorë dhe studentë të UBT-së dhe të ftuar të tjerë, në emër të Presidentit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizit, i cili po merret pjesë në Hartimin e Strategjisë Regjionale për Hulumtim dhe Inovacione, të financuara nga Banka Botërore dhe mbështetur nga Komisioni Evropian, zëvendës-presidenti i UBT-së, Mo Vaziri, përveç se ju shprehi mirëseardhje, tha:

Në vazhden e manifestimeve e të shumta të ndërlidhura me 100- vjetorin e pavarësisë së Republikës së Shqipërisë, UBT, organizoi Konferencën e radhës dhe regjionale me qëllim për të dhënë kontribut në ndriçimin e faktorëve vendimtarë që kanë ndikuar në krijimin e shtetit të pavarur të Shqipërisë. Rrjedhimisht SHBA-të, kanë krijuar kushte dhe rrethana për pavarësimin e Republikës së Kosovës dhe realizimin e drejtave të shqiptarëve në

përputhje me normat dhe standardet demokratike gjithandej. Stafi akademik dhe menaxherial i UBT-së, shpreston se kjo përbërje reprezentative akademike, politike dhe intelektuale do të ndriçojë, krahas rolit të vazhdueshëm të SHBA-ve, edhe aspektet tjera rrethanore që kanë ndikuar në realizimin e synimeve humanitare dhe kombëtare.

Ndërsa, Agim Rexhepi, Kryetar i shoqatës "Miqtë e Amerikës", përveç që falënderoi pjesëmarrësit, në mënyrë kronologjike foli rreth aktiviteteve të shoqatë, duke bashkëpunuar me udhëheqësit më të lartë shtetërorë amerikanë si kryetarë, kongresmen dhe senatorë për Republikën e Kosovën.

Penalistët e konferencës si; dr. Islam Lauka, Ambasador i Shqipërisë në Republikën e Kosovës, prof. dr. Mo Vaziri, Zëvendës-president në UBT, nga SHBA, Abdi Baleta-, ish-përfaqësues i Shqipërisë në OKB, Riza Halimi, Deputet në Kuvendin e Serbisë,

prof. dr. Veton Latifi- Republika e Maqedonisë, prof. dr. Jordan Daci, profesor universitar, Tahir Tahiri- Kryetari i Këshillit Nacional të Shqiptarëve në Malë të Zi, prof. dr. Abdullah Karjagdiu, profesor në UBT, Fahri Musliu, publicist- Beograd, phd. cand. Arbër Hadri, prof. dr. Belul Beqaj, phd. cand. Shqipërim Pula, Yllka Veseli, Alumni i UBT-së, phd. cand. Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes dhe Kryetar i AKK, Leon Duhanaj, Alumni i UBT-së.

Nga penalistët e cekur më lartë në Konferencë e sotshme u tha se; krahas shumë njohurive të dëshmuara shkencore, akademike dhe politike për rolin e paanashkalueshëm, për krijimin e shteteve shqiptare, SHBA-të, njëherit kanë luajtur dhe po luajnë rol jetik në konsolidimin edhe rimëkëmbjen e shteteve por edhe mbështetjen e shqiptarëve në të gjitha trojet regjionale dhe në botë, për ti realizuar të drejtat

e tyre kombëtare në përputhje me normat dhe standardet demokratike. Në këtë kuptim, kjo Konferencë do të ndriçojë edhe rolin e shumë zyrtarëve lartë të cilët deri më tani nuk ishin ndriçuar për kontributin dhe rolin që kanë pasur në rrugëtimin e gjatë të shtetformimeve të shqiptarëve, që u vazhduan me mbështetjen dhe formimin e shtetit të pavarur të Kosovës më 2008. Konferenca zbardhi edhe disa shkaqe dhe fakte të cilat dëshmojnë përkushtimin amerikan për zgjidhjen demokratike të drejtës natyrore për formimin e shteteve dhe integritetit të tyre në BE dhe Aleancën Veriatlantike. Panelistët, mes tjerash theksuan se obligimet që duhet kryer shqiptarët nuk duhet të vihen barë SHBA-së, ngase shqiptarët duhet, krahas vlerave të veta të krijojnë kulturën e vlerave amerikane nëse dëshirojnë të që për çështjet e duhura të bëjnë veprimet e duhura.



REVISTA "JOURNAL OF CIVIL ENGINEERING AND ARCHITECTURE", ANGAZHON SI RECENSENT PROF. SADIKUN

Prishtinë 28 maj 2013- Gjatë kësaj jave, revista shkencore amerikane "Journal of Civil Engineering and Architecture" ka njoftuar can. dr. Arbër Sadikun, se pas shqyrtimit të dosjes së tij me publikime, punën profesionale dhe akademike, ka vendosur që ta angazhojë si recensues së punimeve shkencore të kësaj reviste për sferën shkencore të cilën ai mbulon, dmth arkitekturën.

Revista shkencore "Journal of Civil Engineering and Architecture" është një nga revistat më prestigjioze në ShBA, ka ISSN1934-7359, dhe indeksohet nga disa prej data-bazave më të rëndësishme ndërkombëtare si: Database of EBSCO, Massachusetts, USA, Cambridge Science Abstracts (CSA), Chinese Database of CEPS, American Federal Computer Library Center (OCLC), USA, Chinese Scientific Journals Database, VIP Corporation, Chongqing, China, Summon Serials Solutions, Ulrich's Periodicals Directory, Norwegian Social Science Data Services

Can. dr. Arbër Sadiku, njëheri është edhe profesor i rregullt në Departamentin e Arkitekturës në UBT.

UBT KA SJELLË ROBOTËT E GJENERATËS SË FUNDIT TË NAO-së NË REPUBLIKËN E KOSOVËS



Prishtinë, 13 prill 2013 – Përveç vendeve nga Evropa, UBT është Universiteti i vetëm nga Republika e Kosovës dhe rajoni që ka sjellë robotet e gjeneratës së fundit të NAO-së në Republikën e Kosovës dhe në tërë Ballkanin, u tha në konferencë e organizuar me media, e cila u mbajt në ambientet e Universitetit UBT, në Prishtinë.

Në këtë konferencë Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, bashkërisht me prof. dr. Peter Kopacek nga Universiteti Teknik i Vjenës dhe Dekani i Departamentit të Mekatronikës, dr. Muzafer Shala, dhanë detaje rreth robotëve të rinj dhe sjelljen dhe rëndësinë e tyre në vendin tonë.

“NOA janë teknologjia e fundit e robotëve Humanoid, dhe sipas bisedës që kam pas me kompaninë në Paris, këta robotë vijnë

për herë të parë në Ballkan. Ky është një lajm i ri dhe më pozitiv për vendin tonë”, tha Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

UBT me fushën e robotikës është mjaft moti e familjarizuar, ku në kuadër të Departamenti të Mekatronikës, është edhe laborator me modernitet që ekziston, jo vetëm në vend, por edhe në regjion, dhe aty janë të vendosur të gjitha llojet e robotëve, duke filluar nga robotët industrialë, robotët që luajnë futboll, e tash edhe robotët që po i prezantojmë sot.

UBT në gara të futbollit me robotë në nivel të Evropës, ka marrë vendin e parë, dhe besojmë se me robotët e porsaardhur do të marrim pjesë për Kupën Evropiane dhe botërore, dhe besojmë që edhe suksesi nuk do të na mungojë.

Diku rreth 20 universitete më të mëdha në botë e kanë këtë teknologji, ku në kuadër të këtyre universiteteve po hyn edhe UBT, dhe tash e tutje studentët dhe stafi i këtij Universiteti kanë mundësi dhe qasje në teknologjinë më të re shkencore dhe profesionale.

Prof. Dr. Peter Kopacek nga Universiteti Teknik i Vjenës, njëkohësisht profesor edhe në Universitetin UBT, tha se e vërteta është që robotët vetëm kanë hy në Kosovë, dhe ne po e zhvillojmë një teknologji të re, edhe në këtë rast robotët Humanoid janë si shembull shumë i mirë për fushën e mekatronikës.

“Mendoj dhe besoj që deri pas 10 viteve çdo kompani e Kosovës do të ketë robotë të tillë, dhe detyra ime dhe e shefit të UBT-së

është që studentët t’i shërbejmë me teknologjinë e fundit në këtë drejtim, sepse universitetet duhet të mendojnë më herët për të ardhmen e zhvillimit të vendit në të gjitha sektorët në përgjithësi, e më shumë atë të teknologjisë. UBT ka Laboratorë e Mekatronikës, dhe ai laborator do të jetë shtëpia e ardhshme e këtyre robotëve.

Ndërsa Dr. Muzave Shala, përveç që bëri prezantimin dhe punën hulumtuuese që po bëhet në Departamentin Mekatronikës, si në pjesën e robotikës dhe në atë të sistemeve industriale, bëri edhe ndërlidhjen e robotëve të porsaardhur, të cilët ofrojnë mundësi të hulumtimit në fusha të ndryshme si atë në shkenca kompjuterike dhe në shkenca tjera.

Kurse Kushtrim Dragusha, ligjëruese në këtë Departament, tha se interkomunikimi mes njeriut dhe robotit mundësohet përmes sensorëve të cilët janë të montuar në robot dhe këta sensorë mundësojnë prej komunikimit me zë dhe marrjes së komandave nga njeriu, gjithashtu mundësi të komandimit edhe me pamje përmes kamerave. Komunikimi me njeriun roboti e bënë përmes LED dritave altoparlan- teve, që të jetë më natyrale. Fuqia e procesimit të të dhënave është e madhe dhe mundëson komunikim në kohë reale mes robotit dhe njeriut. Gjithashtu roboti ka censorin e drejtimit – qëndrimin në mënyre që të detektojë se në cilën pozitë është dhe në rastet e rrëzimit të tij ngrihet në pozitën normale.

PROF. DR. PETER KOPACEK DISKUTOI ME STUDENTËT E UBT-së



Prishtinë, 11 mars 2013 - “Mekatronika dhe robotika sot dhe në të ardhmen”, ishte tema e radhës, për të cilën, para studentëve dhe stafit akademik të UBT-së, ligjëroj prof. dr. techn. dr. hc. mult. Peter Kopacek.

Të pranishëm në debat, përveç studentëve dhe profesorëve të UBT-së, morën pjesë edhe njohës tjerë të shquar nga bota ndërkombëtare nga fusha e robotikës, mekatronikës e shkencës në përgjithësi, të cilët e përcollën me interesim debatin.

Më konkretisht profesor Kopaceku, gjatë kësaj ligjërate ka shtjelluar çështjen kritike në relacion të zhvillimeve në lëmin e robotikës në përgjithësi dhe mekatronikës në veçanti, duke filluar me prezantimin e filleve të kësaj lëmie si arsyeja dhe nevoja e krijimit të saj në tregun e edukimit internacional, puna për krijimin dhe impaktin e saj në treg pas krijimit, dhe sukseset e inxhinierëve të kësaj lëmie në plotësimin e nevojave të tregut me inxhinier profesionistë të mekatronikës.

Ndër të tjerat prof. Kopaceku, ka shtjelluar edhe trendet botërore të kësaj dege studimi, problemet dhe përparësitë mes tyre, por aplikimi i mekatronikës në treg, industri dhe edukim, ishte një pjesë shumë e veçantë e prezantimit duke promovuar edhe fushëveprimet e kësaj lëmie në industri dhe rëndësia e saj për edukimin e brezave të rinj.

Po ashtu, profesori në fjalë, me theks të veçantë foli rreth arritjeve, problemeve dhe rrugë zgjidhjet në inteligjencën artificiale të robotëve apo pajisjeve në përgjithësi dhe kostot benefite mes automatizimit total të sistemit dhe atij pjesërisht, duke llogaritur edhe përgjegjësin mbi punësimin e fuqisë punëtore të racës njerëzore, duke pretenduar edhe në rëndësin e madhe në ambientin shoqëror ekonomik të pajisjeve.

Profesor Kopaceku, zhvilloi dhe përgjigjen në vijim të debatit edhe në një varg pyetjesh e çështjesh të shtruar për diskutim nga pjesëmarrësit, profesorët dhe studentët e UBT-së.

NGA UBT PËR VAZHDIM TË STUDIMEVE JASHTË VENDIT

KTHEHET DURIMI, SHKON LAVDIMI, ME BURSË PËR VAZHDIMIN E STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN GJØVIK

Lavdim Menxhiqi, i cili dy vite e gjysmë të studimeve themelore i ka përfunduar në Departamentin Shkenca Kompjuterike në UBT, për vazhdimin e semestrit të gjashtë apo të fundit, për vitin akademik 2012-2013, ka fituar bursë të plotë, dhe ka nisë ligjëratat në Universitetin Gjøvik në Republikën e Norvegjisë, në Departamentin e Shkencave Kompjuterike, më konkretisht për specializimin e programeve Game programming dhe Information Security.

Lavdimi është mirënjohës për pedagogët dhe UBT –në

Gjatë studimeve në UBT, kam marrë njohuri të shumta sidomos në lëmin e programimit, network-ut, sigurisë së rrjetave, mirëmbajtjen e harduerit, të robotit, etj, etj, nga profesorët si Fatos Maxhuni, Arian Celina, Fisnik Prekazi, Petrit Shala, Selman Haxhijaha, Bertan Karahoda, etj. Gjithashtu, kam qenë pjesë e ekipit «UBT-Kosova», në lojërat «Robot Soccer» që u patën mbajtur në UBT, gjatë viti 2011, dhe patëm fituar vendin e parë në Evropë. Dhe tash jam shumë mirënjohës ndaj programit AEP, e sidomos ndaj UBT-së, që më ka mundësuar t'i vazhdoj studimet jashtë vendit, pikërisht në Universitetin Gjøvik. Menxhiqi, shton se pas përfundimit të këtij semestri, mendoj të kthehem në vend, të diplomojë, dhe të vazhdoj studimet Master po në UBT.



LAVDIM MENXHIQI

Durimi me bursë të plotë përfundoi një pjesë të studimeve në Universitetin Gjøvik

Durim Jusaj, në vitin e kaluar ka qenë përfitues i bursës në fjalë, i cili dy vitet e para të studimeve i ka përfunduar në Departamentin Shkenca Kompjuterike në UBT, kurse semestrin e parafundit, në Universitetin Gjøvik në Republikën e Norvegjisë, në Departamentin e Shkencave Kompjuterike, më konkretisht

për specializimin e të gjitha lëndëve për programimin e lojërave, ku Jusaj para pak ditësh është kthyer në UBT, për vazhdimin e studimeve të pjesës së fundit.

UBT i vetmi privat në vend që është përfituese i projektit AEP

Këtë mundësi studentëve në fjalë u ka mundësuar vetëm UBT-ja, që është i vetmi universitet privat në vend, që është përfituese e projektit "Academic



DURIM JUSAJ

Exchange for Progress (AEP), projekt i financuar nga Qeveria Norvegjeze, ku partneri kryesor akademik i këtij projekti është Universiteti Gjøvik.

UBT, këtë vit dhe për tre vitet e ardhshme është përfitues i projektit Academic Exchange for Progress (AEP), i financuar nga Qeveria Norvegjeze, dhe nga ky projekt përfiton stafi akademik dhe studentët e UBT, në të gjitha nivelet e studimit. Partneri

akademik nga Norvegjia është Gjøvik University College. Ky projekt ka për qëllim avancimin në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.

Përveç UBT-së, në kuadër të këtij përfshihen edhe disa universitete nga rajoni, por vlen të theksohet se UBT është i vetëm privat nga Kosova dhe rajoni që është përfituese nga ky projekt.

HEKURAN POPAJ ZGJEDHET KRYETAR I ORGANIZATËS STUDENTORE TË UBT-së



Prishtinë, 23 prill 2013 - Në garë për postin e Kryetarit të Organizatës Studentore të UBT-së, ishin si Alban Misini, Hekuran Popaj, Rrezart Prebreza, Florian Pirraj, Hana Govori dhe Oktaj Agushi.

Pas votimit nga 24 anëtarëve, para komisionit dhe anëtarëve verifikues e para të pranishmëve tjerë, u numëruan votat ku Kryetar i Organizatës Studentore të UBT-së, u zgjodh Hekuran Popaj, kurse nënkryetarë u zgjodh Alban Misini, dhe anëtarët e Kryesisë si Rrezart Prebreza, Florina Pirraj, Hana Govori dhe Oktaj Agushi.

Në emër të kësaj organizate për Këshillin Akademik të UBT-së u zgjodh Kaltrina Matoshi, kurse për Këshillat e Fakulteteve u zgjodhën si: Dodona Blakaj, Kaltrina Mehmeti, Edon Saki-raqa, Fatmir Prekupi, Majlinda Hajrizi dhe Bardhyl Hyseni, kurse anëtar i

Këshillit të Cilësisë u emërua Durim Dabiqaj, dhe përfaqësuesit për Komisionet e Cilësisë nëpër Fakultete dhe ndër të zgjedhurit janë si; Drenusha Thaqi, Labinot Krasniqi, Oket Hoxha, Shpat Graiqevci, Liridon Ajeti dhe Shqiponjë Jonuzi.

Hekuran Popaj, nga Prizreni, shkollën e mesme e ka përfunduar në vendlindje në Kolegjin Mehmet Akifi, kurse tash është student i rregullt në UBT në Departamentin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në vitin e II-të. Përveç studimeve Hekurani, merret me sporte të shumta si basketboll, futboll etj etj..

Po ashtu Popaj, para të pranishmëve citoi disa aktivitete të cilat mendon t'i realizoj gjatë udhëheqjes së tij si vizita studimore jashtë dhe brenda vendit, gara të shumta, përfaqësime etj.

UBT E KA ANËTARËSUAR REPUBLIKËN E KOSOVËS NË EUROSIM

Prishtinë, 20 maj 2013 – Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë qëndrimit të tij një javorë në Vjenë të Austrisë, ka marrë pjesë edhe në takimin vjetor të Bordit të Federatës Evropiane e Asociacionit të Simulimeve (EUROSIM), e cila merret me modelim dhe simulim.

Në këtë takim, Bordi i EUROSIM, njëzëri ka aprovuar aplikacionin për tu bërë Republika e Kosovës anëtare e kësaj Federate, përmes UBT-së.

Duke qenë pjesëmarrës në Këshillin vjetor të EUROSIM, Presidenti i UBT-së, dr. Hajrizi ka prezantuar punën e UBT-së, konferencat dhe takimet e tjera me karakter ndërkombëtar që ka organizuar UBT, me mjaft sukses dhe duke mbledhur në Prishtinë emra të shquar të shkencës dhe ekspertë nga e gjithë bota.

Sipas tij, pas anëtarësimit në organizatën EUROSIM, hapet një dritare për komunitetin akademik të UBT-së, të cilët mund të marrin pjesë në konferencat shkencore që organizon EUROSIM, dhe në forume të tjera ndërkombëtare.



KOSOVA PJESËMARRËSE NË TAKIMIN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË IPMA-së



Prishtinë, 25 prill 2013 - Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka marrë pjesë dhe ka përfaqësuar Republikën e Kosovës në takimin e radhës në Asambleshë e përgjithshme të Organizatës Ndërkombëtare për Menaxhimin e Projekteve (IPMA), si dhe në Bordin e Certifikimit, i cili u mbajt në Varshavë të Polonisë.

Republika e Kosovës, tani më fal angazhimit të madh të dr. Hajrizit, ka arritur të anëtarësohet në këtë organizatë shumë të rëndësishme profesionale dhe shkencore për menaxhimin e projekteve.

Gjatë takimit, dr. Hajrizi, kishte takime të ndryshme me përfaqësues të vendeve anëtare në IPMA, dhe përpos konfirmimit të bashkëpunimit të ngushtë u vendos që në këtë vit të behet edhe validimi i qendrës për Certifikim të personave për menaxhimin e Projekteve, si

qendra e parë dhe e vetmja në Kosovë, të mbështet Kosova në formimin e sesionit për të rinjtë "Young Crew Kosova" si dhe aktivitet tjera me interes.

Certifikimi i radhës u mbajt për dy ditë me radhë, gjatë muajit prill, në Prishtinë, dhe atë në gjuhën shqipe. Të gjithë të interesuarit mund të kontaktojnë në info@kosovamanagement.com, për tu informuar apo aplikuar për certifikim

IPMA është organizatë në nivel botërore në fushën e Menaxhimit të Projekteve, e cila certifikon menaxherët e projekteve, krijon ekipe për menaxhimin e projekteve dhe hulumtues të suksesshëm, si dhe nxjerr publikime të ndryshme lidhur me menaxhimin e projekteve.

UBT është anëtar me të drejta të plotë në IPMA, i anëtarësuar me votat e shumicës së vendeve anëtare.

VAZHDON BASHKËPUNIMI NDËRMJET UBT-së, QUALITY KOSOVËS, QUALITY AUSTRISË DHE EOQ-së

Prishtinë 24 prill 2013 - UBT- "Quality Kosova" dhe "Quality Austria", vazhdojnë bashkëpunimin në fushën e trajnimit dhe certifikimit të personave dhe Sistemeve sipas standardeve ndërkombëtare dhe atyre evropiane.

Kjo u bë e ditur gjatë takimit vjetor që u organizua nga "Quality Austria" në Salzburg të Austrisë, ku Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ishte i ftuar të merrte pjesë në rolin e ekspertit për menaxhimin e cilësisë.

Prof. dr. Edmond Hajrizi, është njeriu i parë i akredituar në regjionin shqipfolës për trajnimin dhe certifikimin e personave, për menaxhimin e cilësisë dhe auditim sipas skenës së "Quality Austria" dhe Organizatës për Cilësi në Evropë.

Kjo ka bërë të mundur që personat e interesuar të certi-



fikohen edhe në gjuhën Shqipe. Kjo skemë tani ka filluar të futet edhe përbrenda studimeve të UBT-së, ashtu që çdo student i UBT-së, mund të studion, trajnohet dhe njëkohësisht të certifikohet për

menaxhimin dhe auditim, të sistemeve të cilësisë. Kjo është bërë e mundur falë përkushtimit të Presidentit të UBT-së, dr. Hajrizit, duke nënshkruar marrëveshje adekuate me "Quality Austrinë".

Në kuadër të këtij angazhimi të Presidentit të UBT-së, në vitin 2006, është formuar edhe "Quality Kosova" si asosacion profesional për Menaxhimin, Cilësi, standard, certifikim dhe konfirmim.

Kjo organizatë tani përfaqëson Kosovën në Organizatën Evropiane për Cilësi, me çka edhe mundon ndërlidhjen e Kosovës dhe shqiptarëve në forume dhe nivelet më të larta profesionale e shkencore në Evropë.

UBT PREZANTOI SUKSESSHËM PËR REZULTATET E SAJ NË SEECEL

Prishtinë, 29 prill 2013 - Gjatë këtyre ditëve në Dubrovnik të Kroacisë, është organizuar kampi i ndërmarrësis në kuadër të përmbylljes së fazës së parë të projektit regional për mësimin e ndërmarrësis (SEECEL).

Në këtë Konferencë morën pjesë përfaqësues nga Komisioni Evropian, ETF, Qeveria Kroate, po ashtu edhe përfaqësues e tetë vendeve të regionit të Evropës Juglindore, si dhe institucionet pjesëmarrëse në projektet pilot.

UBT në kuadër të SEECEL, ka qenë po ashtu pjesë e projekti pilot për vendosjen e mësimin të ndërmarrësisë tek shkollat jobiznisore, dhe për këtë arsye ishte ftuar të marrë pjesë në këtë event të rëndësishëm. UBT u përfaqësua nga Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, Dekani i Fakultetit të Metronikës, dr. Muzafer Shala, si dhe studenti Durim Dabiqaj.

UBT prezantoi rezultatet e dala të projektit përmes punimeve shumë interesante dhe inovative të studentëve, si shembuj konkrete se si mund me të vërtetë të përfitohet nga studime që përbajnë elemente interdisciplinare dhe duke e ndërlidhur teknologjinë dhe ndërmarrësin në kuadër të korikules.

Gjate takimit u prezantua edhe faza e dyte e këtij projekti, ku UBT do të jetë përsëri pjesëmarrëse aktive në te, por tani me një dimension edhe më të madh.



CEC - UNIVERSITETI TEKNOLOGJIK I VJENËS VIZITOI UBT- në

Prishtinë 2 maj 2013- Drejtoresha e përgjithshme nga Qendra për Edukim të vazhdueshëm, znj. Petra Aigner, nga Universiteti Teknologjik i Vjenës, ka vizituar Universitetin UBT, për të shikuar të arriturat e këtij institucioni, dhe njëkohësisht ka biseduar me të parin e UBT-së, dr. Hajrizin, për mundësinë e bashkëpunimit në të gjitha sektorët, por me theks të veçantë në fushën e manexhimit dhe atë të inxhinierisë.



FILLOI INTERNSHIPI I STUDENTËVE TË UBT-së

Prishtinë, 28 mars 2013 –Qendra për Karrierë dhe Internship në UBT, në bashkëpunim me Innovation Lab, UNICEF, kanë filluar fazën e intervistimit për internship, në programet Android Application Developer dhe PHP Developer.

Më saktësisht kjo Qendër ka për qëllim që t'i ndihmojë studentët e vitit të II dhe III- të të Shkencave Kompjuterike, që të ndërlidhin procesin akademik me praktikën profesionale e cila i mundëson ata të marrin njohuri në fusha të caktuara të cilat janë me interes për zhvillimin e tyre personal.

“Këtë vit ne do të gjejmë forma të ndryshme të bashkëpunimit me të gjithë partnerët tanë me qëllim që të përgatisim studentët ti qasën me sukses tregut të punës”, tha Udhëheqësi i Qendrës për Karrierë dhe Internship, z. Halil Bashota.



IPKOF FOUNDATION BASHKËPUNON NGUSHTË ME UBT-në

Prishtinë, 28 mars 2013 –Përfaqësuesit kompanisë më profitabile në vend si “IpkoFoundation”, para studentëve të UBT-së, prezantuan, ku në këtë rast e veçuan projektin për ndarjen e bursave në nivelin universitar.

Gjatë prezantimit ata cekën të gjitha kriteret për marrjen e kësaj shumë si notën mesatare, disa ese të shkruar dhe të përpiluar për vizionin e tyre me theks të veçantë për sektorin e teknologjisë, përvoja e punës së mëhershme etj.

Siç u theksua edhe në fillim se, mënyra e vlerësimit për ndarjen e bursave nga ana e jurisë është transparente, dhe shumica e bursës së studimeve nga kompania “IpkoFoundation”, ka në vlerë me

mbi 80% të pagesës së semestrit për vitin akademik.

Studentët të cilët do kenë fatin të jenë përfitues të bursave gjatë vitit akademik do kenë aktivitete të shumta si koktej, darka dhe vizita nga vendet më të ndryshme.

Vlen të theksohet se në vitet e kaluar përfitues të bursave në fjalë kanë qenë këta student të UBT-së si: Anesa Ramaxhiu dhe Valbona Fejzullahu për vitin akademik 2009/ 2010, Besfort Ajeti për vitin akademik 2010/ 2011, dy vitet me radhë Arian Agani, Kreshnik Ismaili 2011/ 2012, dhe Fatos Sylaj, Trim Kadriu dhe Besfor Ajeti, ishin fituesit e bursave të 2012/2013.

UBT NË VAZHDIMËSI BASHKËPUNON ME USAID-in

Prishtinë, 18 prill 2013- Studentët e Departamentit të Juridikut të UBT-së, patën rastin të mësojnë më shumë rreth strukturës së gjykatave dhe prokurorive në Kosovë. Në bashkëpunim me Programin për Sundimin Efektiv të Ligjit (EROL) të USAID-it. UBT organizoi takimin ku përfaqësues të EROL prezantuan informacione për gjykatat, prokuroritë dhe mundësitë për karrierë në sektorin e drejtësisë në vend.

Takimin e hapì prodedekani i Departamentit të Juridikut në UBT, z. Ardian Emini, i cili theksoi sa e rëndësishme është për studentët e juridikut të kenë më shumë informacion rreth gjykatave, prokurorive dhe profesioneve të ndryshme në lëminë në mënyrë që ta kenë më të lehtë të zgjedhin orientimin e dëshiruar.

Nga ana tjetër, zëvendës-presidenti i UBT-së, prof. dr. Mo Vaziri, iu foli studentëve për fusha të ndryshme të ekspertizës ligjore, duke u fokusuar tek ndryshimet që ka pësuar praktika dhe lëvizja nga krimi i 'jakave blu' drejt një shtimi të rasteve të krimit nga 'jakat e bardha' dhe sa e rëndë-



sishme është që të hetohet dhe luftohet ky lloj i krimit për të ndërtuar një shoqëri të drejtë për të gjithë.

Në këtë takim, përfaqësueset e programit EROL iu prezantuan studentëve cila është struktura e re e gjykatave dhe e prokurorive dhe se 'qëllimi i këtij ristu-

rimi është që të ketë më shumë efikasitet, transparencë dhe qasje të barabartë për të gjithë në sistemin e drejtësisë.' Gjithashtu, studentët mësuuan rreth profesioneve të ndryshme që ata mund t'i zgjedhin në të ardhmen si karrierë e tyre, si prokurorë, gjyqtarë, avokatë, apo noterë dhe se çfarë rrugësh duhet të ndjekin dhe pro-

vime duhet të japin për të realizuar ëndrrën e tyre profesionale.

Pas takimit, përfaqësuesit e programit EROL shpërndanë dhe broshurat e përgatitura për të rinj 'Zgjidh profesionin tënd', 'Çfarë është provimi i jurisprudence' dhe 'Vlerësimi dhe njohja e diplomave'.



STUDENTËT E JURIDIKUT VIZITUAN GJYKATËN THEMELORE TË PRISHTINËS

Prishtinë, 17 maj 2013- Studentët e Departamenti të Juridikut në UBT, bashkërisht me can. dr. Ardian Emini, gjatë këtij muaji kanë zhvilluar mbi katër vizita vëzhguese në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Lidhur me këtë, studentët u njoftuan për së afërmi për rolin dhe funksionin e seancave gjyqësore, si institucionit autoritativ, inicimit të procedurës paraprake dhe në senacën e dytë u njohën me nxjerrjen e aktgjykimit dhe shqiptimin e dënimit palëve të involvuara në rast.



STUDENTËT E DEPARTAMENTIT TË JURIDIKUT REALIZUAN SEANCËN E IMPROVIZUAR

Prishtinë, 1 mars 2013- Studentet e vitit të III-të të Departamentit të Juridikut në UBT, morën pjesë në Seancën e improvizuar gjyqësore, në lëndën e Drejta e Procedurës Penale.

Seancën nga afër patën rastin ta ndjekin edhe Zëvendës-presidenti i UBT-së, prof. dr. Mo Vaziri, Prodekani i Departamentit të Juridikut, prof. Emrush Ujkani, si dhe një numri i caktuar i profesorëve dhe studentët të këtij Departamenti.

Në fjalën e tij hyrëse të seancës prof. dr. Mo Vaziri, theksoj rëndësinë që ka një simulim i tillë duke i inkurajuar dhe uruar studentët që në të ardhmen të jenë pjesë edhe e garave të karakterit ndërkombëtar. Ai ndër të tjera shtoi se kjo është arsyeja kryesore pse të rinjtë, ata të cilët duan të studion drejtësinë duhet të vijnë në UBT.

Nga ana e tij prof. Emrush Ujkani, shtoi ndër të tjera se për studentet e Departamentit të Juridikut, kjo është një arritje e

suksesshme, duke përgëzuar në veçanti studentët të cilët ishin pjesë aktive e një simulimi të tillë por gjithashtu duke e vlerësuar teje mase punën e pa lodhshme të prof. Lavdim Krasniqi, të cilit për të arritur tek një gjë e tillë iu kishin dashur javë të tëra.

Kurse, Prof. Lavdim Krasniqi i cili bëri një hyrje lidhur me rastin i cili do jetë pjesë e simulimit dhe potencoi faktin se një procedurë e tillë është adoptuar plotësisht ndryshimeve të reja më Kodin e Procedurës Penale. Ai pastaj ftoj studentët të cilët morën rolet e veta përkatëse, tre nga studentet ishin caktuar në cilësinë e panelit gjyqësor duke përfshirë edhe kryetarin e trupit gjykues, njëri në cilësinë e prokurorit dhe njëri në cilësinë e avokatit të palës së akuzuar. Natyrisht në një seancë të tillë nuk munguan as dëshmitarët e ndryshëm që në një mënyrë apo tjetër ndërlidheshin me rastin e simuluar.





Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informativ
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negocimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktit
- Aqvi Comunnitëre e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatie
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

Teknologji Informativ

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.

Kredi për studentë



**Raiffeisen
BANK**

...JETO MË MIRË

Financoni studimet tuaja

- Norma të volitshme interesi
 - 10,000 Euro deri në 5 vjet
 - 0% - shpenzime administrative

www.raiffeisen-kosovo.com
Raiffeisen Direct: 038 222 222

DR. EDMOND HAJRIZI NË FORUMIN BROWN

Prishtinë, 26 prill 2013 - Në këtë Forum të rëndësishëm, Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, u takua me krerë të rëndësishëm të Qeverisë Amerikane dhe asaj Kroate, me ndërmarrës të suksesshëm nga rajoni dhe SHBA –të, si dhe me udhëheqës të ndryshëm të institucioneve arsimore në rajon.

Përpos ambasadorëve amerikan në Kroaci dhe Shqipëri, ministrave të Qeverisë Kroate, në Forumin BROWN, ishte prezent edhe i ngarkuari për punë në Ballkan nga Qeveria Obama, z. Filip Reeker.

Nga organizatorët e forumit në fjalë, u konfirmua se në vitet e ardhshme edhe studentët e UBT-së mund të marrin pjesë në garën për ndërmarrësi e cila zhvillohet në kuadër të këtij forumi.



DR. HAJRIZI NË KONFERENCË NË PODGORICË

Prishtinë, 18 prill 2013- “Veglat dhe Metodët e Menaxhimit në Arsimin e Lartë”, është tema e kumtesës për të cilën ka folur Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hjarizi, në konferencën e organizuar nga Projekti i Komisionit Evropian “Erasmus Mundus” - SIGMA, ku punime e saja kanë nisur dje dhe do të përfundojnë më 19 prill, në Podgoricë të Malit të Zi.

Në këtë tubim, përveç Presidentit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hjarizi, kanë marrë pjesë edhe

të gjitha universitetet partnere në SIGMA si: City University në Londër të Anglisë, Freie University në Berlin të Gjermanisë, Lund University në Suedi, University of Milan në Itali, Warsaë University në Poloni, Warcklaë Technical University në

Poloni, University of Monetpolier II në Francë, Twente University në Irlandë, Shkodra University në Shqipëri, University of Belgrade, Serbi, University of Montenegro në Malin e Zi, University of Nis në Serbi, University of Novi Sa në

Serbi, University of Prishtina në Kosovë, University of Sarajevo, Bosnia dhe Herzegovina, University “St. Kliment Ohridski”, Bitola, FYR of Macedonia, University of Tuzla në Bosnja dhe Hercegovina dhe ekspertë nga Evropa.

UBT PËRGATIT ZYRTARËT E UN HABITATIT TË KOMUNAVE PËR MENAXHIMIN E PROJEKTEVE

Prishtinë, 23 prill 2013 – UBT përfundoi me sukses të plotë trajnimin për zyrtarët e UN Habitatit dhe komunave të ndryshme në fushën e Menaxhimit të Projekteve.

Për pesë muajt e fundit, duke filluar nga tetori i vitit 2012, dhe pas tetë moduleve të mbajtura, 30 zyrtarët e institucionit të UN Habitatit dhe përfaqësuesit e komunave relevante e përfunduan me sukses trajnimin në fjalë.

Gjatë kësaj kohe personat pjesëmarrës janë ngritur në aspektin teorik dhe praktik të menaxhimit, udhëheqjes, negociimit dhe menaxhimit të projekteve dhe ekziston bindja se ata do të jenë në gjendje që në mënyrë profesionale të planifikojnë, organizojnë, implementojnë dhe përmbyllin projektet, tha Dr. Krasniqi.

Të gjithë personat pjesëmarrës, së shpejti në një ceremoni solemne, do të pajisen edhe Certifikate nga UBT, për pjesëmarrje të suksesshme në trajnimin e përmendur.

Zyrtarët e UN Habitatit, ndryshe u trajnuan nga Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Prof. Dr. Ibrahim Krasniqi, dhe Can. Dr. Besnik Skenderi.



DR. HAJRIZI MODEROI TRYEZËN PËR TREGUN E BRENDSHËM

Prishtinë, 30 prill 2013 - Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, në cilësinë e ekspertit, me ftesë të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Organizatës Gjermane GIZ, është ftuar që të moderoj tryezën për tregun e brendshëm.

Tryezat është organizuar në Durrës në Shqipëri, dhe gjithashtu kanë marrë pjesë përfaqësues të ministrive përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të rregullatorëve të ndryshëm si, nga telekomunikacion, energjia, përfaqësues të komunave, shoqatave të bizneseve, sindikatave, ekspertë të ndryshëm, përfaqësues të shoqërisë civile, etj.

Më konkretisht, ky është një projekt i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i mbështetur nga Organizata GIZ, për të analizuar gjendjen dhe definuar hapat e mëtejshëm për integrimin Republikës së Kosovës në Evropë.

“Nga punëtorja kanë dalë propozime të shumta dhe të qarta, që do të ngritin efikasitetin dhe eficiencën në plotësimin e kriterëve për në integrimin evropian”, citoi Dr. Hajrizi.



ARKITEKTËT E RINJ PREZANTOJNË SUKSESSHËM

Studentët e vitit të parë në Departamentin e Arkitekturës në UBT, në kuadër të Konferencës studentore, që organizohet nga ky institucion, ditë më parë kanë bërë prezantimet e tyre hulumtues në lëndën "Projektimi Arkitektonik I".

"Këto prezantimet kanë qenë hulumtime individuale të studentëve në lidhje me analizën funksionale të objekteve individuale të banimit. Hulumtimi ka përfshirë rreth 60 objekte të banimit në të gjitha anët e Republikës së Kosovës respektivisht nga viset nga vijinë studentët", ka thënë ligjëruesi i lëndës dr. can. Lulzim Beqiri, për gazetën "UBT News".

Prof. Beqiri, më tej shtoi se, analiza funksionale është fokusuar në parametrat në vijim si në analizën e një objekti individual të banimit që ndodhet brenda ose jashtë Republikës së Kosovës, objekt që ka qenë i banueshëm-

nuk ka pas rëndësi etazhiteti dhe lokacioni (zonë urbane, jo urbane, periferi, zonë rurale), dhe në fund është dhënë edhe adresa - lokacionin i objektit. Po ashtu për një hulumtim të tillë janë kërkuar edhe teknikat e prezantimit si, teknikat e lira e që janë: video, programe të ndryshme për prezantim (PowerPoint, publisher etj) dhe prezantimi në letër të formatit të madh (p.sh formatit A0).

Varësisht nga mënyra e prezantimit, studentët kanë dorëzuar prezantimet e tyre në letër dhe CD. Studentët që kanë vendosur që prezantimi i tyre të jetë video kanë përshkruar prezantimin në letër dhe e kanë dorëzuar në CD. Dhe të të dyja llojet e prezantimit, si në letër dhe CD ka pas të shënuar emrin dhe mbiemrin e studentit.

Kurse në përmbajtjen e prezantimit është përfshi edhe analiza e situacionit (parcela, oborri, rruga deri tek objekti) dhe analiza e një-

sive të banimit (të metat dhe përparësitë): erëmbrojtësit, komunikimi (hyrja, shkallët, korridoret), qëndrimi ditorë, kuzhina, trapezaria, dhomat e gjumit, banje, utiliti, depo, gardërobat, bodrumi, garazhe, lloxa, ballkonet, terasa, pwrfundoi Prof. Beqiri.

Gjatë prezantimit të hulumtimeve në fjalë, të pranishëm ishin stafit akademik, studentë dhe mysafirë tjerë, kurse vlerësimi i këtyre punimeve është bërë nga ligjëruesi i lëndës Dr. Can. Lulzim Beqiri.

Në vijim është shënuar lista e studenteve që ishin pjesë e konferencës studentore në Fakultetin e Arkitekturës në UBT si: Abetare Rama, Alban Krasniqi, Albesa Oluri, Albion Vuçitërna, Albulena Memeti, Albulena Doli, Albunit Murati, Ali Aliu, Altin Sylka, Amar Tahiraga, Anduena Hunduzi, Anita Nika, Anita Karaxhi, Ardi Mustafa, Ardian Llugaxhija, Armend Begisholli, Armend Sadiku, Arta



Abdyli, Arxhend Curraj, Aulona Sylejmani, Bardha Brestovci, Ble- rim Maliqaj, Bujar Statovci, Ditnis Zekaj, Dodona Blakaj, Donjeta Duraj, Doruntina Kupina, Dre- nushë Thaçi, Driton Begisholli, Egzona Morina, Elitë Sherifi, El- medina Qajani, Elvis Gusturanaj, Emel Vërbiqi, Fadil Ahmetaj, Fes- tina Mustafa, Filloreta Tafarshiku,

Fistina Bllaca, Florim Kosumi, Ibrahim Krasniqi, Kadri Kras- niqi, Kata Abazi, Learta Stavileci, Luiza Hoxha, Mërgim Shabani, Mërgim Bajramaj, Mergime Kras- niqi, Nora Lika, Qëndrim Mare- vci, Rinor Toska, Ruzhdi Dakaj, Shaindere Krasniqi, Valdet Ma- liqi, Vesa Shasivari, Veton Daka, Vjollcë Krasniqi, Vlora Bajgora.

HULUMTUAN NJË SEMESTËR DHE PREZANTUAN PUNËN E TYRE



Për dy ditë me radhë, mbi 80 studentët të vitit të dytë në Departamentin e Arkitekturës në UBT, në lëndën "Studio Dizajn I", kanë prezantuar hulumtime e tyre me temën "Ndërtesat publike -shkol- la, hoteli, ministria", te profesorët dhe asistentja, dhe në të njëjtën kohë që të dy ishin mbikëqyrësit

e këtyre hulumtimeve prof. dr. Binak Beqaj dhe cand. msc. Vlora Aliu.

"Hulumtimi është realizuar përmes këtyre fazave si: analizat e lokacionit, struktura e organizimit të detyrës projektuese, dizajnimi dhe prezantimi i projektit, kurse

deri te realizimi është dashtë të punohet një semestër akademik dhe realizimi është bazuar në ele- mentet konceptuale si në analizën urbane, funksionale, konstruktive, ekonomizimit dhe estetike", tha profesori i lëndës, dr. Beqaj, duke shtuar se projektet janë realizuar me një qasje të punës sistematike dhe zgjidhjet e ideve kanë qenë të lloj- llojshme duke përcaktuar lokacionet e përzgjedhura në qytetin e Prishtinës.

Kurse asistentja e lëndës, znj. Aliu tha se, projektet kishin vlera relativisht të mira, sidomos kur kihet parasysh metodologjia e punës-teknika e projektimit me dorë dhe finalizimi me tush. Por karakteristike është aftësia e zotërimit të mirë nga ana e studenteve të teknikës së komunikimit dhe

prezantimit të projektit, përfun- doi ajo për gazetën "UBT News".

Tre vendet më meritore në këto punime të prezantuara janë si: Leonarda Emini, Ard Gashi dhe Arben Lushi.

Në vijim po japim listën e gjithë studentëve që kanë prezantuar!

Vlora Haradinaj, Gentiana Xhe- maili, Dafina Tufa, Mimoza Tolaj, Leonora Thaqi, Valon Cacaj, Anyla Berisha, Ard Gashi, Shkëlqim Is- maili, Leonarda Emini, Bajram Biqkaj, Mevlana Ibrahim, Xheneta Selmani, Leart Jakupi, Blerina Ba- laj, Arben Lushi, Leotrina Hoxha, Adrian Sharku, Blendi Bërdynaj, Alban Misini, Marigona Dragu- sha, Drizona Maçani, Albert Mus- tafa, Blerta Sylka, Sorkadhe Pira,

Florim Gashi, Agon Gacaferri, Labëri Dakaj, Edina Mamusha, Hana Bytyqi, Nita Mala, Arbër Kryeziu, Nexhmije Nuza, Albina Vuthi, Brillantina Bekteshi, Endrit Kadriu, Blendiona Gegollaj, Mah- mut Ajvazi, Arian Sefiu, Krenare Mustafa, Nazif Arifi, Alma Rapuca, Lulzim Cernavëri, Tirana Selimi, Blerta Emini, Barbana Berisha, Qëndresa Gutaj, Valmir Krasniqi, Premtim Reçica, Leonard Rexhe- pi, Rrahim Latifi, Leartë Salihu, Egzona Rexhepi, Rilind Duriqi, Valdrin Murturi, Agon Hoti, Xhevahir Skoro, Alban Azemi, Shkëlqim Maliqi, LedriMahmuti, Rustem Brahimi, Denis Qerimi, Ardian Zymeri, Ideal Kolshi, Mu- harrem Cani, Driton Tahiri, Er- mal Krasniqi, Aida Bakalli, Baton Mekuli, Mirela Qupeva, Fortunë Haziri.

KRASNIQI: STUDENTËT KANË BËRË PUNË TË MIRË

Studentët e Departamentit MBE, në UBT, të viti të III-të, kanë prezantuar hulumtimet në lëndën "Menaxhimi i projekteve", para dhe te prof. dr. Ibrahim Krasniqi dhe asistentja e lëndës msc. Leonita Braha.

Sipas prof. Krasniqit, shumica e studentëve kanë bërë një punë të mirë dhe janë të gatshëm që në mënyrë grupore në të ardhme të planifikojnë dhe realizojnë projekte të natyrave të ndryshme. Kurse, Leonita, tha se punimet e studentëve kanë qenë të nivel të duhur, pasi që studentët për çdo javë, për një semestër me radhë, u është caktuar çka të punojnë në projekte dhe pastaj vlerësimi ka qenë gradual.

Në vijim është lista e studenteve që kane prezantuar ose kane përgatitur projektet e tyre.

Flsnik Kingji, Edona Byci, Bujar Sokoli, Ardiana Hajdaj, Hekuran Alija, Kemaj Qerimi, Ilir Krasniqi, Norik Spahiu, Armend Dubova, De-

nis Berisha, Agron Binakaj, Liridon Dragusha, Argjent Feka, Besart Berisha, Drini Begu, Besim Shala, Drilon Visoka, Avdullah Hoxha, Arbenora Maliqaj, Blerte Gara, Dren Babalia, Granit Shala, Liridon Rafuna, Alor Ejupi, Armend Hasanaj, Suad Ejupi, Valon Rexhepi, Betim Nuha, Kaltrina Abdullahu, Marigona Bekteshi, Don- jeta Abdullahu, Marigona Krasniqi, Aida Sejdiu, Astrit Nrecaj, Edona Grainca, Halime Demiri, Ylli Kras- niqi, Shpresa Gashi, Bujar Kajtazi, Albina Zuka, Teuta Avdirrahmani, Qendresa Krasniqi, Fitore Pacolli, Li- ridon Zeqiri, Shpetim Kryeziu, Habib Rama, Labinot Babatinca, Sabahate Mushica, Lirie Metaj, Fitim Tasholli, Besfort Ajeti, Dielleza Xhemaili, Petrit Hajdari, Bastri Halili, Labinot Bardhi, Kaltrinë Matoshi, Berna Devexhiu, Edona Krasniqi, Gentiana Qevani, Fi- liz Salihu, Resmije Hajredini, Bardha Blakoqori, Fatbardha Bahtiri, Merita Berisha, Qendresa Hurgulica, Qen- dersona Ramadani.

MASTERAT E UBT-SË, TË GATSHËM TË REALIZOJNË PROJEKTE

Studentët e të vitit të I-rë dhe të II-të, në pro- gramit Mastër, në Departamentin MBE, në UBT, sot i janë nënshtruar provimit në lëndën Menaxhimi Ndërkombëtar i projekteve. Hyrja e provimit është procedurë normale por e veçanta është se, të njëjtit parapakisht kanë kryer për- gatitjen e projekteve të tyre gjatë semestrit dhe i kanë prezantuar ato para profesorit të lëndës dhe mbikëqyrësi i realizimit të projekteve prof. dr. Ibrahim Krasniqi.

"Më konkretisht projektet janë nga fusha të ndryshme hulumtuese në kuadër të specifikave studimore të nivelit Master dhe këto projekte janë realizuar brenda afatit dy mujor dhe punës shumë të madhe që e kanë bërë studentet në përgjithësi", tha prof. I. Krasniqi. Ai shton se vlerësimi është bërë nga vet profesori i lëndës por edhe një vlerë- sim formal është bërë edhe nga audiencia gjatë prezantimit. Sipas tij shumica e studentëve kanë bërë një punë të mirë dhe janë të gatshëm që në mënyrë grupore në të ardhme të planifikojnë dhe realizojnë projekte të natyrave të ndryshme.

Në vijim është lista e studenteve që kane prezantuar ose kane përgatitur projektet e tyre: Bashkim Beha, Alim Halimi, Flamur Sadriu, Hana Janjeva, Valmira Hoxha, Miranda Ramnabaja,

Tringa Hoda, Njomza Prestreshi, Besarta Boroci, Arlinda Baraliu, Donika Bucaliu, Dren Nallbani, Kushtrim Klaiqi, Doruntina Haliti, Granit Shala, Kastriot Ramabaja, Burim Tmava, Diturie Ceka, Florida Shatri, Leonora Dragobuzhda, Ylifidane Lushta, Antigona Shuperka, Abetare Rexha, Besim Paqarizi, Drin Mormorina, Fjolla Matu- sha, Doruntina Smolica, Tringe Hyseni, Valeza Gela, Qendresa balaj, Nora Hasani, Visar Ahme- ti, Agron Kamberi, Faton Hasolli, Bekim Bojku, Diana Salihu, Adelina Jakupi, Blerta Jusaj, Zana Baraku, Shkelqim Jusaj, Ismajl Shabani, Shefki Svarqa, Labinot Krasniqi, Gentian Ahmeti, Arben Sadriu, Mirlinda Jashanica, Majlinda Jemini, Arben Hyseni, Ragip Zejnnullahu, Bujar Sekiraqa, Blerim Sekiraqa, Azem Kajtazi, Arber Rustemi, Shpresa Veseli, Ardian Bytyqim, Faton Karaqi, Ramadan Raka, Bujar Maloku, Argjent Hasani, Teuta Pajaziti, Uran Mujku, Betim Shabani, Bardh Zeka, Gentian Hyseni, Kreshnik Ismajli, Veprim Mustafa, Nasuf Isufi dhe Halil Nallbani.

Kjo paraqet një metodologji të shkëlqyer të bashkëpunimit studentë- profesor dhe ndër- lidhjes së pjesës teorike të mësimdhënies dhe studimit me pjesën praktike të tij e që është për- shëndetur nga studentet e nivelit Master.

NJËQIND VJET NGA VRASJA E PRESIDENTIT KONSTITUCIONAL
TË MEKSIKËS, FRANCISKO MADERO (23 SHKURT 1913 - 2013) (1)

TREGIMI PËR "BANDITIN QË KISHTE REFUZUAR TË

PROF. DR. ZEJNULLAH GRUDA

1. Historia e Meksikës ka disa emra emblematikë jo vetëm për popullin e Meksikës, por edhe për mbarë njerëzimin. Të këtyrë janë Montezuma II, në kohën e të cilit mbretëria e Actekëve kishte arritur kulmin, por edhe ishte shkaktërruar nga pushtuesit spanjollë të udhëhequr nga Kortes; klerikët Miguel Hidalgo dhe Jose Morelos, të cilët njihen për angazhimin e tyre për kthimin e tokës fshatarëve dhe shpalljen e pavarësisë së Meksikës; Benito Juarez (Huarez), presidenti i parë i Meksikës nga radha e indiosëve, që kishte udhëhequr shtetin në një kohë shumë kritike të historisë së tij; Pancho Villa dhe Emiliano Zapata, që ishin vënë në krye të çetave të fshatarëve të varfër, pas vrasjes së presidentit konstitucional të Meksikës Francisco Madero; dhe presidenti Lazaro Cardenas (Kardenas) që njihet për angazhimin e tij të vendosur: për zbatimin e reformës agrare; për nacionalizimin e hekurudhave dhe ndërmarrjeve të industrisë së naftës që ishin në pronësi të kompanive të huaja (1937 - 1938); për gjykimin e aksioneve pushtuese të Italisë dhe Gjermanisë në prag të Luftës së Dytë Botërore; dhe për përkrahjen forcave republikane në Luftën Civile në Spanjë.

Shumica nga këto personalitete janë vrarë për shkak të angazhimit të tyre në favor të masave të gjëra të popullit, për barazi dhe drejtësi sociale dhe për liri, siç është rasti me klerikët Miguel Hidalgo dhe Jose Morelos dhe dy simbolet e peonëve të shtypur dhe tribunët më të mëdhenj të Meksikës - Emiliano Zapata dhe Pancho Villa. Emiliano Zapata kishte vetëm 35 vjet kur u vra në vitin 1919 me pabesi nga një oficer konstitucionalist, që ishte paraqitur si dezertor, i shtyrë nga premtimi i shpërblimit, që Qeveria kishte premtuar për kokën e Zapatës. Të njëjtin fat e kishte pasur edhe Pancho Villa që ishte vrarë pabesisht më 20 korrik 1923 kur kishte vetëm 46 vjet, vrasje që kishte pikëlluar madje edhe ata që e kishin urreyer gjatë jetës.

Megjithëse, Pancho Villa dhe Emiliano Zapata janë vrarë të ri, rëndësia dhe fama e tyre jo vetëm që nuk është zbeh me kalimin e kohës, por përkundrazi vazhdon për të ndikojë edhe sot. Këta kanë vazhduar të evoluojnë e të shndërrohen në figura mitike, kurse kujtimi për ta të nderohet jo vetëm në Meksikë, por edhe në mbarë botën. Për këtë arsye

shumë rrugë në Meksikë dhe në fqinjësi të Meksikës mbajnë emrin e Pancho Villës sikurse që vazhdojnë të këndohen balada për të.

Kjo vlen edhe për bashkohani-kun dhe shokun e Villës për nga idealet, Emiliano Zapata, i cili ka luftuar për të drejtat e fshatarëve të varfër, qysh para shpërthimit të revolucionit meksikan dhe është angazhuar për reformë agrare, ka përhëndetur me shpresa Revolucionin e Tetorit dhe ka qenë idol i miliona peonëve dhe simbol i kryengritjes antif feudale.

Për këtë arsye rekomandohet që kur përmendet Pancho Villa duhet pasur parasysh se në Meksikë e edhe në shumë vende të Amerikës Latine Pancho Villa s'është bandit dhe vagabond qysh më së shpeshti është portretizuar, por sinonim i luftëtarit për të drejtat e vegjëlisë, para së gjithash të fshatarësisë së varfër dhe për barazi sociale. Kjo vlen edhe për prijësin e kryengritjes fshatare në shtetin Morelos Emiliano Sapata (Zapata), prandaj përpjekja për përbaltjen e tyre, megjithëse e kuptueshme nga prizmi i klasave eksploatuese dhe shtypëse, është fyes jo vetëm për ata, por edhe për të gjithë njerëzit liridashës.

2. Pancho Villa më së shpeshti është përshkruar si një vagabond, vrasës, plaçkitës, aventuristë, kokëkrisur, i çartur, i marrë ose si një Robin Hud i ri, i mençur, i zgjuar, i aftë, i shkathët, dhe si hero legjendar dhe tribun i popullit të Meksikës. Për këtë arsye, në disa shkrime këshillohen të huajt, që kur flasin për Villën, specialisht me nortenjos (Meksikanët e veriut të vendit), të mos gabojnë ta nënvlerësojnë respektin që ai gëzon akoma në Meksikë.

Këto cilësime që përmbajnë mjaft të vërteta janë të pashmangshme kur të kihen parasysh faktet që lidhen me lindjen dhe rininë e hershme të tij, por edhe me, më se dy dekada të jetës së tij shumë të bujshme. Pancho Villa ka lindur në San Huan del Rio, të shtetit Durango më 1877, si fëmijë i jashtëligjshëm i një pronari të madh të tokës (Jesus Villa). Emri i tij i vërtetë ishte Doroteo Arango, kurse emrin Pancho Villa e kishte marrë, sipas një rebeli të njohur të kohës, pasi ishte gjind jashtë ligjit, për shkak të vrasjes së një pasaniku, i cili ia kishte dhunuar motrën 12-vjeçare. Pra, Pancho Villa u gjind jashtë ligjit si 16-vjeçar për shkak të vrasjes në mbrojtje të nderit të motrës së vet. Ata që janë marrë me jetën e tij trego-

nin se ai nuk ka pirë alkool deri në vitet e fundit të jetës së tij, por ua lejonte këtë njerëzve të tij. Gjatë festave vallëzonte me femra të re natën në kampet e përkrahësve të tij. Njëra nga gratë e fundit që e ka mbijetuar kishte treguar se ai është martuar zyrtarisht 26 herë.

Ky person, ndryshe nga ç'mund të pritej, do të hyjë në histori kur si shef i bandës së hajnave të bagëtisë, që ishte në kohën kur ka filluar rebelimi në Meksikë më 1910, do t'i bashkohet çështjes maderiste, e cila synonte t'i japë fund diktaturës së egër të gjeneralit Porfirio Diaz, i cili kishte sunduar Meksikën për 33 vjet. Grupi i Pancho Villës do të bëhet shumë shpejt i famshëm, sepse fenomeni i banditizmit që normalisht gjykohej çdo kund, në Meksikën e asaj kohe konsiderohej si shprehje e rebelimit kundër padrejtësive.

Sipas thashethemeve të përhapura, Pancho Villa konsiderohej (portretohej) si dhunues i femrave. Por, në lidhje me këtë Pancho Villa i kishte deklaruar gazetarit të famshëm John Reed (Xhon Rid), që kishte shkruar një libër për ngjarjet dhe personalitetet më të rëndësishme të Meksikës të atëhershme Pancho Villa, Emiliano Zapata, Francisco Madero, Venustiano Carranza, Victoriano Huerta, Alvaro Obregon etj., me titull "Meksika e rebeluar" (Insurgent Mexico), më pastaj edhe librin e famshëm kushtuar Revolucionit të Tetorit "Dhjetë ditë që tronditën botën": "Kur nuk përpiqem fort t'i mohoj tregimet e tilla" dhe kishte vazhduar: "Thonë se jam bandit, gjithashtu. Pra, ju e njihni jetën time. E pra, më thuaj: a ke takuar burrin, prindin ose vëllanë e ndonjë gruaje që kam dhunuar?" ... "Ose madje ndonjë dëshmitar?"

3. Revolucionin meksikan, si edhe shumica e revolucioneve [Revolucioni Rus (i Tetorit), Revolucionin Kinez, Revolucionin Kuban] ka buruar nga padrejtësitë që i goditnin pjesët më të mëdha të popullit të Meksikës, por edhe popujt e tjerë të Amerikës Latine. Kjo gjendje e rëndë e popujve të atjeshëm kishte filluar me ardhjen e evropianëve, të cilët janë përgjegjës kryesorë për gjenocidin mbi indianë, që është gjenocidi më i madh në histori, me ç'rast popullsia autoktone bëhet objekt likuidimesh masive, persekutimesh dhe skllavërimi, e më pastaj edhe mjerimi ekstrem bashkë me melezët (popullsia e përzier) dhe zezakët, që ishin sjellë në kontinentin Amerikan si

skllav. Të gjithë këta fatzi ishin, e edhe sot janë shpesh, viktimat të reaksionit të brendshëm, që e përbëjnë latifondistët (pronarët e mëdhenj të tokës), kleri katolik dhe garniturat reaksionare ushtarake, të cilat mbahen me ndihmën e forcave të jashtme imperialiste.

Ata që kanë studiuar sadopak historinë e Amerikës Latine e dinë se padrejtësitë e mëdha në Meksikë (dhe tërë Amerikën Latine) burojnë nga fakti, se vetëm disa dhjetëra pronarë të mëdhenj të tokës, të lidhur ngushtë me njerëzit në pozita të larta, kishin përvetësuar me dhjetëra miliona hektar tokë, kurse në anën tjetër ishin me miliona peon (fshatarë të varfër) dhe të patokë që punonin me medijtje e që jetonin në koliba të bëra nga balta, druri ose shkurret. Nga këta latifondistë, vetëm tetë pronarë mbanin 22,5 milionë hektarë tokë. Në prag të revolucionit në Meksikë, disa mijëra latifondistë mbanin 97 % të tokës, kurse 400 mijë pronarë të vegjël ndanin pjesën tjetër prej 3 %. Në të njëjtën kohë më shumë se 12 milionë fshatarë ishin pa tokë.

Kjo gjendje që mbretëronte në Meksikë u ngjasonte vendeve të tjera të Amerikës Latine, ku tokat në pronë të latifondistëve gati pa asnjë përjashtim kapnin më shumë se gjysmën e tokës së shteteve përkatëse, e madje diku, si në Paraguai, latifondistët mbanin 93,8 % të tokës; në Çile 73,2 %, e në Argjentinë 74,8 %.

Gjendjes së vështirë të popullsisë së varfër të Meksikës i kishte kontribuar edhe kisha katolike, që edhe vetë ishte pronare e madhe e tokës (në Meksikë ajo mbante më së gjysmën e tokës së puneshme para Revolucionit) me doktrinën e veta për shpërblimet dhe parajsën që i pret të durueshmit ose ndëshkimin dhe ferrin që i pret ata që rebelohen, doktrina të cilat duhej t'i kontribuonin qëndrueshmërisë dhe ruajtjes së rendit sundues.

Grupin e tretë e përbënin strukturat ushtarake që më së shpeshti ndikonin e shpesh edhe diktonin rrjedhat e jetës politike, të cilat më shumë se ta mbronin shtetin nga armiqët e jashtëm, e mbronin sistemin latifondist dhe konservativ të shoqërisë dhe kompanitë dhe korporatat imperialiste që eksploatonin në mënyrë të pamëshirshme popujt dhe vendet e Amerikës Latine.

Në këto kushte rebelimi i peonëve pa tokë shumë shpejt është shndërruar në revolucio-

nin meksikan, kurse Pancho Villa dhe Emiliano Zapata dhe "maderizmi" e "zapatzizmi" në personalitete dhe lëvizjet më të famshme jo vetëm të Meksikës, por edhe të Amerikës Latine dhe tërë Botës.

4. Pancho Villa ka filluar të bëhet i njohur tek ne në fillim të viteve të pesëdhjeta të shekullit të kaluar. Atëherë në kinematë e Jugosllavisë, e edhe të Kosovës, shfaqej filmi "Një ditë jetë", që bënte fjalë për revolucionin në Meksikë. Filmi kishte nxitur aso interesimi te publiku sa që në çdo vend shfaqej me ditë nga disa herë. Kur përfundonte filmi njerëzit dilnin duke qarë dhe fshirë lotët. Në atë film protagonist kryesor, një oficer i forcave konstitucionaliste (maderistëve) që luftonin kundër huntës ushtarake, të cilin e kishin kapur, para se ta ekzekutonin, e kishin pyetur a ka ndonjë dëshirë të fundit? Ai ishte përgjigjur se ditën që do ta ekzekutonin e ka ditëlindjen nëna e tij dhe se kishte dashur të shkojë t'ia urojë ditëlindjen. Autoritetet ushtarake e kishin lejuar dhe ky kishte shkuar në agim te shtëpia e nënës së tij me disa shokë. Këta e kishin zgjuar të ëmën e tij, plakën Juanita, me një këngë që edhe sot është një ndër këngët më të popullarizuara në Meksikë - Las manjanitas (Yjet e mëngjesit). Gruaja - nëna e oficerit të dënuar, nëna Huanita (mama Juanita), ftohej me këngë të ngrihet se kanë ardhur t'ia urojnë ditëlindjen. Oficeri i ri, që ishte dënuar me vdekje, nga e cila e ndanin shumë pak kohë dhe shokët e tij këndonin, sikur mos të ishte kjo hera e fundit që e uronte nënën për ditëlindje dhe lamtumira e fundit. Kjo këngë ishte bërë shumë e popullarizuar edhe te ne.

Jo shumë pas kësaj oficeri i ri ishte pushkatuar, kurse mbi trupin e tij kishte rënë e trishtuar një gazetare nga Kuba që mbante mbiemrin Marti, pra që mbante mbiemrin e apostullit të çlirimit të Kubës - Jose Marti, gazetare që kishte ardhur në Meksikë të shkruajë për revolucionin, njerëzit që luftonin dhe vdisnin, parimet nga të cilat udhëhiqeshin etj. Ajo e kishte intervistuar oficerin e ri që kishte luftuar për kauzën e drejtë, për të kuptuar çfarë ideale e kanë inspiruar dhe udhëhequr në atë luftë të shenjtë siç mund të jetë lufta për liri dhe drejtësi.

4. Prej atëherë, ngjarjet dhe personalitet kryesorë të revolucionit meksikan do të më bëhen tema të pashmangshme falë interesit profesional sidomos lidhur me

"PANCHO VILLA Ë BËHET PRESIDENT

njohjen e qeverive që kanë ardhur në pushtet në mënyrë jokonstitucionale dmth. me revolucion ose me grushtet për çka janë të njohura vendet e Amerikës Latine. Siç dihet vrasja e presidentit konstitucional Francisco Madero dhe marrja e pushtetit nga gjenerali Victoriano Huerta kanë provokuar luftën disavjeçare e cila ishte ndër luftërat më të përgjakshme që ka njohur Meksika, por edhe shpalljen e një doktrine të njohur në të drejtën ndërkombëtare si "Doktrina e Uilsonit".

Madero ka qenë viktimë e reacionit të brendshëm, por edhe të intrigave të ambasadorit të SHBA Henry Lane Wilson, i cili kokë në vedit, më 15 shkurt 1913 kishte kërkuar dorëheqjen e Maderës. Pas vrasjes së Maderës presidenti Wilson që kishte marrë detyrën me 4 mars 1913 kishte refuzuar njohjen e qeverisë së Huertës dhe kishte urdhëruar largimin diskret të ambasadorit Lejn Wilson nga shërbimi diplomatik. Për fat të mirë, ky qëndrim mosaprovues i Wilsonit do të radikalizohet pas shpërndarjes arbitrare të Kongresit meksikan nga ana e uzurpatorit të pushtetit, kur Wilsoni kishte gjykuar hapur grusht shtetit dhe kishte kërkuar në mënyrë të vrazhdë dorëheqjen e Huertës.

Mbas kësaj ngjarjet do të rrjedhin me shpejtësi të jashtëzakonshme. Më 18 shkurt Madero është arrestuar nga gjenerali Blanket, të cilit i ishte besuar ruajtja e pallatit presidencial, kurse të njëjtën mbrëmje gjeneralet Huerta dhe Dias kishin nënshkruar paktin e njohur si "Pakti nga ambasada" sipas selisë së përfaqësisë diplomatike të SHBA ku ishte shkruar, në të cilin Huerta deklaronte se e ka burgosur Maderën "për t'i ikur gjakderdhjes së mëtejme dhe për shkak të ndjenjës së vëllazërimit kombëtar". Të nesërmen, më 19 shkurt, presidenti dhe nënpresidenti janë bindur t'i nënshkruajnë dorëheqjet, me premtim se do t'u kursehet jeta dhe do t'u mundësohet largimi nga Meksika, e Huerta është kunorizuar në krye të shtetit. Më 23 shkurt ishte kumtuar se Madero dhe zëvendësi i tij ishin vrarë gjatë një sulmi të një grupi të armatosur në automobilin me të cilin këta transportoheshin nga pallati presidencial në burgun qendror. Por, çka kishte ndodhur saktësisht nuk është kuptuar kur. Një letër anonime i fajëson pushtetmbajtësit, të cilët i kishin dërguar viktimat nga pallati presidencial në vend ekzekutim, ku ishin vra me bajoneta, e më pastaj

ishin bërë shosh me plumba, për të simuluar atentatin. Historianët e tashëm pa përjashtim mendojnë se përgjegjës për masakër janë Huerta që e ka menduar likuidimin dhe Feliks Diaz (Dijas) nipi i diktatorit Porfirio Diaz dhe Manuel Madragon, dhe se qeveria e SHBA s'është asesi bashkëfajtorë, që nuk mund të thuhet për ambasadorin amerikan Henri Lejn Vilson.

Kjo ngjarje kishte shqetësuar njerëzit jo vetëm në Meksikë por edhe në tërë botën kurse Presidentit amerikan Taft, që e kishin informuar për vrasje gjatë lutjes në kishë, thonë se ju kishin "dridh duart".

Në atë luftë do të fiton famë dhe shndërrohet në mit "banditi" Pancho Villa sepse ishte vënë në krye të luftëtarëve konstitucionalist të njohur me emrin "maderist" që luftonin për liri dhe për idealet e Maderës "themeluesit të republikës së Indianëve dhe të gjithë të varfërve" pra ishte angazhuar për kauzën e drejtë të popullit.

Arsyet që përmenden pse Vila ishte rreshtuar në anën e "maderistëve" janë nga më të ndryshmet. Armiqët e tij thonë se këtë e ka bërë për të fshirë njollën e rebelit (të arraturit) nga veti. Ajo që llogaritet si më e besueshme është se Vila është frymëzuar nga revolucioni i peonëve. Besohet gjithashtu se këtë e ka bërë edhe në shenjë mirënjohje Maderës që e ka shpëtuar nga dënimi me vdekje që ja kishte shqiptuar Gjyqi ushtarak pas një procesi pesëmbëdhjetë minutash, në bazë të akuzës për vjedhje kuajsh dhe mos dëgjueshmëri, që ja kishte bërë komandanti i armatës Huerta në prill të vitit 1912, një diçka që mshef tendencën që të eliminohet rivali ambicioz. Thuhet se Vila ka qenë para skuadrës së ekzekutimit kur kishte arritur telegrami nga presidenti Madero me të cilin ekzekutimi zëvendësohej me burg, dhe urdhërohej që Vila të transferohet në burgun ushtarak të kryeqytetit Santjago ku kishte mbetur nga qershori deri më 27 dhjetor 1912 kur kishte ikur. Në burg Vila kishte vazhduar ti mbetet besnik Maderës, e i lirë nga pendesa dhe intrigat politike ju kishte kushtuar mësimin të shkrim leximit, që do të përmend më vonë sinqerisht dhe me modesti.

Nga burgu ka dalë me ikje, i ndihmuar nga vetë presidenti, një veprim zemërgjerë i Maderës, gjest të cilin Vila nuk e kishte harruar kur. Kjo ka qenë arsyeja që ka

ndikuar ke Vila që ai deri në fund të jetës ta admiroj Maderën.

5. Atëherë, Vilën kishin filluar ta quanin "miku i të varfërve", "gjenerali i pamposhtshëm", "shpresa e republikës së indianëve" etj. Dhe ky ju kishte përgjigjur siç ka ditë. Në një ceremoni kur i ishte dorëzuar një dekoratë, ai vetëm kishte arritur t'ju falënderoj me një zë që mezi dëgjohej: "S'kam fjalë që do të mund të shprehen. Krejt ç'ka mund të them është se zemra e ime rrahë për ju". Dhe kjo ishte e tëra që kishte thënë njeriu që kur nuk kishte shkuar në shkollë, që 22 vjet kishte qenë i arratur, që i përshkruanin çdo plaçkitje të ndonjë treni, të ndonjë banditizmi ose të ndonjë vrasjeje që ndodhte në pjesët veriore të Meksikës.

6. Natyrisht për me shkruar për Vilën më shumë se shënimi i një përvjetori të rëndësishëm ka qenë fakti pak i njohur që "banditi" Pancho Villa është bërë sinonim për moral patriotik sidomos kur ky kishte refuzuar të bëhet president i Meksikës. Ky segment nga jeta e tij, mund të shërbejë si shembull antologjik të modestisë, sinqeritetit, moralit dhe patriotizmit, dhe është bërë i njohur kur ka filluar me u parë fundi i luftës. Atëherë kishin filluar diskutimet se kush duhet bërë presidenti i ardhëm i Meksikës. Populli që e admironte Villën mendonte se ky vend duhet t'i jepet Pancho Villës. Por, për habinë e shumëkujt Pancho Villa nuk dëshironte të bëhet President i Republikës dhe nuk nguronte të përgjigjet në pyetje: a kishte mund apo jo të bëhet President? Në lidhje me këtë Vila një herë kishte thënë: "Unë jam luftëtar, e jo shtetar. Nuk jam mjaft i edukuar (shkolluar) të mund të bëhem President. Kam mësuar me lexuar dhe me shkruar tek para dy vjetëve. Qysh kisha unë, që kur nuk kam shkuar në shkollë, mund të shpresoj se do të jem në gjendje të flas me ambasadorët e jashtëm dhe zotërinjtë e kulturuar nga Kongresi? Do të ishte keq për Meksikën nëse një njeri i pashkolluar bëhet President. Ka diçka që kur nuk do të bëjë, - ta pranoj pozitën për të cilën nuk jam i aftë" dhe kishte shtuar më pastaj, se edhe poti urdhëronte këtë "udhëheqësi kryesor i revolucionit" Karranza ky do të refuzonte - e vetmja gjë që do t'ia refuzonte "shefit të vet". E Venustiano Carranza (Karansa), ishte lider i padiskutueshëm i konstitucionalistëve meksikan falë qëndrimit burrëror lidhur me vrasjen e Maderos dhe rolin e shteteve të jashtme në kasaphanën

dhe shtypjen e popullit meksikan, për të cilat i kishte thënë Ridit se "kur është vrarë Madero, fuqitë e jashtme janë tubuar ke vendi i krimi si larashat mbi të vdekurin dhe iu janë vardisë vrasësit ... Këto kombe mendojnë se do të mund të vijnë deri te privilegjet duke ndihmuar qeverinë e uzurpatorit ... është turp për SHBA që i kanë lejuar vetes ti bashkëngjiten atyre forcave të turpshme".

I gjendur shpesh para pyetjes së njëjtë, se a dëshiron të bëhet President i Meksikës Pancho Villa i ishte përgjigjur Xhon Ridit: "Ju kam thënë më shumë herë se nuk ekziston mundësia të bëhem President i Meksikës ... Kjo është hera e fundit që do të përgjigjem në këtë pyetje. Korespondentit e ardhshëm që do të pyet për këtë do të urdhëroj ta dërmojnë së rrahuri dhe ta dërgojnë përtej kufirit".

Pancho Villa ka mbetur i njohur se është i vetmi person i cili me një njësit të vet ka shkretuar (invaduar) qytetin Columbus (New Mexico) të SHBA-së më 9 mars 1916, çka kishte provokuar intervenimin e një armate amerikane prej 10 000 ushtarësh nën komandën e gjeneralit John Pershing për ta kapur Vilën, ekspeditë që ka pësuar fiasco të plotë e detyruar që të tërhiqet pas më se një vit kërkimi të pasuksesshëm.

Pancho Villa është tërhequr nga politika duke përfutur nga amnestia në vitin 1920 për të vazhduar të jetojë në ranqin në Canutillo, afër qytetit Parral (Chihuahua), ku pas tri vjetësh është vrarë më 20 korrik 1923. Kjo vrasje nuk është zbardhur asnjëherë, por shumica e historianëve mendojnë se është bërë më urdhër të gjeneralit Alvaro Obregon, i cili ka dashur që njëherë e përgjithmonë ta heqë qafe Vilën dhe ta eliminojë mundësinë që ky të kandidohet në zgjedhjet e vitit 1924 si shpëtimtar nga egërsia e administratës së Obregonit.

Të gjitha këto kanë ndikuar që Xhon Rid ka shkruar me aq ngrohtësi për Pancho Villën në përpjekjen për të qenë intelektualisht i ndershëm duke na mundësuar që edhe ne pas afro një shekulli "ti shohim bukuritë e mshefura të botës së dukshme".

Fatkeqësisht, shqiptarët megjithëse nuk kanë Pancho Villa, Emiliano Zapata dhe Ernesto Çe Gevara për t'u mburrur dhe krenuar, kanë njerëz që ushqehen me idealet e tyre dhe këtë nuk mund t'ia ndalojë asnjë individ apo klikë politike, të cilët flasin me përbuzje për këta tribunë të vërtetë të popullit ose për njerëzit që iu kanë përngjarë ose i admirojnë.

UBT DHE MINISTRIA E DIASPORËS MË AFËR MËRGIMTARËVE!

Prishtinë, 22 prill 2013 – Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe Ministri i Diasporës në Republikën e Kosovës, Ibrahim Makolli, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional.

Më këtë marrëveshje do të mundësohet zhvillimi i Sistemit të Informacionit për Diasporën nga ana e UBT-së për Ministrinë e Diasporës në Republikën e Kosovës.

Më konkretisht Sistemi i Informacionit për Diasporën përmban: regjistrimin e shoqatave të komunitetit, kompanive, veprimtarive të personave, veprimtarive akademike dhe mirëmbajtjen dhe trajnimin e stafit të Ministrisë së Diasporës.

Presidenti i UBT-së, Dr. Hajrizi tha se, marrëveshja e bashkëpunimit mes dy institucioneve të vendit do të ndihmojë dhe do të lehtësojë rrugën në fushën e informacionit në Ministrinë e Diasporës. Ai me tej shtoi se UBT ka qenë gjithëherë aktive në ofrimin e mundësive për të ndihmuar dhe zhvilluar të gjitha institucionet vendore, duke e dhënë kontributin nga ana shkencore dhe profesionale, me anë të stafit akademik dhe infrastrukturorë, theksoi Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi.

PROF. KRASNIQI, NË KONFERENCËN SHKENCORE NË LITUANI

Prishtinë, 10 prill 2013 - Prof. dr. Ibrahim Krasniqi, profesor i rregullt në UBT, për dy ditë me radhe, ka qëndruar në Riga të Lituanisë, dhe ka marrë pjesë në Konferencën shkencore "Second International Scientific Conference on Project Management in the Baltic States".

Prof. Krasniqi në konferencën në fjalë do të paraqitet me punimin e tij hulumtues me titull: "PROJECT MANAGEMENT CHALLENGES IN LOCAL GOVERNANCE LEVEL IN THE TRANSITION COUNTRIES - KOSOVO CASE", i cili është pranuar nga Komiteti shkencor i Konferencës pas procesit strikt vlerësues nga tre ekspertë të pavarur.

Konferenca organizohet nga Universiteti Shtetëror i Lituanisë në bashkëpunim me Shoqatën e Menaxherëve Profesionalë të Projekteve të Lituanisë dhe mbështetjen të Qeverisë Lituanëze.

Përveç pjesëmarrjes në konferencë z. Krasniqi do të takohet edhe me personalitete nga fusha akademike si dhe do t'i vizitojë një varg institucionesh universitare.

NË UBT U ZHVILLUA CEREMONIA E DIPLOMIMIT 2013

Prishtinë, 6 korrik 2013- Në një ceremoni madhështore, organizuar në Kampusin e ri të UBT-së, u zhvillua Ceremonia e Diplomimit 2013, në të cilën studimet bachelor dhe master i përmbyllën 212 studentë të tre departamenteve: Departamentit për Menaxhment,

Biznes dhe Ekonomi, Departamentit për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, si dhe Departamentit për Mekatronikë.

Të pranishëm në këtë ceremoni madhështore ishin prindër dhe familjarë, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës

dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të medie, profesorë dhe studentë të UBT-së dhe të ftuar të tjerë. Me nga një fjalë rasti ceremoninë e kanë përshëndetur Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ambasadori i Republikës së Norvegjisë në Prishtinë,

Jaan Braathu, zëvendës-presidenti i UBT-së, prof. dr. Mo Vaziri, ndërta në emër të Alumini të UBT-së, Illir Hajdini dhe Kreshnik Ismaili, si dhe kryetari i Organizatës së studentëve në UBT, Hekuran Popaj. Pas fjalëve përshëndetëse ka vijuar ceremonia e diplomimit,

me dhënien e betimit nga të porsadiplomuarit dhe me marrjen e certifikatave.

Po kështu, gjatë kësaj ceremonie janë shpallur edhe studentët e daluar dhe studentët ambasadorë të të tre departamenteve, të cilët janë nderuar me certifikata.



STUDENTI I UBT-së ËSHTË CERTIFIKUAR ME TITULLIN CERTIFIED ETHICAL HACKER NË HOLANDË

Prishtinë, 12 prill 2013- Atdhe Buja, student i rregullt në UBT, në Departamentin Master - Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, nga date 7 prilli e deri më sot, ka marrë pjesë në trajnimin më të avancuar "CEH Certified Ethical Hacker" në Holandë, për mbrojtjen nga sulmet kibernetike.

z. Buja, sot është vlerësuar me rezultatin më të lartë në provim dhe është Certifikuar me titullin "Certified Ethical Hacker".


Ky nivel i njohurisë është më së i nevojshëm për vendin tonë, i cili tregon qartë një nivel të lartë të mbrojtjes së të dhënave të vendit nga sulmet e mundshme kibernetike.

z. Buja, tash e tete vite punon si Administrator i Bazave të të Dhënave për të gjitha institucionet e Kosovës, me një përgjegjësi të lartë profesionale dhe morale. Ka arritur të marrë titujt më të njohur për administrimin dhe menaxhimin e bazave të të dhënave në Microsoft dhe Oracle:

- MCTS & MCITP në SQL Server 2008 (duke përgatitur për hyrjen në provimin e fundit dhe të vetëm MCM - Certified Master)

- Oracle OCA 11g Oracle Certified Associate

Trajnimi organizohet nga organizata TCTS me qendër në Veenendaal, Holandë.



LIBËR SITË SHKRUHEN LIBRA NË GJUHËN SHQIPE PËR TEKNOLOGJINË INFORMATIVE!

Prishtinë, 27 nëntor 2012- Në UBT, u organizua promovimi i librit "Rrjetat kompjuterike", të autorit Selman Haxhijaha, dhe promovimi i revistës shkencore "International Journal of Business, Technology".

Promovimi i librit dhe revistës u organizua me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, dhe morën pjesë përfaqësues vendorë dhe ndërkombëtar nga fusha akademike, politike, studentë, familjarë etj.

"Synimi i këtij libri është që të japë një përshkrim të përgjithshëm të rëndësisë së rrjetave kompjuterike, dhe në mënyrë të veçantë të japë disa këshilla dhe udhëzime si të konfigurohen pajisjet kuqe që mundësojnë komunikimin në një rrjet kompjuterik me madhësi të mesme. Synimi i këtij libri është që të fillohet me të shkruarit e librave në gjuhën shqipe për një fushë si teknologjia informative, duke ditur që libra të tillë mungojnë për lexuesin shqiptar etj etj" tha Presidenti i UBT-së Prof. Dr. Edmond Hajrizi, si recensent dhe njëherit edhe botuesi i këtij libri, dhe shtoi se duke qenë

që nga fillimi i angazhuar për të ndjekur zhvillimet e këtij sektori, shpresojmë që autori edhe në të ardhmen do të vazhdojë të japë kontributin e tij duke na dhënë edhe botime tjera nga kjo fushë.

Kurse, Dr. Petrit Shala, recensentë i librit "Rrjetat kompjuterike", tha se, është libri i parë akademik në gjuhën shqipe që shtjellon në mënyrë të detajuar temat përkatëse në rrjetat kompjuterike. Ky libër përshkruan temat me rëndësi në lëmin e rrjetave kompjuterike, duke filluar nga hyrja dhe temat në vazhdim si përdorimi i algjibrës së Bultit në fushën e rrjetave kompjuterike, komponentët e rrjetave kompjuterike, arkitekturën e rrjetave LAN, modelet referencuese të OSI modelit dhe TCP/IP-në, IP-adresimi dhe subnetimi, komutimi ne LAN pra suiçi, ruteri, bazat e rrugëtimit, konfigurimi i rutereve, aplikimi i sigurisë në ACL etj, duke shtuar se autori në këtë libër ka arrit në mënyrë të shkëlqyer të gërshetohet pjesën teorike me atë praktike.

Kurse autori i librit z. Haxhijaha th se përveç studentëve të

Universiteti të UBT-së, ky libër njëkohësisht mund të ju shërbejë edhe atyre që punojnë në fushën e rrjetave kompjuterike ose duan të mësojnë më tepër për funksionimin dhe organizimin e kësaj lëmie.

Autori Haxhijaha përshëndeti përzemërsisht botuesin e librit, Prof. Dr. Edmond Hajrizin, si dhe recensentet si dhe mysafirët, dhe paralajmëroi se së shpejti do të boton edhe libra tjerë.

Kurse në emër të revistës shkencore foli zëvendës-presidenti i UBT-së, Prof. Mo Vaziri, i cili tha UBT do të vazhdojë edhe me tutje të publikoj revistat të tilla të nivelit të lartë shkencor.

Autori Selman Haxhijaha, studimet themelore dhe master i ka përfunduar në Universitetin UBT, dhe specializimin për rrjetat kompjuterike i ka përfunduar në Universitetin e Anglisë qendrore në Birmingham në Britanisë së Madhe.

Për momentin Haxhijaha është duke punuar si ligjëruese në UBT dhe si konsulent për kompani të shumta si në Kosovë dhe në Belgjikë.



PJESË E SHKËPUTUR NGA INTERVISTA ME PRESIDENTIN E UBT-SË,
PROF. DR. EDMOND HAJRIZI, DHËNË PËR AGJENCINË E LAJMEVE "KOSOVAPRESS"

DR. HAJRIZI: PËR STUDIME NË UBT DUHET PLOTËSUAR KRITERET E CAKTUARA

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë një interviste për agjencinë e lajmeve "Kosovapress", ka thënë se UBT ofron programe studimi të cilat nuk janë në Universitete tjera si: dega e Sistemeve të informacionit, Mekatronikës dhe Robotikës në nivelin Bachelor dhe Master. Sipas tij, UBT ka bashkëpunim me rreth 100 universitete ndërkombëtare, ku përmes këtij bashkëpunimi realizohen mundësi të shkëmbimit të studentëve, shkëmbim të stafit, si dhe realizim të projekteve të ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare.

Hajrizi ka bërë të ditur se UBT ka një rregullore të caktuar për regjistrimin e studentëve ngase, sipas tij, në UBT nuk mund të studiojë kush ka dëshirë pa i plotësuar disa kriteret e caktuara nga UBT.



Ai ka pohuar se bashkëpunimi më shumë universitete, kompani dhe organizata të huaja prestigjioze ka krijuar kushte shumë më të mira për studim falë edhe projekteve të ndryshme që ka përfutur UBT.

"Bashkëpunimi edhe sot vazhdon dhe kemi diku rreth 100 universitete partnere që ne kemi bashkëpunim shumë të madh dhe ajo neve na mundëson që ne të realizojmë shkëmbim të

studentëve, shkëmbim të stafit, realizim të projekteve të ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare. Përmes këtij bashkëpunimi ne kemi arritur që qysh prej fillimit të fitojmë projekte TEMPUS-së. Qysh më 2004 kemi fituar projekte TEMPUS-së, kemi qenë do të thotë që në fazën e parë që shumë pak projekte kanë qenë në Kosovë dhe qato të pakta kemi qenë neve përfutur të tyre", ka thënë Hajrizi.

Ai ka shtuar se studentët kanë kushte shumë të mira për të studiuar në UBT, si nga ana mësimore po ashtu edhe nga infrastrukturë. Ai më tej ka shtuar se UBT është një nga institucionet më cilësore dhe më serioze i cili në bazë të kriterëve bën edhe përzgjedhjen e studentëve.

"Ne kemi pasur dëshirë që të kemi studentë të dalluar sepse është një institucion që kërkon angazhim dhe sukses. Suksesin e

bazojmë në cilësi e jo në parime të tjera, prandaj kryesisht numri i studentëve që vijnë janë të shkëlqyeshëm. Ne e kemi edhe një bursë që u japim të gjithë studentëve të shkëlqyeshëm që kanë pas nota të mira të kenë zbritje dhe një bursë studimi dhe nga statistikatat që shohim shumica e tyre janë studentë të shkëlqyeshëm, mbi 50% ndoshta e plotësojnë atë kriter dhe mandej vinë edhe një grup tjetër i studentëve të cilët dëshirojnë të arrijnë sukses. Në shkollë të mesme mund të mos kenë të gjitha pesëshe po janë të mirë, ata duhet tu nënshtrohen intervistave, provimeve, testeve dhe do të shohim a i plotëson kriteret për t'u pranuar apo jo. D.m.th. është një rregullore e caktuar që tregon rrugëtimin, procesin se si mund të hysh në UBT", ka theksuar Hajrizi.

Ai ka bërë të ditur se UBT, aktualisht ka rreth 4 mijë studentë dhe sipas tij ky numër është në rritje të vazhdueshme, sikurse është në rritje edhe stafi akademik si dhe infrastruktura shkollore në mënyrë që studentët të cilët studiojnë të kenë kushte sa më të mira. /Kosovapress/

BREZET E PASHFRYTËZUARA FREKUENCORE (WHITE SPACE) STANDARDIZIMI I TEKNOLOGJIVE QË PËRDORIN KËTO



Dr. Xhafer Krasniqi

Spektri frekuencor është një burim që çdo herë është i pamjaftueshëm, dhe për këtë çdo përpjekje për të përmirësuar shfrytëzimin e spektrit në mënyrë sa më efektive apo çdo përpjekje për të gjetur breze frekuencore të pashfrytëzuara, gjerë tani ka zgjuar interesim të madh në industri.

Kalimi nga sistemet analoge televizive në ato digjitale, që në shumë vende të botës ky proces veç është kryer dhe në disa tjera do të kryhet gjatë 2013 dhe 2014, ka hapur një mundësi që të gjinden breze frekuencore shtesë që tani janë të pashfrytëzuara dhe që të mundësohet ri-alokimi i tyre. Ka dy lloje brezesh frekuencore që janë liruar apo që janë vënë në dispozicion nga ky trazicion në mes këtyre sistemeve: Brezet frekuencore, që ishin përdorë për sistemet analoge televizive dhe tani janë në dispozicion, por për të cilat breze ende kërkohet licence e shfrytëzimit dhe brezet frekuencore të njohura si breze lokale gjeografike që ko-ekzistojnë me sistemet digjitale televizive (geographically interleaved), dhe që mundësojnë evitimin e interferencave në mes stacioneve transmetuese dhe janë breze për të cilat nuk kërkohet licence.

Fokusi i këtij artikulli është në grupin e dytë të brezeve frekuencore, pra në brezet e pashfrytëzuara në mes 54-862 MHz, që nuk kërkojnë licence dhe që ko-ekzistojnë me kanalet digjitale televizive dhe që njihen edhe si kanale breze-bardha televizive (TV White Space-TVWS).

Teknologjia që operon në këto breze është duke u bërë mjaft aktuale në industri. Ndonëse SHBA-të, janë më të avancuara në këtë aspekt dhe para shteteve tjera, vendet kryesore të Evropës dhe në mënyrë të veçantë Britania a Madhe, janë duke e bërë të njëjtën punë për të kompletuar legjislacionin dhe për të realizuar testet e nevojshme. Shpejtësia transmetuese e të dhënave përmes kësaj teknologjie mund të arrijë deri në 22 Mbps, dhe në një distancë deri në 100 km prej stacionit bazë.

Rregullatori Britanik për Telekomunikim, Ofcom, ka miratuar ligjin për përdorimin e brezeve

të pashfrytëzuara për shërbimet telekomunikuese siç është: Interneti përmes kanaleve brezëgjërë dhe komunikim në mes të vet pajisjeve pa intervenim të faktorit njeri (M2M-Machine to Machine). Pritet që teknologjia që operon në këto breze frekuencore të pashfrytëzuara të implementohet apo t'i afrohet tregut në 2013. Supozohet që ky vendim i Ofcom-it Britanik, që është më i hershëm se në vendet tjera Evropiane, do të ketë ndikim edhe në këto shtete dhe mund të përshpejtojë procesin e miratimit të ligjeve të njëjta në nivel Evropian.

1.1 Ku përdoren brezet e pashfrytëzuara televizive

Aplikacione të cilat i përdorin këto breze frekuencore dhe numri i tyre është në rritje e sipër.

- Qasje në Internet në zona të zgjeruara kryesisht për zona rurale- Mundëson transmetim të të dhënave në distanca më të mëdha në zonat e largëta për shkak se valët udhëtojnë me larg në këto frekuenca, aplikimi për konëktimin e Wi-Fi prapa pikës bashkuese (Access Point) për zonat rurale- Eviton nevojën për lidhje fizike me kabllo prej pikës bashkuese (Access Point), e deri tek serverët e operatorëve. Mund të përdoret në hotele, kampuse dhe biznese të vogla, aplikimi për rrjetat mobile dhe në mënyrë specifike për gjeneratën e katërt të rrjetave mobile, 4G/LTE-Advanced përmes një radio teknologjie të njohur si teknologji inteligjente (Cognitive Radio)- Këto frekuenca janë më të përshtatshme edhe për sinjale në objekte të mbyllura pasi që mundësojnë depërtimin më të mirë përmes mureve të ndërtesës, konëktim për kamerat e sigurisë - E thjeshton instalimin e kamerave të sigurisë në vendet ku nuk ka pas mundësi me pare për shkak të vështirësive për të depërtuar sinjali dhe përdorimi për komunikim në mes të makinave (M2M-Machine to Machine), i cili mundëson konëktim më të lehtë me reaktor bërthamor dhe për monitorim nga distanca të pacientëve. Pra, ky aplikim i gjerë i këtyre frekuencave ka mundësuar që të rritet interesimi për teknologjitë që operojnë në këto frekuenca dhe si të tilla kanë filluar të bëhen edhe si objekt studimi i organizatave të ndryshme të standardeve.

1.2 Kush përfiton nga frekuencat e pashfrytëzuar

Akterët kryesore në këtë industri dhe që mund të përfitojnë nga këto frekuenca janë: prodhuesit e pajisjeve telekomunikuese (siç janë NEC, Nokia, Apple, Huawei, Motorola etj) operatorët (siç janë Vodafone, T-Mobile, Telefonica etj), shfrytëzuesit e telefonave dhe pajisjeve tjera, akademia (universitetet përmes hulumtimeve dhe pro-



jekteve të ndryshme kërkimore) dhe qeveritë (përmes involvimit në alokimin e këtyre frekuencave dhe përpilimin e legjislacionit) etj.

1.3 Radio teknologjia inteligjente (Cognitive Radio-CR)

Faktori kryesor dhe determinues në suksesin e këtyre brezeve të pashfrytëzuar është një teknologji prapa këtyre brezeve e cila teknologji mundëson që të arrihet kolektivitet në mes të dy pikave duke ri-përdore frekuencat e njëjta dhe në këtë mënyrë duke e përmirësuar menaxhimin e këtyre frekuencave në mënyrë dinamike. Kjo teknologji inteligjente është një koncept i ri për të cilën mund të thuhet se ka aftësi të të mësuarit, menduarit dhe observimit, dhe është në gjendje të marr informata për ambientin për rreth si dhe t'i përshtatë parametrat dhe protokollet në mënyrë përkatëse.

Kjo teknologji mundëson qasje në brezat frekuencore në mënyrë dinamike, qasje në databazën për këtë teknologji, precizitet të lartë në teknikat për gjeolokacion, ndjeshmëri për brezat (pra detektim të brezeve frekuencore kur ato janë në dispozicion) dhe poashtu mundëson ko-ekzistencë me shërbimet televizive ekzistuese.

1.4 Testet dhe implementimet e këtyre frekuencave

Numri i kompanive që janë të interesuara për hapësirat e pashfrytëzuara (White Space) është gjithnjë në rritje, por në mënyrë të veçantë Google dhe Microsoft, kompani që dallohen në këtë rast dhe janë duke e shtyrë zhvillimin e teknologjive për këto frekuenca për të mundësuar qasje brezgjërë në zona rurale.

Për të vërtetuar se sa kanale frekuencore rreth nesh janë në të pashfrytëzuara një grup kompanish të bashkuara në një partneritet në Cambridge, 'Cambridge TV White Spaces Consortium' a realizuan një test në vitin 2012 dhe konstatuan se qyteti Cambridge ka rreth 20 kanale frekuencore të pashfrytëzuara nga 8 MHz, që gjithsej ofrojnë 160 MHz. Në këtë rast Microsoft, dhe një kompani tjetër 'Spectrum Bridge' ofruan të

dhënat për gjeolokacion të cilat mundësojnë detektimin e sinjaleve tjera dhe në këtë mënyrë mundësohet të evitohen interferencat.

Për më shumë, teste shtese u realizuan gjatë kësaj ngjarje në Cambridge, për të transferuar programet e BBC iPlayer dhe Sky Go, nga platforma mobile brezgjërë në këto frekuenca të pashfrytëzuara dhe të cilat vërtetuan se këto kanale frekuencore të pashfrytëzuara të njohura si White Space, mund të përdoren sikur teknologjia WiFi, por që mbulojnë një hapësirë më të madhe se sa WiFi, ose mund edhe t'i shërbejë teknologjisë WiFi, për konëktimin e Wi-Fi prapa pikës bashkuese (Access Point).

Në kuadër të promovimit të kësaj teknologjie dhe interesit të madh nga kompanitë e ndryshme, një kompani Kineze, shumë e njohur në botë, Huaäei ka bërë të ditur se ka kompletuar një test për të vërtetuar se këto frekuenca të pashfrytëzuara mund të aplikohen edhe për gjeneratën e katërt të rrjetave mobile dhe në mënyrë specifike për teknologjinë LTE TDD (Long Term Evolution Time Division Duplex).

1.5 Organizatat e standardeve të involvuar në standardizimin dhe promovimin e teknologjive që operojnë në këto frekuenca

Përmes standardeve mendohet që të arrihet implementimi i teknologjive inteligjente (Cognitive Radio) nga prodhuesit të ndryshëm si dhe te realizohet ndërveprimi (interoperabiliteti) në mes këtyre teknologjive.

1.5.1 IEEE (Institute of Electrical and Electronics Engineers)

IEEE është organizata më e madhe e standardeve që ka standardizuar numrin më të madh të sistemeve komunikuese që operojnë në brezet frekuencore të palicencuara, duke i përfshirë edhe ato për këto frekuenca të pashfrytëzuara (TV White Space). IEEE ishte organizata e parë që e inicioi standardizimin për këto frekuenca që nga viti 2005 që njihet si standardi 802.22, por interesimi

i madh për këto standarde filloi vetëm kohëve të fundit.

Ishte standardi P1900 i IEEE, që ishte standardi i parë për gjeneratën e ardhshme për radio dhe për përmirësimin e menaxhimit të spektrit frekuencor që qoi drejt zhvillimit të teknologjive inteligjente (Cognitive Radio) dhe më pas tek standardi SCC 41, që e zgjeroi fushëveprimin e këtij standardi duke përfshirë përmirësimin e shfrytëzimit të spektrit, menaxhimin e interferencave dhe për mundësitë për të mundësuar qasjen në brezet frekuencore në mënyrë dinamike.

Standardi më i rëndësishëm i IEEE për teknologjinë inteligjente (Cognitive Radio) është IEEE 802.22, i cili konsiderohet të jetë si një alternative e WiFi-it, apo të standardit të njohur IEEE 802.11 dhe që operon në frekuenca tjera (54-862 MHz).

Ky standard që në industri njihet edhe si rrjete regionale me radio frekuenca (Wireless Regional Area Networks-WRAN), është standard që mundëson shfrytëzimin efektiv të frekuencave televizive të pashfrytëzuara (TW WS), dhe duke mos shkaktuar interferencë me frekuencat ekzistuese dhe duke adresuar interferencat në shtresat fizike dhe shtresa kontrolluese e mediumit transmetues (MAC-Medium Access Control)

1.5.2 ETSI-European Telecommunications Standards Institute

Është një organizatë tjetër e standardeve shumë e rëndësishme që është kryesisht Evropiane dhe që fokusohet në standardizimin e teknologjive që përdorin ri-konfigurimin e radio rrjetave për t'iu përshtatur ndërrimeve dinamike gjë që i bënë shumë të përshtatshme për frekuencat televizive të pashfrytëzuara për shkak të veçorive specifike që këto frekuenca kanë. Puna për këto teknologji në ETSI, bëhet brenda grupeve punuese, për ri-konfigurimin e radio sistemeve më qëllim që të studiohen sistemet e lidhura me teknologjitë inteligjente (Cognitive Radio), të definohen kriteret për përmirësimin e shfrytëzimit të spektrit frekuencor dhe ndërveprimin (interoperabilitetin) në mes të operatorëve. Specifikacionet kryesore të zhvilluara nga këto grupe punuese janë: DTS/RRS-01010 për kriteret e sistemit për të operuar në brezet televizive (UHF TV Band) dhe DTS/RRS-01005 për të definuar arkitekturën për ko-ekzistencën në mes të rrjetave inteligjente.

1.5.3 IETF-Internet Engineering Task Force
IETF është një organizatë tjetër poashtu shumë e rëndësishme që

PACE) DHE FREKUENCA

poashtu është e involvuar në një formë në standardizimin e protokolleve për të mundësuar qasje precize në sistemin e databazave në mënyrë që të evitohen intererferencat në mes të frekuencave televizive që ndërrojnë varësisht nga lokacioni dhe mikrofonave me radio që operojnë në të njëjtën zone.

Zhvillimi i këtij protokoli nga IETF quhet PAWS (Protocol to Access White Space database) ka filluar në gusht të 2012 dhe IETF planifikon të dërgojë për publikim.

1.5.4 ECMA-European Computer Manufacturers Association

ECMA është një organizatë tjetër e standardeve që ka zhvilluar një standard të quajtur ECMA 392, për të operuar në frekuencat e pashfrytëzuara televizive. ECMA 392, është një standard që implementon teknologjinë inteligjente, (Cognitive Radio), specifikon shtresën fizike dhe shtresën kontrolluese të mediimit (MAC), për këto frekuenca televizive dhe i cili standard mundëson evitimin e interferencave me shërbimet existuese të licencuara në harmoni me rregullat lokale dhe regionale. Aplikimet kryesore të këtij standardi janë në rastin e video sinjaleve me shpejtësi të lartë dhe qasje në Internet të pajisjeve personale dhe atyre elektronike shtëpiake.

1.5.5 Aleanca për frekuencat e pashfrytëzuara (ËSA-Ëhite Space Alliance)

Për dallim prej katër standardeve të cekura më lartë, që zhvilluan specifikacionet teknike për frekuencat e pashfrytëzuara televizive, kjo aleance kryesisht fokusohet në promovimin e këtyre frekuencave dhe teknologjive që operojnë në këto frekuenca, promovimin e implementimit dhe përdorimit të pajisjeve dhe shërbimeve të bazuara në standarde si një formë për të ofruar qasje në Internet me brez të gjerë frekuencor përmes frekuencave televizive.

Kjo aleance poashtu operon edhe si një mbështetëse për një eko-sistem të ri të frekuencave të pashfrytëzuara (Ëhite Space), për të mundësuar testimin për ndërveprim (interoperabilitet), performancë dhe përputhshmëri.

Aleanca për frekuencat e pashfrytëzuara (ËSA), promovon përdorimin e standardeve të zhvilluara nga IEEE, 3GPP dhe IETF, për t'u përdorë në frekuencat televizive. Në mënyrë të veçantë, kjo aleance ka zgjedhur standardin 802.22 të IEEE, si standardi i parë dhe më i rëndësishmi për t'u aplikuar në këto frekuenca.

Standardi 802.22, që ishte zhvilluar si standard për rrjeta regjionale me radio frekuenca (ËRAN),

kishte më shumë përparësi krahasuar me standardet tjera për shkak të karakteristikave transmetuese që kanë frekuencat televizive VHF dhe UHF për të mundësuar transmetim të sinjaleve deri në 100 km distancë, që është shumë më shumë se WiFi apo ndonjë teknologji tjetër për transmetime të shpejta.

1.6 Implikimet e mundshme të kësaj teknologjie për telefonat mobil

Nuk parashihet të ketë implikime të mëdha në arkitekturën dhe dizajnin e telefonave mobil nga aplikimi i këtyre frekuencave. Telefonat mobil dhe pajimet tjera mobile, tabletet etj., do të kenë të njëjtën arkitekturë harduerike, si ato ekzistuese që operojnë në WiFi. Interfjats për këto frekuenca të reja do t'i shtohen kësaj arkitekture pa shkaktuar ndryshime të mëdha dhe pa pasur nevojë të ndërrohet platforma hardverike.

Për më shumë, këto pajisje të modifikuara apo dizajnuara për këto frekuenca të reja shtese, tani më të pashfrytëzuara, poashtu do të duhej të ishin në gjendje të detektojnë brezet në dispozicion ose të kenë qasje në sistemin e databazës për gjeo-lokacion apo edhe të dyja së bashku.

1.7 Konkludim

Ky artikull mund të mbyllet me disa konkluzione të përgjithshme si në vijim. Interesimi për teknologjitë që operojnë në këto frekuenca të pashfrytëzuara (White Space) deri tani dhe për standardizimin e tyre është gjithnjë në rritje nga kompanitë e njohura botërore dhe nga organizatat e ndryshme të standardeve, shfrytëzimi i këtyre frekuencave mund të shërbejë edhe si zgjidhje e shpejte për të adresuar kërkesat e mëdha për kapacitet përmes radio konektiveve, numri i testeve dhe implementimeve komerciale për këto teknologji veç kanë filluar dhe janë në rritje, prodhuesit e pajisjeve të ndryshme, në veçanti të telefonave mobil, tabletave dhe telefonave inteligjent (smartphone) duhet të fillojnë të dizajnojnë dhe t'i modifikojnë prodhimet e veta në mënyrë që të operojnë edhe në këto frekuenca që tani janë në dispozicion, kompanitë e ndryshme, si NEC, Nokia, Motorola, nëse veç nuk kanë filluar ende, t'i kushtojnë vëmendje më të madhe mundësive që ofrojnë këto frekuenca dhe në këtë mënyrë të përfitojnë nga interesimi i madh për to dhe të bëhen me konkurrent në tregun botëror, qeveritë e vendeve të kompletojnë legjislacionin e nevojshëm për të mundësuar shfrytëzimin e këtyre frekuencave dhe pothuaj të gjithë akteret a rëndësishëm në industrinë telekomunikuese mund të përfitojnë nga këto frekuenca të pashfrytëzuara dhe teknologjitë që operojnë në to.

Autori është profesor në Universitetin UBT, dhe konsulent i lartë në "NEC Corporation" në Departamentin për Kërkime dhe Standarde Teknologjike.

TEKSTI I DR.BEQAJT, I PARI NGA LËMI I ARKITEKTURËS

Prishtinë, 26 nëntor 2012- Në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) u organizua promovimi i librit "Projektimi i Konstruksioneve Arkitektonike", i autorit Prof. Dr. Binak Beqaj.

Promovimi i librit u organizua me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, dhe në të morën pjesë përfaqësues vendorë dhe ndërkombëtarë nga fusha akademike, politike, studentë, familjarë etj.

Përveç botuesit, Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, fjalë rasti mbajtën edhe recensentët e librit, Prof. Dr. Fetah Jagxhiu dhe Prof. Dr. Misin Misini.

"Ky libër është bazë e mirë për përcjelljen e njohurive edhe nga fushat e tjera të arkitekturës dhe ndërtimit, duke u bazuar në njohuritë e fituara për mënyrën e kompletimit të elaboreteve të projekteve arkitektonike, njohuritë e mjaftueshme për realizimin e objekteve arkitektonike, bazën profesionale për zgjedhje të drejtë të sistemeve konstruktive dhe ndërtesave, njohjen dhe aplikimin e normave dhe standardeve teknike, njohjen e shkathtësive të profesionit në ndërtim, njohjen me rregullat e projektimit dhe dokumentacionit teknik të nevojshëm për vetësimin e terminologjisë profesionale etj.", tha Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe shtoi se duke qenë që nga fillimi i angazhuar për të ndjekur zhvillimet e këtij sektori, shpresojmë që autori edhe në të ardhmen do të vazhdojë të japë kontributin e tij duke na dhënë edhe botime të tjera nga kjo fushë.

Kurse Prof. Dr. Fetah Jagxhiu, recensent i librit "Projektimi i Konstruksioneve Arkitektonike", tha se është teksti i parë nga lëmi i arkitekturës dhe do të jetë bazë e mirë për lëndët e projektimit të ndërtesave në përgjithësi, autori i këtij teksti do të përmendet si autori i parë i një teksti universitar nga lëmi i arkitekturës dhe duhet të jetë si shembull edhe për kolegët e tjerë të arkitekturës që të ndjekin shembullin e tij, ngase në lëmin e arkitekturës mungon tërësisht literatura në gjuhën shqipe tek ne në Republikën e Kosovës". Prof. Jagxhiu shtoi se ky tekst përveç që ka pasuruar literaturën, do të ndikojë në lehtësimin e përvetësimit të lëndës nga ana e studiuesve, si dhe në përmirësimin e suksesit të studentëve, dhe do të jetë i mirëseardhur jo vetëm për studentët e UBT-së por edhe të studentëve tjerë ku kjo lëndë kultivohet.

Kurse Prof. Dr. Misin Misin, recensent, tha se libri është mjaft i avancuar, i një niveli mjaft të lartë serioziteti shkencor dhe përfshin më të rejtat shkencore si dhe i preferohet të shfrytëzohen të gjithë studuesit të arkitekturës e më tej...

"Ky libër i përmbush të gjitha kërkesat dhe nevojat e studentëve, hulumtuesve dhe ekspertëve nga arkitektura dhe ndërtimtaria, por besoj se ky libër paraqet një bazë të mirë për punën studimore dhe atë profesionale", tha autori i librit Prof. Dr. Binak Beqaj, dhe falënderoi UBT për botimin e librit si dhe recensentët si Prof. Dr. Fetah Jagxhiu dhe Prof. Dr. Misin Misin, të cilët kanë dhënë vlerësimin profesional të direkt kanë ndikuar në rritjen e cilësisë së librit.

Profesori përshëndeti përzemësisht botuesin e librit, Prof. Dr. Edmond Hajrizin, si dhe mysafirët, dhe paralajmëroj se së shpejti do ta botojë edhe libra të tjerë.

Më konkretisht ky tekst i takon lëndëve bazike profesionale. Në të janë përfshirë të gjitha elemente e ndërtesave, duke filluar që nga themelet deri te mbulesa e pullazit, kulmit dhe oxhakut. Aty janë dhënë klasifikime e elementeve sipas: destimit, funksionit, llojit të materialeve për materializim të atyre elementeve, formës etj. Teksti përmban edhe mënyrat dhe metodat mbrojtëse si të ndërtesave po ashtu edhe elementeve të saja nga ndikimet e jashtme dhe të brendshme, janë përshkruar të gjitha llojet e izolimeve duke u nisura nga hidroizolimet, termoizolimet dhe izolimet akustike. Të gjitha këto janë përcjella me vizatime të bazave, prerjeve dukjeve aksometrike dhe detaleve të punuara me shumë kujdes dhe përkushtim. Më një fjalë janë dhënë të gjitha elementet që duhet të përfshihen një projekt elektronike duke filluar nga simbolet e shënimit të materialeve, mënyrat e shënimit të dimensioneve si në baza, prerje dhe kuotimet deri te paraqitja e konstruksioneve hapësinore.

Autori Prof. Dr. Binak Beqaj, studimet themelore i ka përfunduar në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës në Prishtinë, kurse të magistraturës në fushën e Menaxhimit ndërkombëtar në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, kurse ato të doktoratës në fushën e Planifikimit të Menaxhimit Urban i ka përfunduar në Universitetin Teknik të Vjenës -TU, Vjenë.

Është autor dhe bashkautor i 17 hulumtimeve dhe publikimeve shkencore. Është autor i librit "Menaxhimi Urban", dhe librit të sapopromovuar "Projektimi i Konstruksioneve Arkitektonike".

Autori Prof. Dr. Beqaj është profesor në UBT, në Departamentin e Arkitekturës dhe bartës i detyrave të larta menaxheriale.



INTERVISTË ME CAN. DR. FATBARDHA QEHAJA-OSMANI, NJËRA NDËR FITUESET E PROGRAMIT "ERASMUS MUNDUS-SIGMA"

PROF. FATBARDHA NGA UBT NË UNIVERSITETIN E SALZBURGUT

Edhe për këtë vit akademik UBT është përfituese e projektit "Erasmus Mundus – SIGMA", projekt i Bashkimit Evropian. Nga ky projekt studentët e UBT-së do të pajisën me bursa të plota studimi si në bachelor, master, doktoratës, post-doktoratës dhe mobilitetit të stafit. Ky mobilitet si i studentëve ashtu edhe i stafit do të fillojë brenda këtij viti akademik dhe atë në universitetet më prestigjioze të vendeve të BE-së. Njëra ndër përfitueset e bursës për mobilitetin e stafit akademik të UBT-së është profesoresha e gjuhës angleze, can. dr. Fatbardha Qehaja-Osmani

"UBT News": Profesoresha e privilegjuar jo vetëm e UBT-së dhe të gjitha institucioneve edukative, më konkretisht si vendosët dhe cila ishte shtytja e juaj që të aplikoni për këtë mobilitet?

Qehaja – Osmani: Trendet e edukimit duhet përcjellë për së afërmi si nga aspekti teorik ashtu edhe praktik. Përgjatë punës sime

në studime të doktoratës, kuptova që eksperiencia ime në një institucion të arsimit të lartë evropian do të ishte tejet e rëndësishme. Me rastin e shpalljes së konkursit për mundësin e aplikimit në projektin Evropian "Erasmus Mundus – Sigma", respektivisht mundësia për të aplikuar për mobilitetin e stafit akademik konsiderova se mu kjo do jetë mundësia të cilën e kam pritur tashme e që disa vite. Natyrisht, duke marrë parasysh konkurrencën e madhe nga shumë shtete të Ballkanit Perëndimor për këtë kategori, unë dorëzova aplikacionin me një optimizim të madh por edhe me një droje që do mund të më refuzohet aplikacioni nga komisioni vlerësues. Patjetër më duhet të cekë përkrahjen shumë të sinqertë nga menaxhmenti i lartë i UBT-së.

"UBT News": Konkretisht në cilin universitet, sa do të qëndroni atje dhe në cilën kohë?

Qehaja – Osmani: Unë kam fituar bursën nga "Erasmus Mundus A2" - projekti SIGMA, i koordinuar nga Universiteti i Varshavës në Poloni, për të qëndruar një muaj në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Salzburgut në Austri. Përgjatë këtij muaji unë do të kem mundësi të jem pjesë e ligjëratave, seminareve, punëto-



rive, konferencave, tryezave dhe aktiviteteve tjera shkencore. Në të njëjtën kohë një pjesë të qëndrimit tim do t'ia dedikoj përvojës së hulumtimit shkencor në këtë institucion. Këtë mobilitet do ta filloj në tetor të vitit 2013.

"UBT News": Profesoreshë, më kujtohet momenti kur pate marr lajmin që je pranuar për studime të doktoratës në Universitetin e Sheffildit, me bursë nga MASHTI, gëzimin e pate shprehur edhe përmes gazetës "UBT News", por ky privilegji sa ju ka bërë përshlyetje?

Qehaja – Osmani: Po, mendoj se kjo mundësi që të jem pjesë e një institucioni prestigjioz siç është Universiteti i Salzburgut,

do të plotësoj edhe më shumë pozitën time si një doktorante në Universitetin e Sheffildit dhe CITY College, si dhe do të me ofroj njohuri të avancuara në shkencë.

"UBT News": A mendoni se kjo përvojë do t'ju ngrit në anën profesionale dhe akademike?

Qehaja – Osmani: Nga aspekti profesional mendoj se pjesëmarrja në ligjëratat dhe ushtrime duke vëzhguar për së afërmi qasjen e mësimdhënies në këtë universitet si dhe metodat e vlerësimit për student do të jenë një përvojë praktike profesionale shumë e mirë. Në anën tjetër, hulumtimet shkencore, me theks të veçantë hulumtimet kuantitative duke hulumtuar përmes formës kom-

parative dhe korrelative të eksperimentit do sjellin një përvojë praktike të cilën vështirë që do ta përfitoja në vendin tonë.

"UBT News": Ende vazhdoi me ritëm të njëjtë të udhëtimit të shpeshta jashtë vendit për çështje profesionale, studimore dhe private, a është edhe ky udhëtim ndër të privilegjuarit që keni pas deri më sot?

Qehaja – Osmani: Jam shumë entuziaste për këtë udhëtim dhe se patjetër që do radhitet në mesin e atyre udhëtimit më interesante të jetës sime.

"UBT News": Profesoreshë, ju jeni edhe familjare, keni edhe fëmijë, kurse në anën profesionale jeni shumë aktive dhe serioz për punën që po e bëni?

Qehaja – Osmani: Është e vërtetë që jam edhe familjare dhe kam tre djem të moshave të ndryshme, dhe kjo aspak nuk është e lehtë për një grua të angazhuar në akademi dhe shkencë. Megjithatë, konsideroj se familja ime është pikërisht shtytja ime dhe frymëzimi për një arritje kulminante në karrierën time.

Intervistoi: Berna Devexhiu

(S)A MUND T'I BESOHEK LIDERSHIPIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 9 janar 2013- Në UBT, u organizua promovimi i librit "(S)a mund t'i besohet lidhshiptit të Kosovës", të autorit Prof. Dr. Belul Beqaj, me rast morën pjesë përfaqësues vendorë dhe nga fusha akademike, politike, studentë, familjarë dhe media, etj.

Përveç botuesit më saktësisht Presidentit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, fjalë rasti mbajtën edhe veprimtari dhe publicisti Adem Demaçi, politologu Ramush Tahiri, dhe Drejtori i Lëvizjes "Fol", Petrit Zogaj.

"Më konkretisht ky libër është bazë e mirë për përcjelljen e njohurive nga fushat e lidhshiptit, politikës dhe publicistikës në përgjithësi, dhe e vlerësoj lartë punën e përkushtuar të autorit ndaj këtij libri" tha Presidenti i UBT-së prof. dr. Edmond Hajrizi, njëherit edhe botuesi i këtij libri, dhe shtoi se duke qenë që nga fillimi i angazhuar për të ndjekur zhvillimet e këtij sektori, shpresojmë që autori edhe në të ardhmen do të vazhdoj të japë kontributin e tij duke na dhënë edhe botime tjera nga kjo fushë.

Kurse, z. Adem Demaçi, e vlerësoj lartë librin, por kërkoj nga autori Beqaj, që në publikimet e tij të ardhshme më shumë të përqendrohet në lidhshiptin autokton, duke aloduar në përfshirjen e aspekteve dhe figurave historike dhe të patriotëve të ndryshëm të cilët mund të shërbejnë si model për një liderin sot.

Ndërsa politologu Ramush Tahiri, në kumtesën e tij vlerësoj lartë librin duke përmendur që "Koncepti i drejtë i profesorit Beqaj, në realizimin e pritjeve nga liderët, i vlerësuar nga puna dhe nga veprimet e deklaratatave të liderëve, përkatësisht të udhëheqësve dhe të elitës së vendit, jo vetëm nga lëmia e politikës dhe qeverisjes edhe pse këtu pikërisht është fokusuar interesi, merr për bazë pikëpamjen e Rosalyn Carter se "Një lider i madh i qon njerëzit aty ku duan të shkojnë, por aty duhet të jetë".

Duke shtuar se autori Beqaj, në këtë libër, gërsheton pikëpamjet teorike për rolin dhe suksesin e liderit duke kaluar nëpër parimin" se kur je i

mirë ndaj të tjerëve je i mirë ndaj vetvetes"- Dale Carnegie, për të shpjeguar karakteristikat e liderit të suksesshëm dhe të pasuksesshëm, madje bënë një krahasim të lidhshiptit të Kosovës me lidhshiptin e disa vendeve të tjera duke e marrë si shembull edhe vlerësimin që sekretarja e shtetit të SHBA-ve Medline Allbrajt ju bënë udhëheqësve të Kosovës, në përvojat që i pati me ta.



z. Tahiri, shton se libri i Belul Beqaj "(S)a mund t'i besohet lidhshiptit të Kosovës", është një libër që ka mungua, është një libër që ja vlen të lexohet, është një libër nga i cili ka se çka të mësohet, edhe në rastin kur pajtohesh, edhe në rastin kur nuk pajtohesh, edhe me të gjeturat... para së gjithash është një libër me të cilin mund të shërbehen studentët dhe studiuesit, si në metodologjinë e punës dhe të hulumtimit e të anketimit, ashtu edhe në inkuorporimin e të dhënave, të pikëpamjeve të teorive, në funksion të temës së shtjelluar dhe në funksion të nxjerrjes së përfundimeve.

Kurse, politika nuk mund të kuptohet si art i së mundshmes, dhe nëse aplikohet parimi se qëllimi arsyeton mjetin, kjo mund ta dëmtoj edhe politikën por edhe artin, tha Drejtori i Lëvizjes "Fol", Petrit Zogaj.

Autori Beqaj, duke falënderuar të gjithë të pranishmit, tha se e ardhmja e shoqërisë kosovare i takon vetëm atij lidhshipti, që është në gjendje të kuptoj nevojën, për të ndi-

kuar në ndryshime të mëdha dhe të jashtëzakonshme të shoqërisë. Nëse ky libër ndikon në këndelljen e atyre që vendosin dhe posaçërisht në vetëdijen e mbështetësve, atëherë do të konsiderojë se kam përmbushur deri diku misionin e pareshtur, tha Dr. Beqaj.

Autori prof. dr. Belul Beqaj studimet themelore për Shkencat politike i ka përfunduar në Universitetin e Beogradit, ndërsa ka magjistruar në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës, kurse ato të doktoratës i ka përfunduar në Universitetin Shtetëror të Maqedonisë. Është profesor në Universitetin UBT. Është autor i dhjetëra punimeve publicistike-shkencore. Pjesëmarrës dhe bartës i shumë projekteve hulumtuese që kanë përfaqësuar Kosovën. Beqaj shquhet si njëri nga analistët më të dalluar politik të vendit. Ka botuar një varg titujsh të librave: "Çështjes dita", "Liria e shtypit në Kosovë", "Çfarë ishte roli i RTK-së në ngjarjet e marsit 2004", "Lidhshiptit", "Roli i lidhshiptit në politikën e medievet të Kosovës" dhe "(S)a mund t'i besohet lidhshiptit të Kosovës".

RECENSION PËR LIBRIN "ÇËSHËTJA E KOSOVËS DHE SHKATËRRIMI I JUGOSLLAVISË", TË AUTORIT PROF. DR. SC. RAMË BUJA

FILLIMI I FUNDIT TË JUGOSLLAVISË

ATDHE BUJA

Është me mjaft dobi e vlerë për kulturën politike, por edhe ndjekësit e politikës ballkanike, leximi i këtij libri të botuar në gjuhën shqipe me titullin "Çështja e Kosovës dhe Shkatërrimi i Jugosllavisë" të Prof. Dr. Sc. Ramë Buja.

Shumë pjesë të kësaj historie autori i ka përjetuar dhe ka qenë aktiv në zhvillimet e përmendura; i dënuar politik për veprimtari ilegale-partiotike, aktiv në radhët e UÇK-së, kryeshef i Drejtorisë për Marrëdhëni Publike dhe Administrim Civil, anëtar i Drejtorisë Politike dhe anëtarë i Delegacionit Negociator në Konferencën e Rambujesë.

Ky recensim i librit çështja e shkatërrimit të Jugosllavisë paraqitet në disa rrafshje; atë politike, juridike dhe ekonomike si shkaqe që ndikuan në shpërbërjen e Jugosllavisë.

Dështimi ekonomik, narrativ, rivale historike, ambiciet nacionaliste, nacionalizëm më ekstrem – gjerë në shovenizëm, shtypja dhe asimilimi i popujve jo sllav, Memorandumi ASSHAS zbuluan fytyrën e vërtetë dhe ndikuan në rrokullisjen drejt greminës të ish-Jugosllavisë.

Rrafshi ekonomik, që autori e paraqet si model specifik të ekonomisë jugosllave në raport me shetet tjera socialiste, në të cilin bëheshin shumë eksperimente – reforma me synim të shmangies së kontrollit për ekonomi tregu, fatëkeqësisht ndodhi e kundërta. Përzjerja e metodave dhe praktikave ekonomike, marrja e kredive, strategji e gabuar e investimeve si pasojë borgji i jashtëm jugosllav shënon rritje ('80, 23mild), hiperinflacioni (inflacion i madhë; Gjermani, Bolivi, ish-Jugosllavi). Si rezultat i këtyre veprimeve dhe efekteve sollën pshjtjellimin dhe domosdoshmërisht dështimin apo shembjen e modelit ekonomik jugosllav.

Rrafshi juridik, RFPJ, përkufizohet si shtet federativ popullor i tipit republikan. Kushtetuta e RFPJ-së, i jep kompetenca të gjëra duke e centralizuar pushtetin në majën e piramidës së saj. Centralizimi i tillë kishte jetëgjatësinë pesë (5) vjeçare, në vitet '50-'55 fillon një decentralizim i ngadaltë si vetqeverisja punëtoare, shoqërore dhe sistemi komunal por ekskluzivisht për republikat, por jo edhe për krahinat si Vojvodina e Kosova. Rikthimi i tyre si subjekte të federatës ndodhi me kushtetutën e '74, e cila asnjëherë nuk funksionojë. Shqiptarët në ish-Jugosllavi ishin kombi i tretë për nga numri, por të fundit në të drejta dhe zhvillim ekonomik. Dhe, padyshim që ishte e kuptueshme se ku do të fillonte shkatërrimi i këti sistemi.

"Kosova Republikë" viti '81, paraqiste sfidën e parë të madhe trashëgimtarëve të Titos (libri "Makthi Etnik i Jugosllavisë" '98), ky vit solli fundin e Jugosllavisë, studentët dhe intelektualët shqiptar ishin bartësit kryesor të asaj fryme të rezistencës për liri e pavarësi.

Në fazën përfundimtare dhe më tragjike të krizës jugosllave ndikoi shumë shkatërrimi i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë (22 janar '90), duke pasur parasysh gjendjen në shkatërrim dhe shpërbërjen e Federatës Jugosllave, e që si ide dhe më pas në obsesion ishte zgjidhja ushtarake.

Tendecat për unitarizim edhe në mënyrë kundërkushtetuese, shtrirjen e hegjemonizmit të Serbisë dhe të serbëve në këtë vend, rezistenca e arsyeshme e subjekteve të tjerë, kapërcimi i këtyre tendencave me mjete kushtetuese ishte i pamundur, andaj u vendosë shkëputja nga Federata, në bazë të drejtës për vetëvendosje (Sllovenia, Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina).

Rrafshi politikë- ideja për bashkimin e sllavëve të jugut

solli krijimin e Jugosllavisë që merrë kohën prej një shekulli por për ta shkatërruar u dëshën vetëm pak vite. Lëvizjet e herë pas hershme politike dhe vendimeve të Titos, Jugosllavisë i sollën benefite në aspektin ekonomik, përfitimit financiar për Titon dhe rrethit të tij bashkudhëheqës, por jo në pjesën më të pazhvilluar të saj, siç ishte Kosova.

Siç e njohim përgjatë historisë së popullit shqiptar bota perëndimore ishte e gatshme të bëhej e shurdhër dhe e verbër në momente të caktuara; veprimet e perëndimit ishin: në shumë raste përmes ndihmave mundësonte organizimin, strukturimin dhe forcimin e ushtrisë në përmasa të shpërputhshme në raport me përmasat e vendit, e cila më pas shëndërrohej dhe shfrytëzohej në aparat dhune, shtypje dhe asimilim.

Do të veqoj edhe një detaj i cili mund të mos vërehet – ndikimi dhe efekti i tij; fjalimi i Slobodan Millosheviçit, në Fushë Kosovë, e që më vonë do të merrte nam, dhe që shënonte fillimin e fundit të Jugosllavisë.

BE-ja u gjend krejtësisht e papërgatitur në sfidën e madhe – Jugosllavi, siq thotë autori "BE-ja u vonua për veprimin e saj në një koncert të vajtueshëm impotence; duke vështruar politikën e "spastrimit etnik" në ish-Jugosllavi".

Robëria vazhdonte edhe pas Luftës së Dytë Botërore për popullin shqiptar, i cili megjithë përpjekjet e angazhimit e deklaruar përmes Rezolutës së Konferencës së Bujanit (31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944), ndër pikat kryesore të saj thuhet: "Kosova është një popullatë shumicë shqiptare, e cila si gjithmonë dëshiron bashkimin me Shqipërinë..."

Përpjekja më e fuqishme e popullit shqiptar dhe që arriti vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare me aleatin e saj



NATO ishte UÇK strukturë ushtarake-politike, e cila arriti t'i largojë forcat pushtuese serbe nga Kosova. Ku edhe autori gjatë Luftës Çlirimtare në Kosovë ishte aktiv në radhët e UÇK-së, duke ushtruar detyra të rëndësishme dhe me përgjegjësi të lartë.

Kishte filluar rënia e perandorisë (ish-Jugosllavisë), rënie e cila në diplomaci përcaktohet si një nga detyrat më të vështira për frenimin e rënies.

Një rrafsh tjetër që shtjellohet në këtë libër nga autori është edhe ana mitologjike apo hyjnore, miti i rrejtshëm serb për Kosovën, e tëra bëhej për të vetmin qëllim për ta pasur Kosovën.

E keqja më e madhe e besimit të serbëve është që ata filluan besimin në gënjeshtër të tyre. Një ëndërr dhe rezistencë e popullit shqiptar e pashuar mbetet bashkimi me pjesën tjetër të kombit, Shqipërinë; me të drejtën e vetëvendosjes së popujve. Edhe kriza në ish-Jugosllavi, jo rastësisht, nisi me Kosovën dhe mitin e ringjallur për të, siq thekson autori në një taban të ri me qëllime të vjetra.

Kuadri politik dhe juridik ndërkombëtarë që u angazhua për krizën jugosllave që tashmë kishte marrë hovin e rrokullisjes në greminë, u mundua që përmes konferencave të vonuara si ajo e Hagës, Londrës, Gjenezës, Dejtonit dhe Rambujesë; por të vetmen gjë kishin të për-bashkët që të legjitimoheshin realitetet e reja të krijuara nga luftërat në vend se të pengoheshin apo ndalnin ato.

Në fund të këtij recensionimi mund të konkludojmë atë që autori e paraqet në këtë libër, dmth, më në fund u gjet gjuha e komunikimit të cilën shumë mirë e kuptonte regjimi gjeno-cidal i Millosheviçit, e vonuar por që po të ishte përdor në kohë të duhur, edhe gjakderdhja edhe komprometimi do të ishin në përmasa më të vogëla. Autori i paraqet tri shkaqe të Shkatërrimit të Jugosllavisë, së pari Roli dhe aktivitetet e ASSHA dmth, Memorandumi i ASSHA hapi frontalisht portat e shkatërrimit të ish shtetit jugosllav; së dyti Dështimi ekonomik; së treti Nacionalizimi më ekstrem serb gjerë në shovenizëm.

POEZITË E BASHOTËS NË BIBLIOTEKËN E UBT-së

Prishtinë, 11 janar 2013- Autori Halil Bashota, sot Bibliotekës së UBT-së i ka dhuruar librin më të ri nga fusha e letërsisë "Të jetosh një kohë tjetër".

Libri ndahet në pesë cikle me gjithsej 102 poezi. Cikli i parë -Bota është një fjalë- reflekton njohjen e botës përmes imagjinatës dhe intuitës së autorit që paraqitet të jetë reale në konceptin e përshkrimit. Ciklet tjera siç janë: Eja të zbrisim në Univer, Bija e Hijeve dhe Hija e gurit- shprehin motivet e një universaliteti të shprehur mitologjik, duke aluduar heroizmin dhe epitetet universale të universit. Këtu qasja dhe identifikimi me botën është më i butë dhe më solemn, që herë-herë shprehet edhe në thirrmore siç është poezia "Eja të zbrisim në Univer".

Ndërsa cikli i fundit- Të jetosh një kohë tjetër, është një përmbledhje substanciale e motiveve dhe nuancave të ndryshimit që personalizohen me shumë karaktere dhe profile jetësore.

E DREJTA E BASHKIMIT EVROPIAN

Prishtinë, 22 nëntor 2012- U publikua libri shkencorë nga fusha e juridikut " E drejta e Bashkimit Evropian, parimet, institucionet dhe praktika gjyqësore" të autorit can. dr. Emrush Ujkani, profesor në Universitetin UBT.

Në këtë libër trajtohet si themelimi, e drejta si dhe mënyra e krijimit të Bashkimit Evropian.

Më saktësisht këtë libër e bënë të veçantë fakti se, gjatë gjithë shqyrtimit të tij vend të posaçëm do të zë e drejta parësore, posaçërisht duke iu referuar Traktatit të Bashkimit Evropian pas ndryshimeve të pësuar me Traktatin e Lisbonës dhe drejta e derivuar e Bashkimit Evropian me të drejtat e rasteve, respektivisht vendimeve të gjykatës së drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Recensentët e librit " E drejta e Bashkimit Evropian, parimet, institucionet dhe praktika gjyqësore" janë prof. dr. Hajredin Kuqi dhe prof. dr. Herber Kupper.



INTEVISTË ME NEXHMEDIN JASHANICËN, STUDENTË NË UBT

FIDANISHTJA "FIDANI", E VETMJA NË VEND

Fidanishtja "Fidani" është njëra ndër bizneset më të mëdha dhe e vetmja në vend për produktin që e ofron. Lidhur me këtë, stafi i gazetës "UBT News", ka shfrytëzuar rastin dhe ka zhvilluar një intervistë me njërin ndër menaxherët e kësaj fidanishte me Nexhmedin Jashanicën, i cili është edhe studentë në Departamentin MBE në UBT

"UBT News": Kush është fidanishtja "Fidani" më konkretisht?

N. Jashanica: Fidanishtja "Fidani" merret me kultivimin e filizave të saporrenjësuar. Për të prodhuar filiza është pak më ndryshe për dallim nga bimët tjera. Të gjithë këta filiza i kemi vendosur ose mbjellë në tasa të plastikës, rritja dhe mbajtja e tyre shkon deri një sezon gjashtë mujorë ose deri një vit. Pas kësaj do të jenë fidane të gatshme për shitje e të gatshme për mbjellje në hapsira dekorative (kopshte) të ndryshme.

Po ashtu në produkti tjetër që e kultivojmë në këtë ambient është komposti (dheu për mbjellje) të cilën e prodhojmë vetë pa shpenzime shtesë, duke bërë përzirjen e duhur të barishtave të ndryshme (greens) dhe lëvozhgave të drunjeve (braëns) në compost bin, si dhe të gjitha mbetjet bimore të kuzhinës, prandaj duhet të bëhet kujdes në përgatitjen e dheut në mënyrë që të krijohen kushtet e përshtatshme për rritjen e fidaneve.

"UBT News": Sa keni investuar deri më tash në Kosovë në këtë fidanishte, dhe më kë keni bashkëpunuar, apo investuar?

N. Jashanica: Deri më tani kemi investuar rreth 5.000.00 Euro investime vetanake, dhe po ashtu kemi përfituar dy grande me vlerë prej 10.000.00Euro nga USAID dhe INTERCORPORATION, kjo e fundit me një SER prej 5 h/k.

"UBT News": E kujt ka qene kjo ide e mençur, te bëni një fidanishte të tillë?

N. Jashanica: Duke u nisur nga pasioni që në si familje i kemi lulet dhe në përgjithësi natyrën, arrijmë gjerë te ideja e mundësisë së konkretizimit të një biznesi solid familjar të cilin shpresojmë ta arrijmë me anë të përkrahjes familjare dhe ndihmës së donatorëve të mundshëm. Familja jonë vazhdimisht ka punuar në kultivimin e bimëve të ndryshme, për nevoja familjare po ashtu duke pare interesimin e të afërmeve kemi vendosur për kultivimin e fidanëve të ndryshme edhe për një treg më të gjerë. Nisur nga kjo kemi ardhur deri te motoja jonë "Jetoje jetën me lule" e cila do të jete edhe moto e biznesit tonë. Ne besojmë në të gjitha kapacitetet tona njerëzore, infrastrukturore, profesionale, ideore, pozitën e mirë gjeografike që kemi, sasinë e mjaftueshme të ujit, etj që të fillojmë me një biznes konkret.



Shumica e këtyre furnizimeve janë importe nga shtetet fqinje të cilat vine me një kosto më të lartë se sa kostoja e produkteve tona!

"UBT News": Prejse keni filluar punën në fidanishten "Fidani", a keni mundur të depërtoni t'i njoftoni qytetarët e Kosovës për një kultivim të tillë?

N. Jashanica: Ne besojmë se do të kemi konsumator të ndryshëm për produktet që i kemi, për këtë është bërë një analizë e vogël në treg dhe është parë se këto fidanishte kanë mungesë të këtij lloji të furnizimit, pasi që shumica e këtyre furnizimeve janë importe nga shtetet fqinje të cilat vine me një kosto më të lartë se sa

kostoja e produkteve tona, pas-taj bujqit të cilët dëshirojnë t'i mbjellin arat e tyre me fidanë të ndryshme dekorative e që pastaj ato pas disa viteve do ti shesin si fidanë të rritura për kopshte, duke u ngritur vetëdija individuale e popullatës rritet edhe përkujdesja për kopshte individuale. Arsyja kryesore se pse konsumatori do të paguan për produktin tonë do të jetë kostoja e arsyeshme dhe kualiteti i lartë pasi që ato do të jenë shumë më të qendrueshme në rritje se sa fidanet e importuara sepse që në start ato do të jenë më të adaptueshme në klimen tonë (zonën 6 klimatike) që është dhe arsyeja kryesore e dështimeve të shumta të fidaneve.

"UBT News": A ka arritur sadopak "Fidanishtja" ta zbus papunësinë në rrethinë dhe sa punëtor ka të punësuar?

N. Jashanica: Biznesi ynë bënë pjese në sektorin e Hortikulturës të bimëve dekorative, dhe ne marrim punëtor sezonal 2-5 punëtor ne varësisht prej volumit të punëve që i kemi dhe mendoj që jemi kontribuues të mirave materiale për këta punëtor.

"UBT News": A keni ndonjë plan për investime apo tjera gjatë vitit që jemi dhe viteve të ardhshme?

N. Jashanica: Kultivimi i 12000 - 15000 fidanëve këtë vit, rritja e kapaciteteve kultivuese në vitet në vijim për 100 %, mbjellja e tre hektar me fidan brenda dy viteve, synim i tregut të vendeve fqinje.

Vendi i kultivimit dhe shitjes të fidanëve në fjalë gjendet në fshatin Vranidol në magjistrallen Prishtinë – Podujevë, në kilometrin e 12. Lokacioni është i përshtatshëm pasiçë rruga është e asfaltuar deri tek vendi i kultivimit gjë që e lehtëson dukshëm transportin si për konsumatorët që do të furnizohen nga vendi i prodhimit po ashtu edhe për vetë biznesin tonë.

Intervistoi:
Fidan Thaqi

STUDENTI I UBT-së NË MESIN E AMBASADORËVE TË "PAJTIMIT"

Nën organizimin e Këshillit të Rinjeve për Arsim dhe Ambasadës së Britanisë së Madhe në Beograd, në dhjetor 2012, u mbajt seminari për ambasadorët e rinj të pajtimit mes popujve të rajonit. Në këtë seminar kanë marrë pjesë të rinj nga Kosova, Bosnja Hercegovina dhe Serbia, ku në mesin e të cilëve ishte edhe student i UBT-së Endrit Kadriu.

Gjatë këtij programi pjesëmarrësit vizituan institucione të ndryshme politike dhe jo-qeveritare në Beograd, ku patën rastin të bisedojnë me politikanë, e udhëheqës të organizatave të ndryshme si dhe promovuan vlerat kulturore të vendeve të tyre. Gjatë programit të ngjeshur të vizitës, pjesëmarrësit nga Republika e Kosovës, Bosnja dhe Serbia biseduan për çështjen e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, luftërave në Kosovë dhe në Bosnje, për integrimet evropiane dhe për zgjidhjen jo të dhunshme të problemeve. Më tutje pjesëmarrësit vizituan Kuvendin e Serbisë, Prokurorin Special për Krime Luftë, dhe institucione tjera ku u ndezën debate të shumta dhe të ndryshme. Pjesëmarrësit nga Kosova i promovuan vlerat kulturore Shqiptare të Kosovës duke marrë veshje dhe ushqime tradicionale, Plisin, Kanunin e Lekë Dukagjinit – ku treguan vlerat e lashta të besës dhe mikpritjes tek Shqiptarët, flamurin kombëtar dhe shtetëror, si dhe materiale tjera të ndryshme kulturore që identifikuan popullin e Kosovës.

"Kjo vizitë studimore ka qenë një mundësi e mirë për të shkëmbyer njohuritë dhe përvojat mes popujve të rajonit, si dhe një rast i padiskutues-



hëm për të bërë debate të hapura e konstruktive me politikanë dhe me persona tjerë me ndikim në jetën politiko-sociale të Serbisë. Më konkretisht për të informuar e nxitur bashkëbiseduesit që të kuptohen gabimet e së kaluarës, me theks të veçantë për gjenocidet dhe krimet e luftës të përsëritura disa herë gjatë historisë." u shpreh Endriti.

Në fund të seminarit 20 pjesëmarrësit nga Kosova, Bosnja Hercegovina dhe Serbia, u certifikuan me titullin "Youth Reconciliation Ambassadors", dukë u bërë ambasadorë të rinj të pajtimit, me qëllimin që të punojnë në të ardhmen në këtë drejtim, për një rajon sa më paqësor.

STUDENTI I UBT-së THEMELUES DHE BASHKËPRONAR I KOMPANISË "INFECTED ARCHITECTURE"

Njëri ndër themeluesit dhe bashkëpronar i kompanisë "Infected Architecture", është Krenar Krasniqi, student i UBT-së, në Departamentin e Arkitekturës, në bahcelore, ku kjo kompani është e licencuar për ndërtime të ulëta dhe të larta, për dizajnim dhe projektim.

"Për dallim nga kompanitë tjera në rajon, klientëve tonë ju ofrojmë dizajne të ndryshe dhe mundohemi që t'ju përshtatemi kërkesave të tyre dhe të realizojmë sa më korrekt", thotë z. Krasniqi për gazetën "UBT News". Ai më tej shton se kompania në fjalë ka realizuar projekte të ndryshme dhe të shumta si shtëpi individuale- lokale, afariste dhe restorante. Shtrirjen e kësaj kompani sot e gjejmë jo vetëm në vend e rajon por edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në qytetin Fort Worth Texas, ku kanë realizuar projekte për restorante dhe për shtëpi individuale.

Kurse për vitin që jemi, synimi i tyre përbashkët është, realizimi i një projekti më të gjerë, ku do të prezantohen një kolazh i planeve të ndryshme, ku do të jenë shtëpi individuale unike, dhe propozime të ndërhyrjeve arkitektonike në pjesë të ndryshme të qyteteve në Kosovë.

Rrugën të cilën është ka ndjek kjo kompani, në një të ardhmen pretendon të bëhet kompani liderë në arkitekturë, kuptohet me punë cilësore dhe dizajnë të rangut botëror.



GRUA!!



Frosina Islami

Grua!
Kur u përmend ky emër, cila ishte gjëja e parë që të erdhi ndër mend ???
Po mendohesh?!
Edhe unë...mbase te erdhi ndër mend nëna, motra, e dashura, apo një mikesh, një mësuese, apo mbase në vend të këtyre tw erdhën ndër mend emra të mëdhenj grash, një këngëtare e preferuar, aktore, modele, dikush si Oprah Winfrey si Nënë Tereza. Cilado që të ketë qenë, patjetër se do të jetë motra, e dashura, nëna, e bija e dikujt, patjetër që do të ketë ardhur ndër mend një hije e bukur e ndokujt. Grua, qenia përmes se cilës natyra i fali bukurinë tokës.

Nëse të erdhën ndër mend këto të fundit atëherë me siguri sh bashkë me to të erdhën ndër mend çmime të ndryshme, globe të arta, mbase edhe Oskare, e nëse të erdhën ndër mend të parat atëherë gjasat që të të ketë ardhur ndër mend një oskar a një çmim janë zero. Mund të të jetë kujtuar një vozitëse që bllokon trafikun, një mësuese apo infermiere, një nënë që është tërë kohën në nxitim dhe nuk është çudi nëse do t'i ketë patur këpucët ndryshe veshur nga moskujdesi, një bukurorë që s'ke guxuar ti flasësh asnjëherë duke u frikësuar se do të të injoroj, një tjetër që shumë e qetë bënë shopping pa qarë kokën për tollovit e ditës, një vogëlushe që ecën rrugës duke kënduar shumë e lumtur, apo një tjetër që ecën e hutuar thuajse nuk është në këtë botë fare, një lypëse e rëndomtë që të përgjehet t'i falësh ndonjë cent ?Mund të të jetë kujtuar secila nga këto nga pak, apo njëra në veçanti. Mua në vend të një figure me erdhën në mend miliona pyetje, dhe kjo sigurisht pse jam një femër, dhe të paturit shumë pyetje është tipike për gjininë time Kush jam unë?Kush jemi ne?Kush është bota etj..

Por më së shumti mendova si do të ndihet një femër kur përmendet kjo fjalë ? Do të ndihet e lumtur apo e trishtuar, me fat apo e mallkuar, e bekuar? E dobët, naive, qaramane, e shfrytëzuar, e bukur?. Do të ndihet njw diva, një kukull? Do të ndihet perëndeshë e bukurisë, një Afroditë e Greqisë,do të ndihet e vetme, e lënduar , e thyer , do të ndihet e bekuar? Do të ndihet një femër me ambicie,e dobishme, një femër e pushtetshme,e ti ..Ti si po ndihesh ? Njëra nga to apo secila nga pak ? Cilado që do të jesh ndjerë jam e sigurt që bashkë me ndjenjën të erdhi në mendje një person që të bëri të ndihesh ashtu, në ato momente do të kesh urreyer-uruar atë person, do të kesh urreyer-uruar vetveten, në këto momente mbase edhe po mendohesh se cila nga kjo je ti. Po e mendon atë person që të bëri të ndihesh kështu,dhe mbase ndihesh më e dobët apo më e fortë se kurrë me parë. Unë derisa po shkruaj miliona vajza më erdhën ndër mend, i kam parë të gjitha nga këto që i përmenda. Një

mike timen, një motër, një nënë, një gjyshe, një të dashur të vëllait, një fqinje, bilës edhe një vogëlushe të panjohur në rrugë. Secila më vajzë se tjetra. Femër-vajzë për nga figura,bukuria,e ecura,e qeshura,por mbi të gjitha femër për nga karakteri,e butë në shpirt dhe e egër në mendje,e ligë si djalli,e lumtur si një engjell. Mes tjerash mu kujtua një lajm që pata dëgjuar kohë më parë në radio për një vajzë të dhunuar brutalisht,dhe të lënë në një cep të botës, s'mund të mos mendoja,si do të jetë ndjerë ajo? Për ters mu kujtua një figurë e famshme e showbizit, një barbi, një kukull që që të gjitha femrat e shikojnë me admirim, s'mund të mos mendoja po ajo si ndihet? Si ndihesh të jesh një femër, të jesh një grua? Të vish në këtë botë, jo gjithmonë shumë e mirëpritur, të rritesh për t'u bërë një yll bote, apo një viktimitë e dhunës, të rritesh për t'u bërë një nënë, një bashkëshorte, një gjyshe një ditë, të rritesh për të marrë edhe rolin e babait ndonjëherë, të rritesh pa një destinacion të saktë, të jesh një femër duke mos u ndier e bukur sa duhet, e mirë sa duhet, e fortë sa duhet, mendjemprehtë sa duhet, e sa në të vërtetë duhet? Nuk e di, as nuk mendoj se do të jemi në gjendje t'a dijë ndonjëherë. E në te vërtet sa e mirë duhet të jesh për t'u konsideruar e mirë? Dikush dikur dikë do të ketë dashur dhe dikush dikur dikë do të ketë harruar dhe dikush dikur dikë do të ketë lënduar, dikush dikur dikë do të ketë përçafuar. Dikush dikur dikë do të ketë sjellë në jetë,dhe dikush dikur i dha botës një qenie të re, ai dikush qe ekzistonte dikur solli te sotmen, ai dikush ekziston edhe sot falë atij qe ekzistoi dikur. Ty të solli në jetë një femër, ty t'i dha hapat e parë një femër, t'i mësoi shkronjat e para një femër, kur të dhembë koka medoemos do t'i drejtohesh një femre, kur të jesh e lodhur dhe uritur do të kesh nevojë për një femër, dhe kur të ndodhesh ne mes të humbëtirës do të të bie ndërmend një femër. Dikush që do të të dojë më shumë se që do vetveten,do të të bie ndërmend nëna jote, një femër.

Ajo që të mësoi si të duash dhe nuk kërkoi asnjëherë asnjë shpazim për këtë,ajo që të ofroi ngrohtësi edhe kur ajo do t'i ketë munguar për vete,ajo që mund të të ketë rritur e vetme pa një baba për ty,ajo që harroi veten duke të të kujtuar ty. Ajo që nuk u marros pas gabimeve të tua,ajo që kujtoi një imazh tëndin të pastër edhe kur ti e harrove atë për vete,ajo që kujtoi bukurin tendë edhe kur u ndjeve i shëmtuar,ajo që të plotësoi edhe kur u theve,ajo që kujtoi sinqeritetin tënde edhe kur u ndjeve në faj,dhe ajo që të kujtoi qëllimin edhe kur ti ishe konfuz .

Dikush që asnjëherë nuk mori një çmim,apo një glob të artë,apo një Oscar për gjithë këtë mund,në të njëjtën kohë me siguri do t'i ketë shikuar me shume ëndje të gjitha programet televizive ku shfaqen ato që u shpërblyen për diçka,duke ëndërruar e dashur pafundësisht shumë që të ishte ajo në vend të saj. Mbase jeta më të vërtet nuk është e drejtë,të paktën është më e drejtë se vdekja,Një femër të solli në këtë botë,mos e harro asnjëherë prejardhjen tënde,një femër është trangu i shoqërisë, duaje! Por më së shumti ti që je një femër, mos i harro vlerat e tua,ti qe nuk e di se cila nga ato femra je dhe nuk e di se si ndihesh, lërma të ta kujtoj e dashur,ti je një femër,një zemër e butë dhe e pastër,një dikush që ke ardhur nga dikur,dhe që do të sjellësh në jetë dikë,që ai te bëhet një ditë dikush dhe të vazhdoj ciklin jetësor dhe si e tillë që je zoti te bekoftë! Amen .

Dedikuar të gjitha atyre që patën një rrugë të gjatë për në shtëpi.

PROBLEMET E RINISË!

Granit Bunjaku

Vendin tonë e kanë kapluar probleme të shumta, por ato të cilat më preokupojnë më shumë mua, si një i ri i Kosovës janë problemet e duhanpirjes, konsumimi i drogës dhe alkoolit, të cilat po vazhdojnë të prekin jetët tona pa u ndalur.

Kohët kanë ndryshuar, dhe po kështu edhe problemet sociale, konsumimi i duhanit, drogës dhe alkoolit, ka arritur në shkallë alarmante duke ndikuar negativisht në zhvillimin e rinisë tonë. Këto zakone të këqija të cilat kanë pushtuar djemtë në ditët e sotme ka filluar të përhapet si një vrasës i heshtur tek të gjithë madje edhe tek vajzat. Në kërkim të identitetit të tyre, të rinjtë po ndikohen lehtë nga miqtë e tyre. Ata miqësohen me njerëz,të cilët konsumojnë duhan, drogë e alkool, e pastaj bëhen pjesë e grupit, duke e pare këtë si një gjë me të cilën duhet të mburren. Arsyeye tjera të këtyre problemeve mund të jenë edhe dëshira për tu larguar nga realiteti, problemet me mësim apo me familje ju shkaktojnë depresion dhe stresi, pastaj nga mosdija se si të përballen me këto situata ata zgjedhin "botën e ëndrrave" do të thotë fillon përdorimi i këtyre lëndëve të rrezikshme, të cilat shumë shpejtë do të shndërrohen në problem edhe më të mëdha, duke shkakuar sëmundje të ndryshme si: kanceri i llojeve të ndryshme, astma, probleme me frymëmarrje, problem të zemrës etj. E me gjithë këto efekte, sigurisht që rinia jonë s'do të ketë ndonjë të ardhme të ndritur, duke mos përmendur krimet që do të shkaktojnë përderisa janë në ndikim të drogës dhe alkoolit.

Kjo nuk është një e ardhme të cilën e dëshirojmë për rininë e vendit tone, andaj për të luftuar këto çështje, ka disa zgjidhje të cilat duhet të ndërmerren nga shoqëria. Së pari këshilltarët e shkollave duhet të organizojnë programe për ti motivuar të rinjtë gjithashtu dhe ti informojnë për rreziqet të cilat këto shprehje të këqija i shkaktojnë, të mbahen fushata të anti-drogës, duhanit dhe alkoolit së paku dy herë në vit nëpër zonat e banuara, ndërsa prindërit kanë rolin më kryesorë,ata duhet të kujdesen se me kë po shoqërohen fëmijët e tyre. Parandalimi ose vonimi është arma më premtuese në luftën kundër këtyre dukurive, kështu që të shpëtojmë të rinjtë tanë nga këto zakone të këqija të cilat e shpijnë vendin tone vetëm në dëshitim dhe asgjë tjetër.

"Edhe pse bota ecën përpara, të rinjtë prapë se prapë duhet të nisen nga fillimi"- Këtë, shkrimtari gjerman kishte thënë një here, kështu që le të shkojmë përpara duke u përpjekur që të bëjmë më të mirën për të rinjtë e Kosovës, për ardhmërinë e tyre të ndritur.

SOFTUERI PËR KORRIGJIMIN E GABIMEVE DREJTSHKRIMORE



Janë shumë të shpeshta rastet, kur shkrimet e ndryshme nga shqipshkruesit të niveleve të ndryshme përmbajnë gabime të shumta morfologjike e sintaksore, duke ndryshuar kështu

domethënien thelbësore që synohet të përcillet tek lexuesi përmes atij shkrimi.

Shkrime të ndryshme zyrtare nga institucione të ndryshme qeveritare e joqeveritare përcillen me gabime drejtshkrimore. Të tilla gabime hasen edhe në njoftime e shpallje rezultatesh të disa profesorëve universitar, madje, ka edhe të atilla raste kur të emëruar: profesorë të gjuhës gabojnë drejtshkrimin e gjuhës standarde, dhe kështu transmetohet kjo mesimdhënie tek nxënësit e cila natyrshëm pranohet si e mirëqenë nga ata.

Ndër gabimet më të shpeshta drejtshkrimore haset keqpërdorimi i shkronjave "ë" dhe "ç", shkronja e parë vihet vend e pavend kurse kjo e dyta zakonisht ngatërrohet me "q". Për disa

shqipshkrues nocionet: zgjidhje dhe zgjedhje janë thjesht sinonime, e për disa tjerë "xh" dhe "gj" paraqesin të njëjtën bashkëtingëllore!

Po ta lexoni statutin e Universitetit të Prishtinës të vendosur në faqen zyrtare, sigurisht se do të vëreni shumë gabime, ja disa prej tyre që unë i vëreja: "avansim" (duhej të ishte avancim), "regullave" (rregullave), "kerkesë" (kërkesë), "nevoitet" (nevojitet), "konkurim" (konkurim), "çertifikatat" (certifikatat), "dorëheqjes" (dorëheqjes), "përvojen" (përvojën), "përgjgjësia" (përgjegjësia), "shëndërrohen" (shndërrohen)... këto gabime i takova fare në fillim përmes korrektoris AS 2.0, imazhinoni sa gabimet dhe parregullsitë gjuhësore e gramatikore do t'i gjente po ta analizonte një

gjuhëtar statutin e Universitetit të Prishtinës, i cili përmbledhet me rreth 90 faqe. Kjo ishte një analizë e shkurtër dhe natyrisht joprofesionale për një institucion të lartë akademik, paramendoni si mund të jetë gjendja në institucione tjera!

Tani, problemi në fjalë mund të zgjidhet më lehtë se kurrë më parë, mjafton që vetëm ta instaloni programin kompjuterik për drejtshkrim AS 2.0 në kompjuterin tuaj. Në këtë pako që ofrohet falas për banorët e Kosovës do të gjeni edhe doracakun për të gjitha udhëzimet e nevojshme për instalim dhe përdorim të mëpastajshëm të softuerit. Përvetësimi i këtij programi është i thjeshtë dhe nuk kërkohet ndonjë trajnim i veçantë për përdorimin e tij. Softueri është i njëjtë me

programet e gjuhëve të tjera në kuadër të "Microsoft Office" dhe në pajtim me programin operativ "Microsoft Windows" të çdo versioni. Menjëherë pas instalimit ju do të jeni në gjendje që të korrigjoni fjalë e trajta fjalësh në tekstin e shkruar shqip, korrigjimin mund ta bëni pasi të jeni njoftuar nga kompjuteri se keni gabuar, ai do ta bëjë këtë duke nënvizuar fjalën që ju e keni shkruar gabim, mjafton një klikim me tastin e djathtë të miut dhe menjëherë korrigjohet ai gabim, madje kjo korrekturë mund të bëhet edhe automati-kisht.

Edhe gjuha shqipe tani më është futur në mesin e gjuhëve të kompjuterizuara. E gjitha kjo fal punës dhe kontributit të Qendrës për Edukim dhe Përpunim, gjë për të cilën ju jemi mirënjohës.

Afrim Bajraktari
Student në UBT,
Departamenti-
Menaxhimi i Mekatronikës

APLIKACIONET MOBILE JANË SHUMË TË PËRHAPUR

"Aplikacionin "MP3 Box", të cilin e kam lanësuar para pak ditësh, për dallim nga loja, "MP3 Box", është programuar i gjithë me "Java", pasi njohuritë e marra në UBT, për gjuhën programuese..." tha Edoni për gazetën "UBT News".

UBT News : Çfarë aplikacionesh keni punuar?

Edon Sakiraqa: Punimet që i kam programuar janë të ekzekutueshme në Sistemin operativ Android. Punimi i parë ka qenë loja "Balloon Neddle" të cilën nga kureshtja e madhe për ta programuar një lojë e kam arritur ta përfundoj "Balloon Neddle", i cili është shkruar në gjuhën basic. Punimi tjetër, po në këtë lami është aplikacioni "MP3 Box", të cilin e kam lanësuar para pak ditësh. Për dallim nga loja, "MP3 Box" është programuar i gjithi me "Java" pasi njohuritë e marra në UBT, për gjuhën programuese ku



kjo më kanë ndihmuar më shumë në zgjidhjen e algoritmeve që më janë dashur.

UBT News : Kur ke filluar të merresh me programim?

Edon Sakiraqa: Me programim kam filluar që nga mosha 14 vjeçare, mirëpo në atë kohë unë programoja vetëm me Visual Basic dhe

VisualBasic.NET. Natyrisht aplikacionet që i ndërtoja ishin shumë të thjeshta, dhe nuk besoj që do t'i hynin në punë ndokujt. Më pastaj fillova të hyj edhe në Web(Ueb) ku fillova të njoftohesha edhe me gjuhët skriptuese si JavaScript, PHP, Action Script 3 etj. Tash jam fokusuar më shumë nga aplikacionet mobile pasi në ditët e sotme kjo teknologji është përhapur shumë.



UBT News : Çka ndihmojnë aplikacionet?

Edon Sakiraqa: Në ditët e sotme falë zhvillimit të teknologjisë gjëra mund të kryhen më shpejtë se dikur, kur zhvillimi i teknologjisë ishte në një nivel më të ulët. Natyrisht, teknologjia nuk i bën vet punët që ne i kërkojmë, por janë aplikacionet e ndryshme, të cilat i ka krijuar njeriu, që njihet si programe kompjuterik. Pra me këtë kuptojmë, që aplikacionet na ndihmojnë në kryerjen e disa punëve në një kohë më të shkurtër, pasi jo gjithkush dëshiron të jetë një programmer kompjuterik.

UBT News : Ku gjeni inspirimin për të programuar aplikacione?

Edon Sakiraqa: Për krijime të aplikacioneve të mira duhet

punë, përkushtim. Natyrisht edhe inspirimi luan rol të rëndësishëm. Pjesë e inspirimit tek unë është edhe dëshira për me e pa vetën duke programuar. Po ashtu edhe personat si Bill Gates, Steve Jobs, Mark Zuckerberg, të cilët i kanë dhënë një kahje krejt tjetër teknologjisë janë inspirim për mua.


UBT News : A has probleme gjatë krijimit të aplikacioneve?

Edon Sakiraqa: Natyrisht gjatë punës gjithmonë hasim në probleme të ndryshme. Zakonisht në programim ku problemi kryesor është gjetja e problemit. Në momentin kur gjendet problemi atëherë zgjidhja e tij është më e lehtë.

Intervistoi: Egzona Luboteni

**NEW TASTE
MAX ENERGY**

magnum
ENERGY DRINK
PIJE ENERGIJE
Produkt nga WILD Germany



Studentët e UBT-së gjatë mësimit dhe ushtrime studimore freskohen me pijen freskuese "Red Bull"



ANKETA : CILAT JANË PASOJAT E MUNGESËS SË PJESËMARRJES TË SPORTISTËVE KOSOVARË NË GARAT NDËRKOMBËTARE ZYRTARE?

Alb Imeri

Arsyeja për mos prezencën në garat ndërkombëtare të sportistëve kosovar, është se nuk jemi të pranuar në FIFA, dhe nuk jemi të njohur nga ligat tjera...

Florim A. Gashi

Po të ishte bllokada vetëm për sportistët, do të kishe qenë shumë më lehtë të zgjidhet çështja. Por, populli i Kosovës, në përgjithësi është vendi i vetëm në Evropën Juglindore, që nuk mund të vizitoj shtetet evropiane. Sa i përket sportit, Kosovën e reprezenton në mënyrë shumë të mirë në botë, sportistja jonë Majlinda Kelmendi, e cila këmbëngul që në garat ndërkombëtare t'i mbroj

ngjyrat e flamurit të Kosovës, por neglizhenca e qeverisë së Kosovës bën që Majlinda të mos ketë as më të voglin benefit nga shteti. Kup-tohet që ka bllokadë të mospjesëmarrjes së sportistëve nga Kosova në garat ndërkombëtare, por edhe në rastet e rralla kur sportistët marrin pjesë për të reprezentuar Kosovën, qeveria jonë tregohet e paaftë për përkrahjen e karrierës së këtyre sportistëve. Gjithsesi shpresa vdes e fundit, dhe kjo shpresa e ceket është duke na mbajtur optimizmin gjallë që një ditë do të jetë më mirë.

Krenar Alija

Mendoj që pasojat e mos pjesëmarrës në garat ndërkombëtare

janë shumë të mëdha sidomos në futbollin kosovar, ka shumë lojtar që luajnë për kombëtaren të tjera shtetet e që njëkohësisht kishin mundur me përfaqësuar Kosovën, në mënyrën ma të mirë si p.sh Valon Behrami, Xherdan Shaqiri, Granit Xhaka e shumë e shumë lojtar tjerë, por mos pranimit në UEFA dhe FIFA, lë pasojat që i kemi sot e që po na përcjellin edhe më tutje.

Arianit Haxha

Pjesëmarrja në garat ndërkombëtare të sportistëve do të kontribuon në njohjen e shtetit tonë edhe në vende ku ndoshta nuk kanë qenë në dijeni se ekziston. Në dhe sot kemi sportistë

femër që tani u është dëgjuar emri në gara ndërkombëtare si psh. Majlinda Kelmendi sporti: Judo. Kemi nevojë që edhe femrat të inkuadrohen më shumë në sporte të ndryshme, që nesër emri i shtetit tonë të dëgjohet në pjesë të ndryshme të botës.

Vegim Vata

Fillimisht duke nisur nga sporti më i famshëm- futbollit, ne si shtet nuk e gëzojmë të drejtën të zhvillojmë ndeshje ndërkombëtare, këtë të drejtë nuk e gëzojmë as në vendin tonë pa miratimin e shtetit serb sipas FIFA-së, më pas duke kaluar në sportet e tjera, ku cilësohemi si të denjë për

medalje si në Xhudo, ku përfaqësohemi denjësisht nga Majlinda Kelmendi, (fatkeqësisht jo me flamurin e shtetit), ku së fundi thuhet se sporti i Xhudos, do përjashtohet nga lojërat Olimpikë më 2020, apo edhe Hendbollit, ku në vazhdimësi arrijmë të kualifikohemi në raundet e avancuara, por fatkeqësisht nga përvoja e pakët, vazhdojmë të mos i arrijmë majat në këtë kategori. Pasojat sigurisht janë politike në rend të parë, mungesa e fondeve të ndara për sportin si dhe joserioziteti nga ana e Komitetëve përkatës. Sigurisht se gëzojmë shumë talent por që fatkeqësisht janë duke shkuar dëm nga kjo situatë.



STUDENTI I UBT-SË DHE SHOKËT E TIJ KANË SHKËLQYER NË KAMPIONATIN BOTËROR TË SHOTOKANIT

Prishtinë, 8 prill 2013 - Karateistët kosovarë kanë shkëlqyer në Kampionatin Botëror të stilit Shotokan, të mbajtur në Stamboll të Turqisë.

Ata fituan gjithsej 23 medalje, shtatë prej të cilave të arta. Herolind Nishevci, Orges Arifi,

Fortesa Orana, Diellza Dragusha, Gresa Zhitija, Melos Gashi dhe skuadra ekipore e femrave (Orana, Dragusha, Rama dhe Zhitija) patën rezultatet kulmore në kategoritë e tyre duke fituar edhe titullin e kampionit. Shtatë medalje të tjera për kosovarët ishin të argjendta,

ndërsa të tjerat të bronzta. Në këtë turne, morën pjesë 2000 garues nga më shumë se 60 shtete.

Herolind Nishevci, është studentë i rregullt në UBT, në vitin e III në Departamentin, Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi.



STUDENTI I UBT HENDBOLLIST I NJOHUR!




Riad Shabanaj, që shtatë vite është aktiv në sportin e hendbollit, luan për ekipin e "Kosovës së Vushtrrisë" në kategorinë e Seniorëve. Gjithashtu është pjesë e Kombëtares së Kosovës U22, ku me Kombëtaren ka marrë pjesë në turnire të shumta jashtë vendit si në Hungari, Itali, Kroaci e vende tjera, gjithashtu disa herë ka qenë i nominuar edhe për lojtarin e vitit në vend, kështu që në vitin 2010 shpallet lojtari më i mirë i vitit në kategorinë e Juniorëve nga Federata e Hendbollit të Kosovës.

Riadi pak a shumë këtë sport e ka të trashëguar nga familjarët e vet: "Me fol realisht unë jam rritë me këtë sport, sepse halla dhe axha im janë marrë një kohët të gjatë me hendboll, ku kanë luajtur në ligën më të fortë në botë, në ligën e ish- Jugosllavisë".

Riadi pas mbarimit të studimeve i cili është studentë në UBT në Departamentin e Juridikut, mendon të shkojë në Luksemburg, pikërisht te axha Agron Shabani, i cili është trajner i hendbollit në në këtë qytet, dhe do të vazhdon sportin që e ka edhe si traditë familjare.

Top University Education for Top Students



- 12 vite Lider i Arsimit të Lartë
- I certifikuar sipas standardit ISO 9001 për cilësi
- Përfitues nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Inovacione

Zgjedh më të mirin ...

... që të bëhesh më i miri!

Come to UBT and go everywhere...

Në bazë të Statutit dhe Vendimit të Rektorit nr.1754/45-12 të datës 08.07.2013 UBT shpall:

KONKURS

Për vitin akademik 2013/2014 në këto programe studimi:

- MENAXHMENT, BIZNES DHE

EKONOMI (BA,MA)

- Financa, Banka dhe Kontabilitet,
- Marketing dhe Shitje,
- Manaxhment dhe Ndërrmarrësi

- SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (BSc, MSc)

- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Softuer dhe Sisteme Inxhinierie,
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Dizajn dhe Multimedia
- Mekatronikë dhe Robotikë

- MENAXHMENT I MEKATRONIKËS (BSc, MSc)

(Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit, Prodhimtaria Industriale, Dizajni Industrial, Ndërrmarrësi dhe Menaxhment)

- ARKITEKTURË (BSc)

(1 vetmi privat i akredituar në vend)

- JURIDIK (LLB)

(Civile, Penale dhe Ndërkombëtare)

- SISTEMET INFORMATIVE (BSc)

(Menaxhment, Biznes dhe Informatikë)

- SHKENCAT POLITIKË (BSc)

- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integritime Europiane
- Administratë Publike

- MEDIA DHE KOMUNIKIM (BSc)

- NDËRTIM DHE INXHINIERI E MJEDISIT ME INFRASTRUKTURË (BSc)

(1 vetmi privat i akredituar në vend)

Përmes UBT-së ju mund të studioni


dhe të përfitoni bursa studimi në Universitetet partnere si:

 Vienna University of Technology, Austri
Engineering Management (MSc)


 University of Warsaw, Poloni
International Relation (BA, MA)

 City University London, Angli
Computer Science and Engineering (BSc, MSc)

 HiG - Gjøvik University, Norvegji
Computer Science and Engineering (Mobility)

 CIFE - Centre International de Formation Europ, Francë
European Integration and Law (MA)

 Danube University Krems, Austri
Master in Business Administration (MBA)

 WIT (Waterford Institute of Technology), Irlandë
Master in Information Systems (MSc)

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi 4X6

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze

Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta gjatë ditës. Për të punësuarit ofrohen ligjërata pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

Që suksesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe certifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë.
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Projekt, etj.

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik është 1200 €, me mundësi pagese deri në 12 kështe.

Për të gjithë nxënësit e dalluar UBT ofron zbritje 20-50%

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentë që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik

nuk është vetëm diplomë...

... ËSHTË PRESTIGJ!

... ËSHTË SUKSES!

... ËSHTË CILËSI!

American European University Education

Lagja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400 Email:info@ubt-uni.net Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës 09:00 deri në 17:30

Apliko online: www.ubt-uni.net/apliko ose në qendrat për Informim dhe Regjistrim në Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Podujevë, Gjilan dhe Rahovec